



KOLEGJI UNIVERSITAR
BEDËR

Kolegji Universitar “Bedër”

RAPORTI I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në
“Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”**


Grupi i Vlerësimit të Brendshëm:

1. Dr. Arti Omeri (Kryetar)
2. Dr. Sofokli Garo (Anëtar)
3. MSc. Edlir Spaho (Anëtar)
4. MSc. Krisien Xoxa (Anëtar)
5. MSc. Klevis Topi (Anëtar)
6. MSc. Gesjana Kaba (Sekretare)
7. Norest Belegu (Përfaqësues i studentëve)

Janar / 2021

Tabela e Përmbajtjes

Tabela e Përmbajtjes	2
TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM	6
PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM.....	8
Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”	9
I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	9
Standardi I.1	9
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	9
Standardi I.2	11
Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.	11
Standardi I.3	12
Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.....	12
Standardi I.4	14
Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	14
Standardi I.5	15
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.	15
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR.....	19
Standardi II.1	19
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.....	19
Standardi II.2	21
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.	21
Standardi II.3	23
Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.	23
Standardi II.4	25
Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxëniet dhe vazhdimet të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.....	25



Standardi II.5	28
Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.	28
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT	30
Standardi III.1	30
Institucioni ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së 30	30
mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit. 30	30
Standardi III.2	33
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.	33
Standardi III.3	36
Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.	36
Standardi III.4	39
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.	39
Standardi III.5	41
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	41
Standardi III.6	42
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti. ..	42
Standardi III.7	43
Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.	43
Standardi III.8	46
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	46
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT	49
Standardi IV.1	49
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit.	49
Standardi IV.2	50
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efçente dhe efektive	50
Standardi IV.3	52

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit	52
Standardi IV.4.....	54
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.....	54
Standardi IV.5.....	55
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit	55
Standardi IV.6.....	57
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.....	57
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE	59
Standardi V.1	59
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	59
Standardi V.2.....	61
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program	61
Standardi V.3.....	62
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.....	62
Standardi V.4.....	64
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.....	64
Standardi V.5.....	65
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre	65
Standardi V.6.....	67
Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.....	67
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT.....	69

Standardi VI.1.....	69
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë	69
Standardi VI.2.....	71
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	71
Standardi VI.3.....	73
Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve	73
Standardi VI.4.....	75
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitet akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre	75
Standardi VI.5.....	77
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.....	77
Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Kolegji Universitar Bedër”	79
Pikat e forta dhe afirmime	79
Pika të dobëta.....	82
Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit.....	83
Lista e dokumenteve bazë për procesin e akreditimit të programeve të studimit.....	84

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

Kolegji Universitar "Bedër" u çel me vendimin nr.286, datë 06.04.2011 të Këshillit të Ministrave,¹ me anë të së cilit u miratua dhënia e licencës për ushtrimin e aktivitetit si institucion i arsimit të lartë. KU "Bedër" është një institucion në fushën e arsimit të lartë, i cili funksionon si organizatë jofitimprurëse. Akreditimi i parë institucional është marrë në vitin 2013 nga APAAL² dhe riakredituar nga Agjencia Britanike e Sigurimit të Cilësisë dhe ASCAL në vitin 2017³. Akreditimi i të gjitha programeve të studimit që ofrohen, është një tregues i rëndësishëm i cilësisë dhe standardeve të Kolegjit Universitar "Bedër".

Programi i studimit Bachelor në "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi", u licensua si program studim pranë Departamentit të Shkencave Kompjuterike, asokohe pjesë e Fakultetit të Filologjisë dhe Edukimit.⁴

Për përmbushjen e misionit të tij dhe për të ofruar një ofertë akademike sa më të mirë, KU "Bedër" synon vazhdimisht rritjen e cilësisë akademike dhe institucionale, pjesë e vizionit të funksionimit, që nuk synon sasinë, por cilësinë. Për realizimin e këtij synimi gjatë vitit akademik 2019 – 2020, KU "Bedër" aplikoj për procedurën e riorganizimit institucional.

Duke filluar nga viti akademik 2020–2021, me urdhër të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr.200, datë 03.07.2020, Departamenti i Shkencave Kompjuterike që ofron programin e studimit "Bachelor" në "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi" është njësi bazë e Fakultetit të Teknologjisë dhe Biznesit.⁵

Departamenti i Shkencave Kompjuterike vepron si njësi bazë mësimore-kërkimore, që përfshin fusha kërkimi homogjene në disiplinat e shkencave kompjuterike dhe teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Departamenti aktualisht ofron programet e studimit "Bachelor" në "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi"⁶, "Bachelor" në "Shkenca Kompjuterike",⁷ si dhe programin profesional dy vjeçar "Programim në Web".⁸

Programi i ciklit të parë të studimit "Bachelor" në "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi" zgjat 3 (tre) vite akademike, të ndarë në 6 (gjashtë) semestra. Programi përbëhet nga 180 ECTS, ku për çdo vit parashikohen 60 ECTS, të ndara në 30 ECTS për çdo semestër.

Programi i studimit "Bachelor" në "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi", nëpërmjet një kurrikule të bazuar dhe të mbështetur në traditën e disa universiteteve kombëtare dhe ndërkombëtare, është projektuar t'u ofrojë studentëve njohuri teorike dhe praktike të profileve më të rëndësishme dhe më me perspektivë të sistemeve Hardware dhe Software, që mbështeten nga teknologjia e informacionit dhe komunikimit.

¹ Evidenca nr. 1: Vendimi i Këshillit të Ministrave "Për liçencimin e Shkollës së Lartë "Hëna e Plotë" (Bedër)

² Evidenca nr. 2: Urdhër nr.223, datë 04.06.2013 "Për akreditimin institucional dhe të programeve të studimit"

³ Evidenca nr. 3: Vendimi i BA Nr. 101, datë 10.11.2017 "Për akreditimin periodik të Institucionit të Arsimit të Lartë, Kolegji Universitar "Bedër"

⁴ Evidenca nr. 4: Urdhër Nr. 426, Datë 18.07.2018, për hapjen e programit të ciklit të parë të studimit "Bachelor" në "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi", në Kolegjin Universitar "Bedër", Tiranë

⁵ Evidenca nr. 5: Urdhër nr. 200, datë 3.7.2020 "Për riorganizimin e njësive kryesore të Kolegjit Universitar "Bedër"

⁶ Evidenca nr. 4: Urdhër Nr. 426, Datë 18.07.2018, për hapjen e programit të ciklit të parë të studimit "Bachelor" në "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi", në Kolegjin Universitar "Bedër", Tiranë


⁷ Evidenca nr.6: Urdhër Nr. 350, Datë 17.06.2019, për hapjen e programit të ciklit të parë të studimit "Bachelor" në "Shkenca Kompjuterike", në Kolegjin Universitar "Bedër", Tiranë

⁸ Evidenca nr. 5: Urdhër nr. 184, datë 3.7.2020 "Për hapjen e programit të studimit me karakter profesional në "Programim në Web", në Kolegjin Universitar "Bedër"



Ky program ka si mision kryesor t'i përgatisë studentët me njohuri bazë teorike dhe praktike në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, si dhe në disiplina mbështetëse; të formojë specialistë me kompetenca praktike në fushat e dizenjimit dhe implementimit të sistemeve informatike, për t'iu përgjigjur nevojave në sektorin publik ose privat, brenda ose jashtë vendit ku do të jenë të angazhuar.

Vizioni i këtij programi është realizimi i studimeve cilësore në fushat përkatëse si dhe arsimimi me standarde të larta, duke synuar të përgatisë ekspertët më të mirë të fushës në Shqipëri, si dhe konkurimin e tyre në arenën ndërkombëtare.

A series of handwritten signatures in blue ink, including the name 'Clement' and several other illegible signatures.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

Në mbështetje të nenit 103 dhe të nenit 104 të ligjit nr.80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Statutit të Kolegjit Universitar "Bedër"⁹, si dhe urdhrin të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës "Për miratimin e standardeve shtetërore të cilësisë për vlerësimin dhe akreditimin institucional të institucioneve të arsimit të lartë", nën përgjegjësinë e titullarit të njësisë, me propozim të Këshillit të Departamentit dhe me vendim të Senatit Akademik u ngrit Grupi i Vlerësimit të Brendshëm (GVB) për programin "Bachelor" në "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi"¹⁰.

Në përzgjedhjen e anëtarëve të GVB-së janë marrë parasysh kompetencat profesionale, paanshmëria, mundësitë për grumbullimin e informacionit për të kryer vlerësimin dhe shkallën e nevojshme të njohjes së anëtarëve të grupit. Grupi është ngritur qëllimisht për misionin e vlerësimit të brendshëm (grup ad-hoc). GVB-ja ka në përbërjen e tij 7 anëtarë, duke përfshirë edhe përfaqësues të studentëve.

Ky proces akreditimi për programin e studimit "Bachelor" në "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi" zhvillohet për herë të parë.

Projekti i raportit të vetëvlerësimit u diskutua në njësi, nga ku dolën mendime dhe sugjerime, të cilat plotësuan hartimin e raportit përfundimtar.

ETAPAT E PROCEDURËS SË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM:

1. Kërkesë për fillimin e procesit të vlerësimit të jashtëm të programit nga ana e Kolegjit Universitar "Bedër" drejtuar Bordit të Akreditimit, me shkresë nr. 128, datë 28.05.2020.¹¹
2. Pranimi i kërkesës dhe njoftimi për trajnimin e grupit të punës mbi sistemin e menaxhimit të ASCAL.
3. Ngritja e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm (GVB) me propozim të Këshillit të Departamentit dhe miratim të Senatit Akademik, me vendimin nr. 1, datë 09.12.2020.¹²
4. Kryerja e vlerësimit të brendshëm sipas udhëzimeve përkatëse të ASCAL-it.
5. Përgatitja e dosjes së vetëvlerësimit.
6. Hartimi i Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB), sipas kërkesave e udhëzimeve në këtë udhëzues dhe pas konsultimit të përmbajtjes së tij me personelin e institucionit.
7. Dorëzimi në ASCAL i Raportit të Vlerësimit të Brendshëm bashkë me të gjithë dokumentacionin mbështetës.

⁹ Evidenca nr. 7: Statuti i Kolegjit Universitar "Bedër"

¹⁰ Evidenca nr. 8: Vendim i Senatit Akademik për miratimin e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm, programi Bachelor në TIK

¹¹ Evidenca nr. 9: Kërkesë për fillimin e procesit të vlerësimit të jashtëm të programit nga ana e Kolegjit Universitar "Bedër", drejtuar Bordit të akreditimit

¹² Evidenca nr. 8: Vendim i Senatit Akademik për miratimin e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm, programi Bachelor në TIK



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Teknologji Informatike dhe Komunikimi”

I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE

Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	<p>Kolegji Universitar “Bedër”, si një institucion me një mision të qartë në përgatitjen e profesionistëve nëpërmjet një filozofie arsimimi që ka në thelb vlerat universale, me qëllim vënie në jetë të ideve dhe projekteve, që ndikojnë në përmirësimin e jetës së njeriut dhe mbarë shoqërisë, ofron programe studimi, të cilat reflektojnë interesat e prioritetet kombëtare të vendit.^{13 14} KU “Bedër” në përgjithësi dhe konkretisht Departamenti i Shkencave Kompjuterike, i ka kushtuar vëmendje të veçantë që në çeljen e programeve të studimit që ato të jenë në përputhje me politikën dhe interesat kombëtare. Programet e studimit në KU “Bedër” janë në harmoni me zhvillimet më të fundit të Procesit të Bolonjës.</p> <p>Misioni i Departamentit të Shkencave Kompjuterike është përgatitja e individëve me njohuri të thella në fushën e teknologjisë së informacionit dhe kompjuterizimit, zhvillimi i të menduarit kritik për të kuptuar dhe për t’u përshtatur në botën që zhvillohet me shpejtësi. Departamenti synon të përgatisë profesionistë kontribues për shoqërinë me interes për zhvillimin teknologjik dhe kërkimin shkencor, që do të mund të përballojnë me sukses sfidat e shekullit të 21 në shërbim të shoqërisë dhe vlerave universale.</p>
Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Gjatë gjithë këtyre viteve, KU “Bedër” i ka kushtuar një rëndësi të veçantë ruajtjes, zhvillimit dhe promovimit të vlerave kulturore kombëtare. Në nivel institucional, KU “Bedër” është përpjekur që të promovojë kulturën shqiptare, edhe tek studentët që kanë ardhur nga shumë vende të ndryshme. Në rastin konkret, KU “Bedër” në programet që ofron, ka synuar që të ndihmojë në ruajtjen e këtyre vlerave kombëtare duke ju mundësuar bursa studimi edhe studentëve shqiptarë që vijnë nga trojet shqiptare jashtë kufinjve zyrtarë, konkretisht nga Kosova, Lugina e Preshevës etj.¹⁵ Programi “Bachelor” në “Teknologji Informatike dhe Komunikimi” është konceptuar si një program që mbështetet në forcimin e vlerave akademike dhe kulturore në një shoqëri në zhvillim. Respektimi i vlerave akademike dhe kulturore kombëtare përfshihet natyrshëm në këtë program studimi duke i ofruar studentëve një formim të plotë dhe të gjithanshëm, për t’i bërë ata të gatshëm për t’u përballur me kushtet e një tregu të hapur global në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.</p>
Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p>Programet e studimit të ofruara nga Departamenti i Shkencave Kompjuterike janë hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e Kolegjit Universitar “Bedër” dhe janë në përputhje të plotë me misionin dhe fushën e veprimtarisë së këtij institucioni.¹⁶ Kjo është e përcaktuar në misionin e departamentit, ku theksohet se misioni i departamentit për këtë program është përgatitja e individëve me njohuri të thella në fushën e teknologjisë së informacionit dhe kompjuterizimit, zhvillimi i të</p>

¹³ Evidenca nr. 7: Statuti i Kolegjit Universitar “Bedër”

¹⁴ Evidenca nr. 10: Plani Strategjik 2018-2023

¹⁵ Evidenca nr. 11: Aplikim burse për Luginën e Preshevës

¹⁶ Evidenca nr. 7: Statuti i Kolegjit Universitar “Bedër”

	<p>menduarit kritik për të kuptuar dhe për t'u përshtatur në botën që zhvillohet me shpejtësi. Departamenti synon të përgatisë profesionistë kontribues për shoqërinë me interes për zhvillimin teknologjik dhe kërkimin shkencor, që do të mund të përballojnë me sukses sfidat e shekullit të XXI, në shërbim të shoqërisë dhe vlerave universale.¹⁷</p> <p>Kurrikula e programit TIK synon të përgatisë “studentë të aftë për të përballuar gjithë kërkesat e një shoqërie që avancoon vullshëm nga pikëpamja teknologjike, që ata të zhvillojnë aftësitë e të menduarit kritik, të një vendimmarrjeje të shpejtë dhe të saktë, të kuptojnë dimensionet etike dhe profesionale të vendimeve që marrin, të njohin rolin dhe rëndësinë që ka teknologjia e informacionit në të gjitha veprimtaritë e institucioneve dhe organizatave”.</p>			
<p>Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>Programet e studimit të ofruara nga KU “Bedër” janë në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe synojnë të kontribuojnë në nxitjen e zhvillimit ekonomik lokal dhe kombëtar. Bazuar në këtë qasje të institucionit, Departamenti i Shkencave Kompjuterike ofron programe studimi të bazuara në nevojat reale të tregut të punës dhe në përputhje me strategjinë kombëtare për punësim dhe aftësi.¹⁸ Departamenti ka vlerësuar nevojat e tregut të punës dhe ecurinë e sektorëve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit dhe shkencave kompjuterike. Me mundësitë e reja në epokën digjitale, teknologjia e informacionit dhe komunikimit paraqitet si një ndër sektorët më parësorë dhe me hapësira të gjera për punësimin e të diplomuarve. Këto të dhëna janë siguruar nga studimi i detajuar i tregut të punës të realizuar në kuadër të hapjes së programit të studimit. Studimi në fjalë përfshin në mënyrë të detajuar mundësitë e punësimit të studentëve në tregun rajonal, kombëtar e ndërkombëtar, kërkesat e punëdhënësve; numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra, numrin e kërkesave të maturantëve për këto programe, etj.¹⁹</p> <p>Politikat zhvillimore të Departamentit të Shkencave Kompjuterike nga ana tjetër janë hartuar në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit dhe nevojat e tregut të punës. Aktualisht, sektori i IT-së paraqitet si një ndër sektorët më parësorë në vend dhe me hapësira të gjera për punësimin e të diplomuarve.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>√</p>

¹⁷ Evidenca nr. 12: Rregullorja e programit “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”

¹⁸ Evidenca nr. 13: Strategjia kombëtare për punësim dhe aftësi, 2014-2020: https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2018/06/Strategjia_Kombetare_per_Punesim_dhe_Aftesi_Plani_Veprimit.pdf

¹⁹ Evidenca nr. 14: Studim tregu i programit “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”

Standardi I.2

Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Spektori i teknologjisë së informacionit paraqitet si një ndër më prioritarët dhe me hapësirë të mjaftueshme për punësimin e të diplomuarve. Prandaj, programi “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” ka dalë me prioritet për zhvillimin institucional të KU “Bedër” dhe kjo është theksuar në objektivat e zhvillimit të Kolegjit Universitar “Bedër” të përcaktuara qartë në planin strategjik 2018-2023 dhe në planin e parë strategjik të institucionit. ²⁰ ²¹ Në planin strategjik 2018-2023 thuhet shprehimisht se Kolegji Universitar “Bedër” ka si qëllim të sigurojë një arsimim cilësor, i cili bëhet garanci për studentët e diplomuar që të ndihen të aftë brenda mundësive që ofron tregu i punës. Kolegji Universitar “Bedër” ofron programe studimi në fushën e shkencave humane, sociale, shkencave kompjuterike dhe teknologjisë së informacionit, duke sjellë një profil të larmishëm në tregun e arsimit të lartë shqiptar dhe atë ndërkombëtar.
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Dokumentat kryesorë ku bazohet funksionimi i KUB, si: Statuti, Rregullorja Themelore dhe Rregullorja e Organizimit Akademik, përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike. ^{22 23 24} Programet e studimit të ofruara nga KU “Bedër”, përfshi këtu edhe programin “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”, janë në përputhje me prioritetet akademike të parashikuara në dokumentat e sipërpërmendura. Neni 52 i Rregullores Themelore parashikon se “qëllimi i programeve të studimit të ciklit të parë “Bachelor” është pajisja e studentëve me njohuri teorike dhe praktike në fushat respektive me anë të studimeve, praktikës dhe kryerjes së kërkimit shkencor në këto fusha. Në përfundim të programeve të studimit të ciklit të parë studentët fitojnë njohuri të përgjithshme dhe të nevojshme në fushat përkatëse. ²⁵ Ndërkohë që në nenin 52 të së njëjtës rregullore, thuhet se: “Programet e studimit të ciklit të parë janë konceptuar si harmonizim i njohurive duke filluar me atë bazë teorike, fushës dhe ndihmëse, duke vijuar me thellime në mënyrë më të detajuar në fushat specifike. Arsimimi në fakultetet dhe departamentet e Kolegjit Universitar “Bedër” zhvillohet në përputhje me kërkesat e legjislacionit shqiptar në fushën e arsimit të lartë, si dhe të Kartës së Bolonjës”. ²⁶ Programi i studimit “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” i pajis studentët me njohuritë bazë për metoda e parime shkencore të përgjithshme, nëpërmjet një filozofie arsimimi që ka në thelb vlerat universale dhe mbështetjen shkencore-kërkimore, me qëllim vënien në jetë të ideve dhe të projekteve që ndikojnë në përmirësimin e jetës së njeriut dhe ndjekin zhvillimet bashkëkohore në fushën e teknologjisë së informacionit. Kjo është vënë në dukje edhe në rregulloren e programit. ²⁷
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e	Për t’iu përshtatur sa më mirë nevojave të shoqërisë dhe për të ofruar një ofertë akademike sa më të plotë, gjatë vitit akademik 2019-2020, KU “Bedër” hyri në

²⁰ Evidenca nr. 10: Plani Strategjik 2018-2023

²¹ Evidenca nr. 15: Plani Strategjik 2012-2017

²² Evidenca nr. 7: Statuti i Kolegjit Universitar “Bedër”

²³ Evidenca nr. 16: Rregullorja Themelore

²⁴ Evidenca nr. 17: Rregullorja mbi Organizimin Akademik

²⁵ Evidenca nr. 16: Rregullorja Themelore, neni 52

²⁶ Evidenca nr. 16: Rregullorja Themelore, neni 52

²⁷ Evidenca nr. 12: Rregullorja e programit “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”

<p>programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.</p>	<p>proces riorganizimi të njëjësive kryesore duke sjellë si risi Fakultetin e Teknologjisë dhe Biznesit ²⁸ me tre njësi bazë, një prej të cilave është Departamenti i Shkencave Kompjuterike. Programi “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” është një prej programeve të këtij departamenti. Dokumentat kryesorë ku bazohet funksionimi i KU “Bedër”, si: Statuti, Rregullorja Themelore dhe Rregullorja e Organizimit Akademik, përcaktojnë qartë drejtimit akademike të institucionit. Ashtu siç është parashikuar dhe në Rregulloren Themelore të KU “Bedër”, programi “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” funksionon në përputhje të plotë me Procesin e Bolonjës dhe kërkesat e Ligjit “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Programi ka të përshkruara qartë objektivat dhe kompetencat profesionale. Në rregulloren e programit, krahas objektivave janë parashikuar gjithashtu rezultatet, organizimi i programit, mundësitë e punësimit të studentëve, gjuha e mësimdhënies dhe emërtimi i diplomës.²⁹</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				√

<p>Standardi I.3</p>	
<p>Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p>Si një program i bazuar në kërkesa profesionale dhe me synimin për të përgatitur profesionistë të një shoqërie demokratike, programi “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” kërkon të përmbushë objektivat e tij duke ndihmuar studentët të zhvillojnë aftësitë e të menduarit kritik, të një komunikimi të qartë, që të kuptojnë dimensionet etike të vendimeve që ata marrin, të njohin rolin dhe rëndësinë që ka teknologjia efçente dhe gjithmonë në zhvillim në mbështetje të detyrave dhe objektivave të institucioneve publike dhe private. Këto objektiva të programit janë pasqyruar qartazi në dokumentin e aplikimit për hapjen e këtij programi. Ai është ndërtuar në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor për formimin e studentëve në ciklin e parë të studimit dhe parashikon dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që fitojnë studentët në përfundim të tij. Kuadri ligjor ku mbështetet hartimi i këtij programi përcakton standardet karakterizuese të dijeve, aftësive dhe kompetencave profesionale, të cilat karakterizojnë profilin e programit të studimit. Këto elementë janë pjesë e dosjes së programit që është aprovuar nga MASR, si dhe janë të parashikuara në rregulloren e programit të studimit.^{30 31} Përmes një kurrikule të bazuar në objektiva të qarta, programi synon të zhvillojë një botëkuptim të gjerë të teorive dhe praktikës në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë</p>	<p>Para hapjes së programit, në vitin 2018, u bë një studim për vlerësimin e nevojave të tregut të punës. Në përfundim, Departamenti i Shkencave Kompjuterike ka parashtruar një studim të detajuar tregu. Studimi në fjalë përfshin në mënyrë të detajuar mundësitë e punësimit të studentëve të programit “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” në</p>

²⁸ Evidenca nr. 5: Urdhër nr. 200, datë 3.7.2020 “Për riorganizimin e njëjësive kryesore të Kolegjit Universitar “Bedër””

²⁹ Evidenca nr. 12: Rregullorja e programit “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”

³⁰ Evidenca nr. 12: Rregullorja e programit “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”

³¹ Evidenca nr. 12: Rregullorja e programit “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”

<p>periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>tregun rajonal, kombëtar e ndërkombëtar; kërkesat e punëdhënësve; numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra; numrin e kërkesave të maturantëve për këto programe, etj.³²</p> <p>Që në krye të herës në studimin e tregut është bërë e qartë nevoja për specialistë IT dhe për përdorimin e teknologjisë kompjuterike në shumë sektorë, si në biznes, në sektorin e shëndetësisë, në industrinë e medias, në sistemin bankar, etj.</p> <p>Nga ana tjetër, KU “Bedër” ka në përbërjen e tij njësi të caktuara, të cilat hartojnë raporte periodike mbi ecurinë e punësimit të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet në tregun e punës për fushat që përputhen me programet e studimit që ofron institucioni. Rol aktiv këtu luan Zyra e të Diplomuarve dhe Zyra e Planifikimit të Karrierës.^{33 34}</p>			
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përfitim të dijeve, aftësive, shkathësisë e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Programi i studimi “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” parashtron një strukturë të qartë të objektivave formuese, njohurive, rezultateve të të nxënit, aftësive dhe kompetencave që studenti përfiton në përfundim të ciklit tre vjeçar. Struktura dhe përmbajtja e programit është konceptuar duke mbajtur parasysh formimin bazë të studentëve në disiplinat e përgjithshme dhe formimin specifik që garantohet nga lëndë të caktuara me objektiva të parashkuara në aftësimin praktik.</p> <p>Programi i studimit “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” ka si mision kryesor t’i përgatisë studentët me njohuri bazë aplikative në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, si dhe nën disiplinat mbështetëse, të formojë specialistë me kompetenca të zgjeruara praktike në fushat e implementimeve të sistemeve informatike, si dhe specialistë në lidhje me nevojat e teknologjisë së informacionit në sektorin publik apo privat.</p> <p>Duke synuar realizimin e misionit dhe objektivave të institucionit, programi i studimit “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” përgatit profesionistë të aftë dhe të pajisur me shprehje dhe aftësi në disa profesione dhe specialitete që lidhen me teknologjinë e informacionit, siç janë mirëmbajtja e pajisjeve, administrimi efikas i rrjeteve, siguria dhe mbrojtja nga sulmet kibernetike, etj. Shprehjet teorike dhe praktike të studentëve të këtij programi për këto kompetenca janë pasqyruar në kurrikulën e këtij programi dhe syllabuset e lëndëve/kurseve të veçanta që përbëjnë atë.</p> <p>Të gjithë elementët përbërës të lartpërmendura të programit janë të parashikuara dhe në formatin e syllabusit të çdo lënde, i cili është i arritshëm për studentin dhe publikun përmes faqes zyrtare në internet të institucionit.³⁵</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				√

³² Evidenca nr. 14: Studim tregu i programit “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”

³³ Evidenca nr. 18: Raport i Zyrës së të Diplomuarve, viti 2019-2020

³⁵ Evidenca nr. 19: Shembull syllabusi CMP 111 Hyrje ne algoritem dhe programim

Standardi I.4

Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.	<p>Edhe pse institucioni disa vite më parë ishte i orientuar drejt shkencave humane dhe sociale, u vu re se tendenca e zhvillimeve brenda dhe jashtë vendit ishte teknologjia. Ndryshimi i strategjisë institucionale tregon për vitalitetin dhe dinamikën e jetës akademike në institucion. Gjatë këtyre tre viteve është bërë një punë e madhe për të zgjeruar kapacitetet dhe burimet e nevojshme për t'iu përgjigjur nevojave të programit "Bachelor" në "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi".</p> <p>Stafi akademik i angazhuar në Fakultetin e Teknologjisë dhe Biznesit, në Departamentin e Shkencave Kompjuterike, demonstroi qartë kapacitetet dhe mjaftueshmërinë e burimeve njerëzore të nevojshme për ofrimin e programit të studimit "Bachelor" në "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi".</p> <p>Personeli akademik i departamentit është i përbërë nga lektorë me kohë të plotë, të cilët kanë formim të mirëfilltë akademik në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, inxhinierisë kompjuterike dhe matematikës së aplikuar.³⁶ Eksperienca e personelit më kohë të plotë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor, si dhe përvojat profesionale në kompani dhe institucione të ndryshme, japin garancinë për kapacitetet e duhura në realizimin e këtij programi studimi. Nga ana tjetër, një element i rëndësishëm është edhe angazhimi i specialistëve të fushës së IT-së dhe shkencave kompjuterike, si lektorë me kohë të pjesshme apo asistente në lëndë të caktuara. Ndërtimi i një laboratorit të ri kompjuterik me parametrat më të avancuara të kohës (krahas atij ekzistues), rekrutimi i stafit me përvojë dhe mbajtja e një raporti të arsyeshëm lektor-student, janë disa nga treguesit e punës së vazhdueshme për t'a bërë sa më produktiv programin e ri "Bachelor" në "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi".</p>
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	<p>Adoptimi i strategjisë së re institucionale drejt fushës së teknologjisë e bëri të domosdoshëm riorganizimin e Njësisë Kryesore. Fakulteti i Teknologjisë dhe Biznesit u riorganizua në përputhje të plotë me ligjin aktual për arsimin e lartë. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit "Bachelor" në "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi" është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, fakultetit, dhe njësisë bazë, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit dhe sipas direktivave e udhëzimeve kombëtare e evropiane. Njësia kryesore, Fakulteti i Teknologjisë dhe Biznesit, nëpërmjet Departamentit të Shkencave Kompjuterike, gjithashtu ofron dy programe të tjera në fushën e teknologjisë dhe shkencave kompjuterike, përkatësisht "Bachelor" në "Shkencat Kompjuterike" dhe Program Profesional 2 vjeçar "Programim në Web". Fusha akademike dhe kërkimore e njësisë kryesore plotësohet më tej edhe me Departamentin e Biznesit dhe Ekonomisë dhe Qendrën për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe Inovacion, dy njësi këto që kanë në thelb të tyre aplikimin e njohurive dhe praktikave teknologjike në biznes dhe në kërkim shkencor e projekte për zhvillim të qëndrueshëm.³⁷ Harmonizimi me fushën e biznesit i jep mundësi programit "Bachelor" në "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi" që të zhvillohet më tej në cikle më të larta që do t'a integronin programin me</p>

³⁶ Evidenca nr. 20: CV e stafit të angazhuar në programin "Bachelor" në "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi"

³⁷ Evidenca nr. 21: Organigrama e Fakultetit të Teknologjisë dhe Biznesit

	ekonominë, biznesin, menaxhimin e sistemit bankar dhe financiar.			
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Programi “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” nuk është program ndërdisiplinor dhe fusha e tij e teknologjisë së informacionit është në përputhje të plotë me fushën akademike dhe kërkimore që mbulon Departamenti i Shkencave Kompjuterike. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” përputhet me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, e cila është përgjegjëse për këtë program, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit, sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Departamenti i Shkencave Kompjuterike vepron si njësi bazë mësimore-kërkimore, që përfshin fusha kërkimi homogjene në disiplinën e shkencave kompjuterike dhe teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit. Hartimi i programit të studimit është në përputhje me kodifikimin e programit të studimit sipas klasifikimeve kombëtare mbështetur në Ligjin nr. 80/2015, akteve nënligjore përkatëse, si dhe direktivave e udhëzimeve Europiane.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

Standardi I.5	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Programi “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” në këto vite të para të tij si program, e ka pasur të domosdoshme jo vetëm mbështetjen institucionale, por dhe bashkëpunimin me njësi të tjera brenda institucionit. Janë organizuar një seri mbledhjesh dhe takimesh në nivel rektorati, njësie kryesore dhe njësie bazë që i janë kushtuar përmirësimit dhe nxitjes së dinamikës së punëve në Departamentin e Shkencave Kompjuterike. ³⁸ Janë parë me përparësi kërkesat e departamentit për mbështetje me bazë laboratorike, rekrutimin e stafit akademik, krijimin dhe stabilizimin e lidhjeve me kompani dhe biznese të fushës së teknologjisë dhe programimeve kompjuterike, organizimin e aktiviteteve ekstrakurrikulare me studentë të departamentit, analizën e punës së bërë për programin, etj. Departamenti i Shkencave Kompjuterike ndjek një praktikë të vazhdueshme bashkëpunimi me njësitë akademike dhe administrative për të siguruar mbarëvajtjen e punës në drejtim të zbatimit të programit të studimit “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”. Në fillim të çdo viti akademik, realizohet ndarja e detyrave dhe koordinimi mes personelit akademik të departamentit duke përcaktuar qartë përgjegjësitë në këshillimin akademik, realizimin e koordinimit me njësitë dhe zyrat administrative dhe mbikëqyrjen e aktiviteteve shkencore dhe ekstrakurrikulare. ³⁹ Në këtë mënyrë, Këshilli i Departamentit përcakton këshilltarët akademikë për çdo grup studentësh, përfaqësuesin e

³⁸ Evidenca nr. 22: Vendim i Këshillit të Departamentit për miratimin e planit të aktiviteteve, viti akademik 2020-2021

³⁹ Evidenca nr. 23: Vendimi i Këshillit të Departamentit për caktimin e përfaqësuesit pranë Zyrës së Planifikimit të Karrierës

	departamentit në Zyrën e Planifikimit të Karrierës dhe Zyrën e Marrëdhënieve Ndërkombëtare. ⁴⁰
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.	<p>Në funksion të realizimit të objektivave të programeve studimore, Kolegji Universitar “Bedër” ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit, si dhe me aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.</p> <p>KU “Bedër” ndjek një politikë favorizuese për lëvizshmërinë e personelit akademik dhe të studentëve me institucionet arsimore të huaja, me të cilat ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për organizimin e përbashkët të konferencave ndërkombëtare, projekteve të përbashkëta kërkimore dhe për trajnime profesionale e praktika studentore. Më konkretisht, në këtë drejtim janë firmosur marrëveshje bashkëpunimi me universitete në disa vende të Europës, si Rumania, Kroaci, etj., që mundësojnë përfshirjen e studentëve në programe shkëmbimi.⁴¹ Njëkohësisht, në kuadër të kësaj fryme bashkëpunimi, është mundësuar firmosja e memorandumeve të bashkëpunimit me kompani të ndryshme që operojnë në fushën e teknologjisë së informacionit dhe shkencave kompjuterike.⁴²</p> <p>Programi “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” ka zhvilluar gjatë këtyre viteve nga licensimi i tij aktivitete për mësimdhënien cilësore në bashkëpunim me partnerët e tjerë. Veçojmë këtu ligjëratat e përbashkëta nga lektorët tanë dhe amerikanë në kursin e Analizës Matematike, me pjesëmarrjen e studentëve të programit “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”, (Bedër), dhe studentëve nga Universiteti i Wiskonsin (Oshkosh), SHBA, shkëmbimin e eksperiencave me lektorë të universitetit Epoka, bisedat virtuale me profesorë italianë të shkencave kompjuterike pranë Universitetit Torre Vergata, Romë, Webinare të tilla si ato të mbajtura nga profesionistë të fushës, zhvillues software, specialistë të LinkedIn, etj.⁴³</p> <p>Veç kësaj, departamenti ka organizuar dy workshope studentore në nivel departamenti dhe një numër të madh referimesh profesionale në nivel fakulteti, ku kanë prezantuar para personaliteteve të fushës së IT-së⁴⁴, sigurisë kibernetike, data mining, etj., nga Tirana, institucione të rëndësishme qendrore dhe nga qytete të tjera të vendit. Bashkëpunim i rëndësishëm është edhe ai me institucione të sistemit parauniversitar përmes organizimit të Konkursit Kombëtar të IT-së.⁴⁵</p>
Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	<p>Të gjitha bashkëpunimet e mësipërme janë dokumentuar në raportet e mbledhjeve të Departamentit të Shkencave Kompjuterike, si dhe në raportet vjetore, që i përcillen Rektoratit.⁴⁶</p> <p>Departamenti i Shkencave Kompjuterike, ashtu si njësitë e tjera, në mënyrë të përvitshme harton raportin vjetor, të cilin e dorëzon pranë Rektorit. Pjesë e këtij raporti vjetor është dhe analiza vjetore e punës akademike, kërkimore dhe bashkëpunimi me aktorët e jashtëm në kuadër të procesit mësimor dhe formues. Raporti vjetor përmban gjithashtu edhe një analizë të detajuar në formatin SWOT, e cila realizohet përmes një punë bashkëpunuese të personelit akademik, duke synuar identifikimin e</p>

⁴⁰ Evidenca nr. 24: Vendimi i Këshillit të Departamentit për caktimin e këshilltarit akademik

⁴¹ Evidenca nr. 25: Marrëveshje bashkëpunimi në kuadër të Erasmus me Universitete në Rumania dhe Kroaci

⁴² Evidenca nr. 26: Lista e bashkëpunimeve dhe MOU

⁴³ Evidenca nr. 27: Raporti i aktiviteteve të zhvilluara ndër vite

⁴⁴ Evidenca nr. 27: Raporti i aktiviteteve të zhvilluara ndër vite, seminare dhe webinar-e

⁴⁵ Evidenca nr. 28: Përshkrim rreth Konkursit Kombëtar të IT-së

⁴⁶ Evidenca nr. 29: Komunikim shkresor i Zyrës së Planifikimit të Karrierës me institucionet e zhvillimit të praktikave profesionale

	pikave të forta, elementëve që duhen përmirësuar, mundësive dhe risqeve, me të cilat mund të përballet departamenti në çdo vit akademik. ⁴⁷			
Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.	<p>KU “Bedër”, veçanërisht Departamenti i Shkencave Kompjuterike u kushton rëndësi të veçantë praktikave profesionale sipas programeve përkatëse. Prandaj, gjatë vitit akademik, studentët nxiten dhe iu ofrohet mundësia të ndjekin praktika profesionale pranë institucioneve, organizatave dhe bizneseve të ndryshme me të cilat departamenti dhe universiteti kanë marrëveshje bashkëpunimi.⁴⁸</p> <p>Studentët e programit “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”, gjatë dy viteve të para të funksionimit të programit iu nënshtruan aftësimit praktik në institucione shtetërore dhe private, nën monitorimin dhe mentorimin e lektorëve të departamentit. Kompanitë dhe bizneset u zgjodhën në përputhje me interesat e studentëve, pasi studentët kishin shprehur kërkesat e tyre përmes formularëve përkatës.⁴⁹</p> <p>Deri tani janë 10 kompani private dhe institucione shtetërore me të cilat Departamenti i Shkencave Kompjuterike ka konsoliduar bashkëpunime në formën e praktikave profesionale dhe/ose internshipe, si: Big Media Expert, ATOM Computers, Agjencia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike,⁵⁰ etj. Studentët, të cilët kanë zgjedhur si specializim të fushës së tyre IT Help Desk, Network Administrator dhe System Administrator, kanë ndjekur në vijueshmëri praktikën përkatëse.</p>			
Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkëpunim me punëdhënësit.	<p>KU “Bedër” duke u bazuar në nevojat e tregut në vend, rajon dhe më gjerë, nxit frymën e formimit të vazhdueshëm dhe trajnimet profesionale “in service”. Në këtë kuadër, zyrat përkatëse dhe departamentet ofrojnë një varg metodash dhe modulesh që synojnë zhvillimin e mëtijshëm profesional për studentët tanë në vijim të studimeve të tyre apo edhe pas diplomimit.</p> <p>Përsa i përket programit “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” janë zhvilluar një sërë seminaresh dhe trajnimesh të tjera profesionale. Vlen këtu për t’u përmendur edhe workshop-et e ndryshme të organizuara nga institucioni në bashkëpunim me punëdhënësit të ndryshëm me qëllim formimin e studentëve në përputhje me kërkesat aktuale të tregut të punës, si dhe vizitat studimore në kompani të ndryshme.⁵¹</p> <p>Programi “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” është në vitin e fundit që paraprind diplomimin e studentëve, por së shpejti krahas Workshop-eve të organizuara me profesionistë të fushës, planifikohet që të ngrihen programe për aftësimin e mëtijshëm të studentëve të diplomuar. Departamenti i Shkencave Kompjuterike në bashkëpunim me kompaninë ATOM Computers po planifikon hapjen e Qendrës së Certifikimeve, e cila synon trajnimin në fusha specifike kompjuterike, nënshtrimin ndaj provimit përkatës rigoroz të monitoruar dhe marrjen e certifikimit përkatës ndërkombëtar.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

⁴⁷ Evidenca nr. 30: Raporti Vjetor i Departamentit të Shkencave Kompjuterike, viti akademik 2019-2020





⁴⁸ Evidenca nr. 29: Komunikim shkresor i Zyrës së Planifikimit të Karrierës me institucionet e zhvillimit të praktikave profesionale

⁴⁹ Evidenca nr. 31: Formular aplikimi për zhvillimin e praktikës profesionale

⁵⁰ Evidenca nr. 26: Lista e bashkëpunimeve dhe MOU

⁵¹ Evidenca nr. 27: Raporti i aktiviteteve të zhvilluara ndër vite, vizita të studentëve në kompani të ndryshme

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				√

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Plani mësimor i programit të studimit “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” është i organizuar në lëndë bazë të detyrueshme, lëndë karakterizuese, lëndë ndërdisiplinore, detyrime përmbyllëse ⁵² dhe module, në përputhje të plotë me legjislacionin vendas në fuqi, si edhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). ^{53 54}
Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh.	<p>Programi i studimit “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” me anë të një kurrikule të përgatitur, duke marrë në konsideratë përvojën e disa prej universiteteve më të njohura që ofrojnë këtë program studimi dhe i orientuar nga kërkesat e tregut të punës ofron një larmishmëri të gjerë profesionesh dhe specialitetesh.</p> <p>Programi i studimit “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” ka si synim kryesor të përgatisë studentët me njohuri bazë aplikative në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, si dhe në disiplina mbështetëse, të formojë specialistë me kompetenca të zgjedhura praktike në fushat e implementimit të sistemeve informatike si dhe të operojnë si specialistë në lidhje me nevojat e teknologjisë së informacionit në sektorin publik dhe/ose privat.</p> <p>Të diplomuarit nga ky program studimi mund të punësohen në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • zhvillues të aplikacioneve mobile; • administrues të të dhënave; • zhvillues Web; • administrues të rrjeteve; • specialist IT për çështje të sigurisë; • krijues i software-ve të ndryshme, pranë institucioneve në sektorin publik dhe privat; • zbatues i sistemeve të informacionit për palë të treta; në telekomunikacion, në sistemin bankar, sistemin shëndetësor, sistemin e transportit, biznesin elektronik; • menaxhues i sistemeve të informacionit, analistë të suportit kompjuterik, menaxhues të sistemeve të rrjetit, administrues i bazave të të dhënave, etj.⁵⁵
Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuara në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive	Programi i studimit “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” jep njohuri të thelluara në fushën e studimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit duke përfshirë të kuptuarit kritik të

⁵² Evidenca nr. 12: Rregullorja e programit “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”, neni 16

⁵³ Evidenca nr. 16: Rregullorja Themelore, neni 55

⁵⁴ Evidenca nr. 12: Rregullorja e programit “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”, neni 11

⁵⁵ Evidenca nr. 32: Shtojca për “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”, “KËRKESË PËR HAPJEN DHE/OSE ORGANIZIMIN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT”, pika 2.c

dhe parimeve akademike të fushës.	<p>teorive dhe parimeve bazë akademike.</p> <p>Objektivat kryesore formuese të këtij programi janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> të fituarit e një kulture bazë inxhinierike në shkencat e formimit të përgjithshëm dhe të formimit themelor specifik; aftësimin e studentëve në analizimin kritik të sistemeve të biznesit, me qëllim përmirësimin e tyre me anën e sistemeve të informacionit; aftësimin e studentëve për të komunikuar qartësisht me shkrim apo nëpërmjet prezantimeve konceptet teknike; përgatitjen e studentëve me aftësitë e nevojshme të komunikimit për integrim në skuadra pune në sektorë multidisiplinare; përfshirjen e studentëve në realizimin e aktiviteteve mësimore të lidhura ngushtë me veprimtarinë praktike, duke marrë pjesë në projekte kombëtare e ndërkombëtare dhe duke qenë partnerë me homologë të huaj.⁵⁶
Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	<p>Programi i studimit “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” synon të zhvillojë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fushën e studimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme.</p> <p>Ndër synimet kryesore të programit mund të përmendim:</p> <ul style="list-style-type: none"> përgatitjen e studentëve me njohuritë bazë mbështetëse teorike dhe praktike në funksion të teknologjisë së informacionit; njohjen e studentëve me teknologjitë konkrete që përdoren së fundmi në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit; njohjen e studentëve me bazat e konceptimit dhe implementimit të hardware-ve mbështetës të sistemeve informatike; të fituarit e një kulture bazë inxhinierike në shkencat e formimit të përgjithshëm dhe të formimit themelor specifik.⁵⁷
Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.	<p>Programi i studimit “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore, siç janë të dhënat e përgjithshme të programit, objektivat formuese, dhe karakteristikat e programit të studimit, njohuritë dhe kompetencat e studentëve në përfundim të programit mësimor, plani mësimor i detajuar, veprimtaria formuese, modulet, si dhe syllabuset për çdo lëndë.⁵⁸</p>
Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	<p>Veprimtaria formuese e programit është e përcaktuar qartësisht duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite. Përqindja totale e lëndëve sipas kategorive është si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> lëndët bazë kanë një peshë 20%, lëndët karakterizuese 54%, lëndët ndërdisiplinore 12%,

⁵⁶ Evidenca nr. 32: Shtojca për “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”, “KËRKESË PËR HAPJEN DHE/OSE ORGANIZIMIN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT”, pika 2.a

⁵⁷ Evidenca nr. 32: Shtojca për “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”, “KËRKESË PËR HAPJEN DHE/OSE ORGANIZIMIN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT”, pika 2.b

⁵⁸ Evidenca nr. 32: Shtojca për “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”, “KËRKESË PËR HAPJEN DHE/OSE ORGANIZIMIN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT”

	<ul style="list-style-type: none"> • lëndët plotësuese 10%, <p>dhe detyrimet përmblylëse kanë 4%, të veprimtarisë formuese, e cila është sipas ligjeve dhe udhëzimeve në fuqi, si dhe vendimeve të Këshillit të Ministrave:</p> <p>VKM Nr. 41, Datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” (e ndryshuar).⁵⁹</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Fakulteti i Teknologjisë dhe Biznesit si njësi kryesore ka në përbërjen e tij dhe 3 njësi bazë, të cilat ofrojnë një game të gjerë akademike të programeve të studimit.⁶⁰</p> <p>Fakulteti i Teknologjisë dhe Biznesit, si njësi kryesore, dhe Departamenti i Shkencave Kompjuterike, si njësi bazë, disponojnë një strukturim organizativ në çdo shkallë të hierarkisë duke iu përshtatur nevojave të programit të studimit dhe përmbushin detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.⁶¹</p>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinatori i programit informon vazhdimisht titullarin e njësiesë përkatëse.	<p>Departamenti i Shkencave Kompjuterike, si njësi bazë, me vendim të Këshillit të Departamentit zgjedh koordinatorin e programit të studimit.</p> <p>Koordinatori i programit të studimit është funksion ndihmës akademik me karakter administrativ. Ai kryen detyrat e ngarkuara dhe merr masat e nevojshme në funksion të mbarëvajtjes së programit.⁶²</p>
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	<p>Fakulteti i Teknologjisë dhe Biznesit si njësi kryesore dhe Departamenti i Shkencave Kompjuterike si njësi bazë për programin e studimit “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” përmbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p> <p>Si njësi kryesore Fakulteti i Teknologjisë dhe Biznesit përbëhet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Departamenti i Shkencave Kompjuterike • Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit • Qendra për Zhvillim të Qendrueshëm dhe Inovacion⁶³ <p>Departamenti i Shkencave Kompjuterike si njësi bazë aktualisht ofron:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 2 (dy) programe studimi me kohë të plotë në Ciklin e Parë të Studimeve, “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”, si dhe “Bachelor” në “Shkenca Kompjuterike”

⁵⁹ Evidenca nr. 12: Rregullorja e programit “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”, neni 16

⁶⁰ Evidenca nr. 5: Urdhër nr. 200, datë 3.7.2020 “Për riorganizimin e njësive kryesore të Kolegjit Universitar “Bedër”

⁶¹ Evidenca nr. 33: Organigrama e Kolegjit Universitar “Bedër”

⁶² Evidenca nr. 34: Vendimi për caktimin e Koordinatorit të Programeve Bachelor, viti akademik 2020-2021

⁶³ Evidenca nr. 33: Organigrama e Kolegjit Universitar “Bedër”

<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • 1 (një) program studimi profesional dy vjeçar “Programim në Web” <p>Stafi akademik i Fakultetit të Teknologjisë dhe Biznesit është i përbërë nga 21 anëtarë personel akademik efektiv, ku 1 anëtar është me titullin Prof.Asoc. Dr., 8 anëtarë janë me gradën shkencore “Doktor i Shkencave”, 1 anëtar në proces doktorature dhe 11 anëtarë janë me gradën “Master i Shkencave”. Ndërsa, Departamenti i Shkencave Kompjuterike, si njësi bazë ka në përbërjen e tij tre anëtarë me Gradën Shkencore “Doktor i Shkencave” 1 anëtar në proces doktorature dhe 3 anëtarë me gradën “Master i Shkencave”, duke përbushur detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.⁶⁴</p>								
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Nga sa më sipër, rezulton se njësia kryesore dhe ajo bazë përgjegjëse për programin e studimit “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” i përbushin detyrimet ligjore për organizimin dhe strukturën akademike. Në përputhje me rregullimet ligjore dhe nënligjore në fuqi në strukturën akademike të fakultetit janë dy departamente dhe një qendër kërkimore zhvillimore përkatësisht Departamenti i Shkencave Kompjuterike, Departamenti i Ekonomisë dhe Biznesit dhe Qendra për Zhvillim të Qendrueshëm dhe Inovacion. Gjithashtu, në përbushje të detyrimeve ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike në përbërje të secilës njësi bazë janë të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 janë me grada dhe tituj. Një përshkrim i detajuar i organigramës së njësive kryesore dhe anëtarëve me kohë të plotë të njësive bazë gjenden në tabelat dhe evidencat bashkëngjitur këtij raporti.^{65 66}</p>								
<p>Shkalla e përbushjes së standarditë</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="644 958 799 1037">Nuk përbushet</th> <th data-bbox="799 958 1015 1037">Përbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="1015 958 1230 1037">Përbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1230 958 1441 1037">Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="644 1037 799 1093"></td> <td data-bbox="799 1037 1015 1093"></td> <td data-bbox="1015 1037 1230 1093"></td> <td data-bbox="1230 1037 1441 1093">√</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				√
Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			√						

⁶⁴ Shtojca nr. 1: Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë: Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), tituj/gradat; Personeli ndihmës Akademik dhe Administrativ (PNA dhe PA) (Tabelat 1 dhe 2)

⁶⁵ Evidenca nr. 21: Organigrama e Fakultetit të Teknologjisë dhe Biznesit

⁶⁶ Evidenca nr. 35: Rregullorja e Fakultetit të Teknologjisë dhe Biznesit

Standardi II.3

Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Fakulteti i Teknologjisë dhe Biznesit dhe Departamenti i Shkencave Kompjuterike disponojnë informacionin e duhur për strukturën, përmbajtjen dhe procedurat për mirëfunksionimin e programit të studimit "Bachelor" në "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi", i cili menaxhohet nëpërmjet administratorit të fakultetit ⁶⁷ dhe koordinatorit të departamentit. ⁶⁸
Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	Siç është përmendur dhe më sipër, programi i studimit "Bachelor" në "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi" është i organizuar në lëndë, module, praktikë e objektiva formues. Programi i studimit është i ndërtuar me lëndë të kategorive A, B, C, D dhe E në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. ⁶⁹
Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	Plani mësimor i programit të studimit "Bachelor" në "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi" ⁷⁰ i ka të gjitha lëndët të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendas e evropian, të ndara në vite akademike dhe semestra. Programi i ciklit të parë të studimit "Bachelor" në "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi" zgjat 3 (tre) vite akademike, të ndarë në 6 (gjashtë) semestra. Programi përbëhet nga 180 kredite ECTS, ku për çdo vit parashikohen 60 ECTS, të ndara në 30 ECTS për çdo semestër.
Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.	Në planin mësimor të programit të studimit "Bachelor" në "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi" ⁷¹ paraqiten në formë të detajuar informacionet për ngarkesën mësimore, orët në/dhe jashtë auditorit. Sipas rregullores së programit të studimit "Bachelor" në "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi" ⁷² studenti ka detyrimin të ndjekë të paktën 70% të lëndëve teorike dhe të paktën 80% të punëve laboratorike. Studentët të cilët nuk përmbushin këto norma nuk hyjnë në provimin përfundimtar semestral. Mënyra e vlerësimit të dijeve është e përcaktuar qartësisht për çdo lëndë në syllabusin e saj ⁷³ dhe e publikuar paraprakisht në faqen e web-it të programit të studimit (https://cmp.beder.edu.al/sh/content/default/bachelor-ne-teknologji-informacioni-dhe-komunikimi-19/616/617).
Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me	Pranimi dhe regjistrimi ⁷⁴ i studentëve në programin e studimit "Bachelor" në "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi", transferimi ⁷⁵ ⁷⁶ , si dhe ekuivalentimi i studimeve ⁷⁷ ⁷⁸ janë parashikuar në rregulloren e përgjithshme

⁶⁷ Evidenca nr. 17: Rregullorja mbi Organizimin Akademik, Neni 38

⁶⁸ Evidenca nr. 17: Rregullorja mbi Organizimin Akademik, Neni 39

⁶⁹ Evidenca nr. 12: Rregullorja e programit "Bachelor" në "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi", neni 16

⁷⁰ Evidenca nr. 12: Rregullorja e programit "Bachelor" në "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi", neni 16

⁷¹ Evidenca nr. 12: Rregullorja e programit "Bachelor" në "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi"

⁷² Evidenca nr. 12: Rregullorja e programit "Bachelor" në "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi", neni 18, pika d

⁷³ Evidenca nr. 19: Shembull syllabusi (<https://cmp.beder.edu.al/sh/content/default/bachelor-ne-teknologji-informacioni-dhe-komunikimi-16/616/617/?con=0&cid=4470&t=1&oid=3835>)

⁷⁴ Evidenca nr. 12: Rregullorja e programit "Bachelor" në "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi", neni 5

⁷⁵ Evidenca nr. 12: Rregullorja e programit "Bachelor" në "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi", neni 9

⁷⁶ Evidenca nr. 12: Rregullorja e programit "Bachelor" në "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi", neni 9

⁷⁷ Evidenca nr. 12: Rregullorja e programit "Bachelor" në "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi", nenet 4 dhe 9

⁷⁸ Evidenca nr. 12: Rregullorja e programit "Bachelor" në "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi", neni 9

<p>kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>të programit të studimit, si dhe në rregulloren e transferimit të studimeve.</p> <p>Kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit për programin e studimit “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”, propozohen nga departamenti⁷⁹ dhe miratohen nga Senati Akademik, i cili brenda periudhës së përcaktuar nga ministria përgjegjëse për arsimin, dërgon në MASR, QSHA dhe RASH kriteret e pranimit për programin e studimit. Kriteret publikohen në portalin U-Albania dhe në faqen zyrtare KU “Bedër”, të cilat janë të aksesueshme nga të gjithë të interesuarit.⁸⁰</p>			
<p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Në çdo program të lëndëve të programit të studimit “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” janë të paraqitura qartësisht të gjitha informacionet e nevojshme si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • titullari i lëndës, • tipologjia e lëndës sipas klasifikimeve dhe llojin në kurs të detyrueshëm apo me zgjedhje, • përmbledhjen dhe rezultatet e të nxënit; • konceptet themelore; • numri i orëve të leksioneve, seminarëve, punëve të laboratorit, praktikave të ndryshme, • puna e pavarur e studentëve, ngarkesa brenda dhe jashtë auditorit për projekte të ndryshme, • konceptet kryesore dhe tematikat që do të trajtohen • format e frekuentimit dhe kontrollit të dijeve dhe mënyrat e vlerësimit dhe pikëzimit të studentit, sipas formatit të miratuar nga VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, (i ndryshuar) Shtojca Nr.3⁸¹ 			
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Kompjuterike në fillim të çdo viti akademik, ndjek rishikimin dhe përditësimin e syllabuseve, për programin e studimit “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”, të hartuara nga titullarët e lëndëve për përmirësim të vazhdueshëm të lëndëve.</p> <p>Gjithashtu, për përmirësimin e programit të studimit nga njësia bazë janë propozuar disa ndryshime në kurrikulën e programit të studimit dhe janë miratuar nga Senati Akademik brenda kuadrit ligjor të lejuar.⁸²</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p style="text-align: center;">√</p>

⁷⁹ Evidenca nr. 17: Rregullorja mbi Organizimin Akademik, neni 8, pika 3

⁸⁰ Evidenca nr. 36: Vendimi i Senatit Akademik për miratimin e kriterëve të pranimit të studentëve në programin “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”

⁸¹ Evidenca nr. 37: Syllabuset e lëndëve për programin e studimit “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”

⁸² Evidenca nr. 38: Praktika e ndryshimit në kurrikul

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Ngarkesa mësimore e programit të studimit “Bachelor” në “Teknologji Informativ dhe Komunikim” është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi. Në total, ky plan mësimor ka një ngarkesë 4500 orë mësimore dhe përbëhet nga 180 ECTS, ku 1 ECTS është i barabartë me $4500/180=25$ Orë Mësimore.
Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.	Plani mësimor i këtij programi studimi është realizuar duke marrë në konsideratë përvojat më të mira të universiteteve publike dhe private brenda dhe jashtë vendit. Plani mësimor i këtij programi studimi është i ndarë në 6 semestra me nga 30 ECTS secili. Emërtimi, përmbajtja e njohurive për secilën lëndë, shpërndarja e ngarkesës mësimore teorike dhe praktike, si dhe praktikat e ndryshme brenda dhe ekstakurrikulare ju mundëson studentëve njohuri teorike dhe praktike për kalimin sa më me lehtësi nga auditorët në tregun e punës. ⁸³
Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.	Siç u përmend dhe më sipër, plani mësimor i këtij program studimi është i ndarë në 6 semestra me nga 30 ECTS ose 750 orë mësimore secili, ku një ECTS është e barabartë me $750/30=25$ orë mësimore. Ngarkesa mësimore në auditore për çdo javë nga semestri i parë deri në semestrin e tretë është 22.5 orë, për semestrat 4 dhe 5 është 18.75 orë, ndërsa për semestrin e fundit është 16.87 orë në javë. Në këtë plan mësimor rëndësi e veçantë i kushtohet edhe përgatitjes praktike profesionale të studentëve, ku nga ngarkesa totale mësimore javore, ngarkesa mësimore praktike për çdo javë nga semestri i parë deri në semestrin e tretë është 5.62 orë, për semestrat 4 dhe 5 është 9.37 orë, ndërsa për semestrin e fundit është 11.25 orë në javë. ^{84 85} Nga sa më sipër, vihet re lehtësisht se me kalimin e semestrave pesha e ngarkesës mësimore praktike në auditore rritet deri në masën 67% të ngarkesës totale mësimore në auditore çka mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit për aftësimin profesional të tyre.
Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Përqindjet e kategorive të ndryshme të ngarkesës mësimore kundrejt ngarkesës totale të këtij programi studimi janë si më poshtë: <ul style="list-style-type: none">• 27% Leksione• 5% Seminare• 12% Punë Laboratorike dhe Praktika Mësimore• 57% Punë Individuale⁸⁶ Ashtu siç përmendet dhe më sipër, një rëndësi e veçantë në këtë program studimi i kushtohet edhe formimit praktik veçanërisht në kategorinë e

⁸³ Evidenca nr. 29: Komunikim shkresor i Zyrës së Planifikimit të Karrierës me institucionet e zhvillimit të praktikave profesionale

⁸⁴ Shtojca nr. 2: Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E) (Tabela 9)

⁸⁵ Shtojca nr. 3: Plani mësimor sipas modelit të Tabelës 10

⁸⁶ Shtojca nr. 4: Ngarkesa totale në auditore të studentëve për format e mësimdhënies në programin e studimit, për secilin program (Tabela 13)

	lëndëve karakterizuese.
Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	<p>Raportet e ndarjes së veprimtarisë formuese të planit mësimor të programit të studimit “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” sipas kategorive janë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • LËNDËT BAZË – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme (A) përbëjnë 20% të totalit të krediteve të programit të studimit; • LËNDËT KARAKTERIZUESE – përgatitje për disiplinën shkencore (B) përbëjnë 54% të totalit të krediteve të programit të studimit; • LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUESE – nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje (C) përbëjnë 12% të totalit të krediteve të programit të studimit; • LËNDË PLOTËSUESE – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale (D) përbëjnë 10% të totalit të krediteve të programit të studimit; • DETYRIME PËRMBYLLËSE (E) përbëjnë 4% të totalit të krediteve të programit të studimit;⁸⁷ <p>Përçindja e ngarkesës mësimore në auditore për formimin teorik kundrejt ngarkesës totale të planit mësimor të këtij programi studimi është 27% dhe ngarkesa mësimore në auditore për formimin praktik kundrejt ngarkesës totale është 17%, ndërsa raporti midis formimit teorik dhe praktik në auditore është 0.625, gjë e cila mundëson realizimin e objektivave formues, çka u mundëson studentëve transferimin e studimeve në një program tjetër studimi brenda dhe jashtë vendit, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.⁸⁸</p>
Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.	Në fillim të çdo semestri të çdo viti akademik pedagogu i lëndës është i detyruar të ngarkojë në sistemin informatik Bedër Information System (BIS) programin e lëndës që jep, bashkë me përditësimet e nevojshme duke përcaktuar qartësisht literaturën e detyruar dhe literaturën ndihmëse të 5 viteve të fundit, gjithashtu programi i lëndës dorëzohet edhe pranë koordinatorit të departamentit.
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësi dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.	Emërtimi dhe përmbajtja e lëndëve të programit të studimit “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” është realizuar duke marrë në konsideratë përvojat më të mira pozitive të disa prej universiteteve më me eksperiencë në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, çka garanton përfitim të dijeve, aftësi dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë. ⁸⁹
Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Gjithashtu, përmbajtja e këtij programi është realizuar në një formë të tillë që t’u mundësojë studentëve të këtij programi edhe studime të ciklit të dytë, po ashtu edhe punësimin e tyre duke marrë në konsideratë pritshmëritë dhe kërkesat e tregut e punës. ⁹⁰
Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat	Për të realizuar përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”, si dhe për të realizuar sa më mirë pritshmëritë dhe nevojat e tregut të punës, këshilltari i karrierës në bashkëpunim me Zyrën e Planifikimit të Karrierës organizon

⁸⁷ Shtojca nr. 2: Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E) (Tabela 9)

⁸⁸ Evidenca nr. 12: Rregullorja e programit “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”, neni 16

⁸⁹ Evidenca nr. 12: Rregullorja e programit “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”, neni 16

⁹⁰ Shtojca nr. 3: Plani mësimor sipas modelit të Tabelës 10

<p>përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>takime të vazhdueshme me bashkëpunëtorë dhe partnerë të ndryshëm nga tregu i punës.⁹¹ Zyra e Planifikimit të Karrierës organizon gjithashtu takime të studentëve me bashkëpunëtorë dhe partnerë të ndryshëm nga tregu i punës për t'i orientuar rreth kërkesave dhe pritshmërive të punëdhënësve eventuale të mundshëm.⁹²</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				√

⁹¹ Evidenca nr. 17: Rregullorja mbi Organizimin Akademik, neni 41

⁹² Evidenca nr. 27: Raporti i aktiviteteve të zhvilluara ndër vite

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përbushin kërkesat ligjore në fuqi.	Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjet në realizimin e programit të studimit, si dhe përbushin kërkesat ligjore në fuqi. ⁹³
Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.	Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që janë të angazhuar në realizimin e programit të studimit “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për mbulimin dhe realizimin me sukses të moduleve mësimore të programit të studimit. Kjo vërtetohet nga përputhja midis kualifikimeve të tyre dhe lëndëve ku ata janë të angazhuar. Përgjegjësi i Departamentit të Shkencave Kompjuterike ka fituar titullin “Doktor” pranë Universitetit të Dakotës së Veriut, ShBA.
Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.	Niveli i kualifikimit të anëtarëve dhe profile i personelit akademik që mbulon programin e studimit “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” është në përputhje me programin e studimit, kryesisht në profilet: Inxhinieri Kompjuterike, Inxhinieri Kompjuterike dhe Informatike, Informatikë, Matematikë, Fizikë, etj., në përputhje të plotë me natyrën dhe specifikën e moduleve që ata mbulojnë. ⁹⁴
Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Kolegji Universitar “Bedër” ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi, kompani të ndryshme në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, si dhe institucione publike të ndryshme. ⁹⁵ Gjithashtu, nën varësinë e Dekanit të Studentëve në Kolegjin Universitar “Bedër” funksionon dhe Zyra e Planifikimit të Karrierës, ku ndër detyrat kryesore janë: <ul style="list-style-type: none">• Zhvillimi i aktiviteteve të cilat kanë si qëllim afrimin e institucioneve të sektorit privat ose publik me studentët aktualë ose të diplomuar, të cilët përbëjnë burime njerëzore të mirëkualifikuara.• Organizimi i takimeve prezantuese të studentëve të diplomuar dhe institucioneve të sektoreve të ndryshme për informimin e studentëve me profesionet përkatëse, eksperiencat e punës dhe mundësitë e karrierës, si dhe ndërtimin e urave lidhëse midis KU “Bedër” dhe tregut të punës. Gjithashtu, në fillim të çdo viti akademik, çdo departament zgjedh një këshilltar karriere me vendim të Këshillit të Departamentit pranë kësaj zyre,

⁹³ Shtojca nr. 1: Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë: Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat; Personeli ndihmës Akademik dhe Administrativ (PNA dhe PA) (Tabelat 1 dhe 2)

⁹⁴ Evidenca nr. 20: CV e stafit të angazhuar në programin “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”

⁹⁵ Evidenca nr. 26: Lista e bashkëpunimeve dhe MOU

	me qëllim që të ofrojë konsulencën e tij për studentët e Kolegjit Universitar "Bedër". ^{96 97}			
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Në institucionin tonë personeli ndihmës akademik ndahet në personel ndihmës-akademik me karakter mësimor dhe ndihmës-akademik me karakter administrativ. Personeli ndihmës-akademik me karakter mësimor ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies dhe/ose të kërkimit shkencor. Ai bën pjesë në stafin e njësisë bazë dhe shërben për mbështetjen e veprimtarive të kësaj të fundit. Në këtë kategori futen laborantët dhe teknikët, si dhe personel tjetër, sipas përcaktimeve të bëra në aktet e brendshme të institucionit. ⁹⁸			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

⁹⁶ Evidenca nr. 17: Rregullorja mbi Organizimin Akademik, neni 41

⁹⁷ Evidenca nr. 23: Vendimi i Këshillit të Departamentit për caktimin e përfaqësuesit pranë Zyrës së Planifikimit të Karrierës

⁹⁸ Evidenca nr. 17: Rregullorja mbi Organizimin Akademik, neni 9, pika 1.a

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1

Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.</p>	<p>Institucioni merr masa për sigurimin e mbarëvajtjes së planit mësimor për çdo program studimi. Rregullorja e programit përkatës është udhëzuesi i drejtpërdrejtë në lidhje me hartimin e planeve mësimore për secilin program dhe nxitjen e përdorimit të metodave të ndryshme bashkëkohore dhe inovative të mësimdhënies duke iu përshtatur fushës së studimit që i përket kualifikimit të studentëve, llojit dhe specifikave konkrete të lëndëve, rezultateve të mundshme me vlerë të shtuar që mund të sjellin metodat e reja në përgatitjen e studentëve.</p> <p>Gjithashtu, institucioni ka hartuar dhe në vazhdimësi harton udhëzues, manualë dhe organizon trajnime të vazhdueshme në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve, ku ndër të mund të përmendim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Udhëzuesi për përdorimin e sistemit Bedër Information System (BIS)⁹⁹ • Video udhëzuesi mbi përdorimin e platformës Google G-Suite • Guida e Stafit ¹⁰⁰ • Guida e Studentit ¹⁰¹ • Udhëzimi mbi funksionimin e Bibliotekës; etj.¹⁰² • Udhëzimi mbi mësimdhënien në distancë ¹⁰³
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Çështjet në lidhje me organizimin e mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit të ngarkesës mësimore, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm, përfshirja e studentëve në aktivitetet e njësisë shpjegohen në Rregulloren e Studimeve të Ciklit të Parë.¹⁰⁴</p> <p>KU “Bedër” është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies. Ky proces kontrollohet periodikisht nga strukturat e brendshme të institucionit, konkretisht nga “Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë” (NJSBC).</p> <p>Monitorimi dhe vlerësimi bëhet në mënyrë periodike dhe ofron të dhëna të rëndësishme për të kuptuar nivelin e aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik.</p> <p>Duke synuar garantimin e cilësisë në mësimdhënie, si edhe kualifikimet e</p>

⁹⁹ Evidenca nr. 39: Udhëzuesi i Sistemit Informativ Bedër (BIS)

¹⁰⁰ Evidenca nr. 40: Guida e Stafit

¹⁰¹ Evidenca nr. 41: Guida e Studentit

¹⁰² Evidenca nr. 42: Udhëzimi mbi funksionimin e Bibliotekës

¹⁰³ Evidenca nr. 43: Udhëzim mbi mësimdhënien në distancë

¹⁰⁴ Evidenca nr. 44: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë

	<p>personelit në fushën e kërkimit shkencor, KU “Bedër” gjatë kësaj periudhe ka organizuar disa trajnime, të arkivuara pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore, të propozuara nga NJSBC. Ndërkohë, për zhvillimin e këtyre standardeve, KU “Bedër” ka ngritur Komisionin e Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit. Për çdo departament, për të minimizuar ngarkesat administrative të personelit akademik, është caktuar një sekretar/koordinator që ndjek punët administrative të departamentit përkatës. KU “Bedër” vë në dispozicion infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve.</p> <p>Monitorimi dhe vlerësimi i aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës-akademik realizohet nëpërmjet anketimeve.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Institucioni zhvillon në fund të çdo semestri një anketë me të gjithë studentët në lidhje me lëndët përkatëse dhe lektorët e tyre. Nga anketa merret vlerësimi i studentit për: mbarëvajtjen e procesit mësimor, metodat e përdorura, aftësinë profesionale të pedagogut etj. Kjo anketë kryhet në diskrecion të plotë të studentëve.^{105 106}</p> <p>Në rast se studenti ka ankesa ndaj rezultatit përfundimtar të një provimi semestral, ai ka të drejtë që brenda një jave nga dita e publikimit të rezultateve të paraqesë një ankesë me shkrim pranë Zyrës së Sekretarisë Mësimore. Ankimi shqyrtohet mbi gabimet materiale, nga një komision i cili ngrihet me vendim të departamentit përkatës dhe përbëhet prej tre anëtarësh. Pedagogu i lëndës nuk mund të jetë pjesë e këtij komisioni. Vendimi i bëhet i ditur studentit jo më shumë se 15 ditë nga dita e paraqitjes së kërkesës për rishikim.¹⁰⁷</p> <p>Përveç kësaj është hartuar edhe një anketë e posaçme për mësimdhënien në kushtet e pandemisë COVID-19.¹⁰⁸</p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Siç u përmend dhe më sipër, struktura përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në KU “Bedër” është Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC). Kjo njësi bën të mundur monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, realizon anketa të ndryshme, si dhe bën shpërndarjen e rezultateve të anketimeve nëpërmjet zyrave përkatëse, njësive kryesore, Senatit Akademik apo Rektorit, nevojat për ndërhyrje në program, në burime njerëzore apo infrastrukturë me qëllim rritjen e efektshmërisë dhe cilësisë së programit.¹⁰⁹</p> <p>Publikimi i rezultateve të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të Kolegjit Universitar “Bedër” është i detyrueshëm. Raportet vjetore të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të Kolegjit Universitar “Bedër” dhe raporti i komisionit të vlerësimit dhe zhvillimit të cilësisë në arsimin e lartë publikohen në faqen e internetit.¹¹⁰</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Mekanizmat kryesorë të vlerësimit për personelin akademik janë:</p> <p>Formulari i Anketave vetëvlerësuese të stafit akademik ¹¹¹, – plotësohet nga personeli akademik dhe kontrollohet nga përgjegjësi i departamentit përkatës dhe ka për qëllim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të njohë progresin që ka pasur stafi akademik gjatë vitit të kaluar; • Të përcaktojë mënyrat nëpërmjet të cilave performanca e tyre mund

¹⁰⁵ Evidenca nr. 45: Rregullore e anketave dhe vlerësimeve, nenet 13 dhe 14

¹⁰⁶ Evidenca nr. 46: Anketa e studentit ndaj lëndës

¹⁰⁷ Evidenca nr. 12: Rregullorja e programit “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”, neni 27


¹⁰⁸ Evidenca nr. 47: Anketë, mësimdhënia në distancë

¹⁰⁹ Evidenca nr. 48: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC-së, neni 11

¹¹⁰ Evidenca nr. 48: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC-së, neni 18

¹¹¹ Evidenca nr. 45: Rregullore e anketave dhe vlerësimeve, nenet 3 dhe 14

	<p>të përmirësohet dhe zhvillohet për t'i shërbyer si individit edhe institucionit;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të mbështesë dhe zhvillojë qëllimet për vitin e ardhshëm; • Të rishikojë zhvillimin e karrierës; • Të përcaktojë fushat e trajnimit dhe zhvillimit në mënyrë që të përmbushë misionin dhe qëllimet; • Të përcaktojë treguesit e cilësisë në mësimdhënie, kërkim shkencor dhe publikime. <p>Një proces i tillë duhet të sjellë një përmirësim të vazhdueshëm dhe një zhvillim në performancën e individit dhe efektshmërinë e institucionit. Stafit akademik duhet të arrijë pritshmëritë e punës së tij dhe përmbushjen e qëllimeve të tij në të mirë të zhvillimit të interesave të institucionit.</p> <p>Anketa vlerësuese e studentit për stafin akademik ¹¹² ka për qëllim marrjen e informacionit në lidhje me cilësinë dhe metodat e mësimdhënies së stafit akademik, vlerësimit të dijeve ndaj studentëve të këtij institucioni.</p> <p>Anketa plotësohet nga studentët për çdo lëndë dhe pedagog. Të dhënat nga ky anketim janë të rëndësishme për politikat e ardhshme akademike dhe të mësimdhënies nga Kolegji Universitar "Bedër". Ky anketim zhvillohet 2 herë në çdo vit akademik në përfundim të semestrit.</p> <p>Rezultatet e anketimeve dhe vlerësimeve i komunikohen çdo pedagogu në zarf të mbyllur.</p> <p>Varësisht këtyre rezultateve, departamentet marrin masa për përmirësimin e mëtejshëm të këtyre metodave të mësimdhënies.</p> <p>Vlerësimi dhe promovimi i praktikave të mira bëhet nga eprorët në raportet vjetore të njësive të ndryshme akademike dhe administrative të institucionit dhe në takimet me personelin akademik dhe administrativ.</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="638 1108 790 1198">Nuk përmbushet</th> <th data-bbox="790 1108 1005 1198">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="1005 1108 1220 1198">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1220 1108 1457 1198">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="638 1198 790 1254"></td> <td data-bbox="790 1198 1005 1254"></td> <td data-bbox="1005 1198 1220 1254"></td> <td data-bbox="1220 1198 1457 1254">√</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				√
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			√						



Standardi III.2

Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive në Kolegjin Universitar “Bedër” janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit, projektet, orët e hapura të organizuara nga lektorët e lëndëve ose me të ftuar të jashtëm, etj. Format e mësimdhënies janë të parashikuara si në Rregulloren Themelore, ashtu edhe në Rregulloren e Ciklit të Parë të Studimeve. Në Rregulloren Themelore format e mësimdhënies janë pjesë e nenit 55 <i>Kuptimi i Kreditit ECTS</i>, ndërsa në Rregulloren e Studimeve të Ciklit të Parë është neni 11 <i>Kohëzgjatja e arsimimit, forma dhe gjuha</i>, ku parashtrohen format kryesore të mësimdhënies. Për të rregulluar edhe procesin e mësimdhënies online në kushtet e pandemisë COVID-19, në përputhje edhe me urdhërat e nxjerrë nga MASR dhe Ministria e Shëndetësisë, është hartuar edhe udhëzimi për mësimdhënien në distancë.^{113 114}</p> <p>Në lidhje me praktikat profesionale, institucioni i ka siguruar ato duke lidhur marrëveshje me kompani të ndryshme të fushës. Praktikrat profesionale fillojnë që nga semestri i parë i studimeve, deri në të fundit.¹¹⁵</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t’u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>Çdo anëtar i personelit akademik përpiqet t’u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe modulet e aktiviteteve formuese në veçanti.</p> <p>Për realizimin e këtyre synimeve janë organizuar leksione të hapura, vizita në institucione të ndryshme, Workshop-e, praktika profesionale brenda dhe jashtë institucionit, etj.¹¹⁶</p> <p>Nga ana tjetër, përfaqësues të studentëve janë pjesë e mbledhjeve periodike të Këshillit të Departamentit, duke sjellë në këto takime zërin e studentëve, propozimet, ankesat apo kërkesat specifike të studentëve në përgjithësi dhe në veçanti, të cilat merren në shqyrtim nga Këshilli i Departamentit duke i reflektuar në përmirësimin e formave dhe përshtatjen e metodave të mësimdhënies me mundësi alternative. Gjithashtu, personeli akademik i Departamentit të Shkencave Kompjuterike angazhohet për përmirësimin e njohurive dhe aftësive për t’ju përgjigjur nevojave të studentëve. Kolegji Universitar “Bedër” ofron mundësi për arsimimin e studentëve me aftësi ndryshe dhe garanton që arsimimi i tyre të jetë pjesë integrale e sistemit arsimor. Mosdiskriminimi i studentëve me aftësi ndryshe dhe garantimi i respektimit të parimit të barazisë, është një ndër parimet e rëndësishme të Kolegjit Universitar “Bedër”. Kolegji Universitar “Bedër” ka siguruar të gjitha facilitetet infrastrukturore dhe shërbimet mbështetëse, të projektuara në përputhje me nevojat e personave me aftësi ndryshe. Përshtatja dhe përditësimi i syllabuseve kalon nëpërmjet procesit të vlerësimit të cilësisë në mësimdhënie. Mekanizmi i anketimit dhe analizimi i të dhënave të dala</p>

¹¹³ Evidenca nr. 16: Rregullorja Themelore, neni 55 dhe neni 56

¹¹⁴ Evidenca nr. 43: Udhëzimi mbi mësimdhënien në distancë

¹¹⁵ Evidenca nr. 29: Komunikim shkresor i Zyrës së Planifikimit të Karrierës me institucionet e zhvillimit të praktikave profesionale

¹¹⁶ Evidenca nr. 27: Raporti i aktiviteteve të zhvilluara ndër vite

	janë gjithashtu një mënyrë efektive për të reflektuar nevojat e studentëve.
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të nxënësve, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.	Departamenti ka ndjekur një politikë aktive në bashkëpunimin me punëdhënësit potencialë për studentët që do të diplomohen nga ky program studimi i nivelit të parë. Kjo ka çuar në reflektimin e nevojave të tregut në procesin e mësimdhënës. Departamenti inkurajon stafin të përmirësojë aftësitë dhe kompetencat didaktike, në mënyrë që programi i studimit të jetë në përputhje me rezultatet e pritshme, objektivat formues dhe t'i përgjigjet sa më mirë nevojave të tregut të punës. ¹¹⁷ Është praktikë që çdo fillim viti të organizohen trajnime profesionale me në fokus përmirësimin e mësimdhënies, integrimin e teknologjisë në mësimdhënie apo ndërthurjen e kërkimit shkencor me mësimdhënien. Trajnime të tilla janë organizuar edhe në fillim vitin akademik 2019-2020 me tematika “ <i>Teknologjia në ndihmë të mësimdhënies cilësore në universitet</i> ”, si dhe “ <i>Përditësimi i syllabuseve si nevojë në vijueshmëri</i> ”.
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.	Kolegji Universitar “Bedër” synon të tërheqë një staf të kualifikuar, me grada e tituj shkencorë, në përputhje me synimet dhe standardet e përcaktuara në Planin Strategjik të institucionit. ¹¹⁸ Në përmbushje të nevojave për një staf akademik me tituj dhe grada shkencore, Kolegji Universitar “Bedër” ndjek politika të punësimit të profesionistëve vendas dhe të huaj me eksperiencë në fushën akademike. Nga analiza e CV-ve të stafit vihet re se anëtarët e personelit akademik kanë përvojën dhe ekspertizën e nevojshme për të plotësuar objektivat e programit, si dhe profesionistë të fushës të angazhuar si në institucione shtetërore, ashtu edhe në sektorin privat apo freelance të licensuar për të marrë përsipër detyra të lidhura ngushtësisht me fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, si dhe atë të shkencave kompjuterike. ¹¹⁹ Personeli akademik përdor metoda të ndryshme mësimore, duke iu përshtatur tipologjive të lëndëve dhe mundësisë për një mësimnxënie sa më efikase.
Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Siç është përmendur edhe më lart, institucioni ka përfshirë në procesin e vlerësimit të metodave të mësimdhënies studentët nëpërmjet anketimit dhe vlerësimit periodik. ¹²⁰ Ky vlerësim bëhet në çdo fund semestri. Studentët plotësojnë pyetësorët ku pyeten për performancën e lektorëve, si dhe metodat apo format që secili lektor aplikon gjatë lëndës së tij. Gjatë bashkëbisedimeve me studentë të programit, vazhdimisht është konstatuar se ky proces është gjithëpërfshirës. ¹²¹ Përfshirja e studentëve në mbledhjet e njësive kryesore dhe njësive bazë, si dhe përfshirja e tyre si detyrim ligjor në organet kolegjiale të KU “Bedër” është parashikuar edhe në vendimarrjet e këtyre organeve. Senati Akademik i KU “Bedër” ka marrë vendim për përfshirjen aktive të studentëve përfaqësues nga këshilli studentor në mbledhjet e njësive të KU “Bedër”.
Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.	Personeli akademik në varësi të përmbajtjes së orës së mësimi përdor metoda dhe mjete interaktive, si smart board, projeksion animacionesh, paraqitje fizike të pajisjeve, duke i bërë tërheqëse orët e mësimi. Gjithashtu, studentët inkurajohen vazhdimisht të diskutojnë rreth përmbajtjes apo dukurive të ndryshme të trajtuara në orët e mësimi. ¹²²

¹¹⁷ Evidenca nr. 49: Lista e trajnimeve për stafin rreth mësimdhënies

¹¹⁸ Evidenca nr. 10: Plani Strategjik 2018-2023

¹¹⁹ Evidenca nr. 20: CV e stafit të angazhuar në programin “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”

¹²⁰ Evidenca nr. 45: Rregullore e anketave dhe vlerësimeve

¹²¹ Evidenca nr. 50: Vendim i Senatit Akademik për studentët përfaqësues në mbledhje

¹²² Evidenca nr. 19: Shembull syllabusi: <https://cmp.beder.edu.al/sh/content/default/bachelor-ne-teknologji-informacioni-dhe-komunikimi-16/616.617/?con=0&cid=4470&t=1&oid=3835>

	<p>Nga vlerësimi i evidencave të paraqitura vihet re se Departamenti i Shkencave Kompjuterike është përpjekur të përfshijë metodat interaktive në mësimdhënie përmes projekteve të ndryshme të realizuara nga studentët në kuadër të lëndëve të ndryshme, nëpërmjet specialistëve të ftuar si përfaqësues të agjencive, biznesit dhe institucioneve publike dhe jopublike, në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit dhe shkencave kompjuterike, etj.¹²³</p>			
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Në objektivat strategjike të institucionit synohet sigurimi i një arsimimi cilësor, i cili si në procesin e mësimdhënies ashtu edhe në atë të vlerësimit, të aftësojë studentët të mendojnë në mënyrë kritike dhe të pavarur, si mënyra më efektive për t'i përgatitur për sfidat e së ardhmes.¹²⁴ Mësimdhënia cilësore është edhe një ndër objektivat e Planit Strategjik 2018-2023, Kreu III Objektivat strategjike.</p> <p>Detyrat, projektet dhe punët e ndryshme të pavarura janë mënyra më e përdorur që sigurojnë autonomi dhe autodeduksion të studentit.</p> <p>Në praktikimin e punëve në grup dhe projekteve, studentët kanë autonomi në organizimin e punëve dhe gjithashtu në vlerësimin e kontributit të anëtarëve në punën e përbashkët nëpërmjet kriterëve, si: përfshirja, kontributi me ide të vlefshme, marrja e iniciativave, gatishmëria dhe realizimi i detyrave, bashkëpunimi dhe ndihma ndaj anëtarëve të grupit. Këto vlerësime përfshihen në vlerësimin e përgjithshëm të studentit për lëndën përkatëse.</p> <p>Një nga pikat më të rëndësishme në funksion për mbështetjen e studentëve nga mësimdhënësit dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre është komunikimi i vazhdueshëm. Studentët mund të komunikojnë me lektorët e tyre brenda institucionit, me anë të adresës zyrtare të e-mailit si dhe numrit të kontaktit.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

¹²³ Evidenca nr. 27: Raporti i aktiviteteve të zhvilluara ndër vite

¹²⁴ Evidenca nr. 16: Rregullorja Themelore neni 75, 76, 77 dhe 78

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	<p>KU "Bedër" vazhdon aktivitetin e tij në dy godina të kontraktuara me qira për një periudhë dhjetëvjeçare, me sipërfaqe në total 2964,3 m² godina A dhe godina B. Infrastruktura e përdorur plotëson kriteret e përcaktuara në pikën 4 të shtojcës nr. 3 të udhëzimit të MASH, nr.11, datë 28.02.2011 "Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit" që duhet të paraqesë subjekti juridik, për hapjen e një institucioni privat të arsimit të lartë, ose programeve të studimit, në ciklin e parë dhe të dytë të studimit.</p> <p>Godinat janë të sapo rikonstruara dhe kompani të treta janë kontraktuar për mirëmbajtjen dhe pastrimin e tyre.</p> <p>Ambientet kanë një infrastrukturë moderne dhe përbëhen nga 17 klasa, 1 sallë konferencash, 2 laboratorë kompjuteri, sallë gjyqesh, News Room të cilat përdoren për aktivitete mësimdhënëse. Gjithashtu, përveç klasave të mësimin, ka dhe shumë ambiente çlodhëse për studentët, si mensë, bibliotekë, mjedise për Këshillin Studentor dhe klubet studentore, etj. Përveç ambienteve që ofrohen brenda 2 godinave kryesore, vlerë e shtuar janë edhe ambientet e jashtme çlodhëse që pasurojnë në shumë dimensione jetën studentore, brenda hapësirës së institucionit.¹²⁵</p> <p>Godinat janë të pajisura me sistem kaldaje, dalje emergjence, ambientet e shërbimit/teknike që i shërbejnë funksioneve të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, si dhe mundëson burime alternative energjie dhe uji pasi është i pajisur me elektropompë e depo uji, si dhe gjenerator.¹²⁶</p> <p>Objekti është larg zonave industriale apo me ndotje përtej normave të lejuara, në ambiente të ndërtuara me materiale cilësore që plotësojnë kushtet higjieno-sanitare dhe nuk shfaqin rrezikshmëri për studentët apo stafin akademik e administrativ.</p>
Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	<p>Godinat kanë një infrastrukturë moderne dhe janë të pajisura me sistem ngrohjeje. Klasat janë të pajisura me videoprojektorë dhe me tabela inteligjente (smart board) të cilat bëjnë të mundur zhvillimin më cilësor të procesit mësimor.</p> <p>Ato janë të pajisura gjithashtu me karrige ortopedike dhe tavolina individuale që sigurojnë akomodimin e rehatshëm dhe të sigurt të studentëve dhe pedagogëve, duke respektuar të gjitha protokollet e ruajtjes së higjienës dhe sigurisë.</p>
Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.	<p>Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme kompjuterike hardware dhe software në kuadër të plotësimin të procesit mësimor. Klasat janë të pajisura me tabela inteligjente (smart board), kompjutera, akses interneti, projektorë, si dhe një rrjet kompjuterik profesional. Gjithashtu, çdo individ është i pajisur me llogarinë e tij e-mail dhe llogarinë e tij në sistemin e automatizimit Bedër Information System (BIS).</p>

¹²⁵ Shtojca nr. 5: Mjediset e Fakultetit/Njësi Bazë (Tabela 16)

¹²⁶ Evidenca nr. 51: Marrëveshje me kompaninë Albpastrim për mirëmbajtjen e ambienteve të KU "Bedër"

	<p>Gjatë situatës së jashtëzakonshme, për shkak të pandemisë së COVID-19, për të ndjekur, monitoruar dhe raportuar ecurinë e mësimdhënies në distancë u krijua platforma one.beder.edu.al (https://drive.google.com/file/d/1ObEG3t7MHd_rgl154LYR-kW_T0BUy76Q/view?usp=drivesdk). ku çdo pedagog që zhvillon leksione pranë KU “Bedër”, akseson këtë platformë me anë të kredencialeve unike të ofruara nga institucioni dhe raporton në lidhje me zhvillimin e çdo leksioni të dhënë në distancë.</p> <p>KU “Bedër” ka një marrëveshje me Google¹²⁷ dhe përdor gjërësisht platformën G-Suite për të ofruar shërbime kundrejt stafit dhe studentëve, veçanërisht gjatë periudhës së pandemisë COVID-19.</p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Lektori i lëndës zgjedh dhe përditëson literaturën bazë dhe ndihmëse në bazë të specifikave të programit të lëndës. Gjithashtu, një kopje elektronike e kësaj literature u jepet studentëve në leksionin e parë të secilës lëndë, për të garantuar sa më mirë marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>KU “Bedër” disponon një bibliotekë me numër të madh titujsh e botimesh në gjuhë të ndryshme. Biblioteka është e pajisur me tavolina, karrige, kompjutera, Wi-Fi dhe ka një ndriçim të lartë natyral dhe vihet në dispozicion të studentëve çdo ditë të javës.</p> <p>Biblioteka e KU “Bedër” është shërbim të studentëve dhe stafit me kapacitet 24 poste leximi dhe 8 kompjutera në funksion të saj. Në Bibliotekë gjenden 22.600 tituj shkencor, 26.000 libra shkencorë, 166 monografi shkencore dhe 48 revista shkencore.¹²⁸</p> <p>Këta tituj janë të përzgjedhur dhe klasifikuar në përputhshmëri me programet e studimit të ofruara nga KU “Bedër”.</p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>KU “Bedër” parashikon fonde për blerjen e literaturës së specializuar në fushën e kërkimit shkencor, duke i akorduar çdo departamenti një fond të caktuar për pasurimin e bibliotekës me botimet dhe publikimet më të fundit të fushës.¹²⁹</p> <p>Në funksion të Bibliotekës, KU “Bedër” ka vënë në dispozicion edhe sistemin e automatizimit. Sipas këtij sistemi, kërkesa për sigurimin e literaturës dhe regjistrimet e studentëve bëhen në formë elektronike.</p> <p>KU “Bedër” ka akses në biblioteka digjitale ku përmendim librarinë JSTOR,¹³⁰ e cila aksesohet lehtë me anë të llogarisë mail të institucionit.</p> <p>JSTOR mundëson përdorimin e më shumë se 12 milionë artikujve të revistave shkencore. Gjithashtu, Biblioteka e KU “Bedër” mundëson komunikimin dhe në Book Academic Collection.</p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>KU “Bedër” disponon dy salla laboratorike me kompjutera të kohës, të shfrytëzueshëm gjatë orareve mësimore dhe pas tyre.</p> <p>Për realizimin e këtij programi, por jo vetëm, Kolegji Universitar “Bedër”, aktualisht zotëron dy laboratorë informatike, ku njëri prej tyre i ndërtuar gjatë periudhës Shtator-Dhjetor 2019 dhe ofron kapacitete shumë të larta teknike.</p> <p>Të gjithë kompjuterët janë arkitekturë Workstation me parametra teknike të larta (HP Z440, MT Xeon 2650 V3, Hexa Core, 16GB DDR4 SDRAM PC4</p>

127 Evidenca nr. 52: Marrëveshje me Google për platformën G-Suite

128 Shtojca nr. 6: Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online, etj (Tabela 17)

129 Evidenca nr. 53: Projekt buxheti i Departamentit të Shkencave Kompjuterike, viti akademik 2020-2021

130 Evidenca nr. 54: Marrëveshje me librarinë Online JSTOR

	<p>21000, SSD 240GB, NVIDIA Quadro K2200 GDDR5 SDRAM 4GB, HDD 500GB), ndërsa shpejtësia e transmetimit të rrjetit të brendshëm është të paktën 1Gb/s (kanalet e transmetimit janë CAT 6e me router profesional Cisco 4948 Gb).</p> <p>Sallat laboratorike me kompjutera të kohës janë të shfrytëzueshëm nga studentët për realizimin e detyrave, projekteve dhe studimeve specifike gjatë orareve mësimore dhe pas tyre.</p> <p>Në periudhat e sezonit të provimeve, sallat laboratorike dhe Biblioteka e KU "Bedër" janë të hapur edhe gjatë fundjavës në dispozicion të studentëve për përgatitjen e detyrave dhe projekteve.</p>								
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>KU "Bedër" ka një marrëveshje me Google¹³¹ dhe përdor gjëresisht platformën G-Suite për të ofruar shërbime kundrejt stafit dhe studentëve, veçanërisht gjatë periudhës së pandemisë COVID-19.</p> <p>Platforma G-Suite ofron shërbime për institucionin si: email, hapësirë pa limit drive, video-konferenca, klasa virtuale, prezantime, teste ose quize on-line, detyra dhe vlerësime për këto dhe shumë shërbime të tjera.</p> <p>Gjatë periudhës së pandemisë COVID-19 kjo platformë siguroi vazhdimësinë e pandërprerë të procesit mësimor akademik në komunikimet e vazhdueshme dhe realizimin e seancave të procesit mësimor.</p> <p>Sistemi i komunikimit elektronik dhe hapësira vetjake e dedikuar mundësohet nëpërmjet platformës G-Suite si për stafin akademik, administrativ, ashtu edhe për studentët e nivelit të parë dhe të dytë të regjistruar në institucion.</p> <p>Secili nga studentët në momentin e regjistrimit pajiset me një adresë emaili në formatin (iniciali i emrit, mbiemri, viti i regjistrimit @beder.edu.al)</p> <p>Stafi akademik dhe administrativ është i pajisur me adresë emailin në formatin (iniciali i emrit, mbiemri@beder.edu.al)</p>								
<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.</p>	<p>Sistemi i komunikimit të brendshëm elektronik dhe hapësira vetjake e dedikuar mundësohet nëpërmjet platformës G-Suite, siç është përmendur në kriterin 8 të këtij standarti.</p> <p>Të dhënat personale të stafit akademik, administrative dhe studentëve menaxhohen nëpërmjet sistemit të automatizimit të brendshëm BIS.</p> <p>Këto të dhëna përditësohen në mënyrë automatike edhe në një sistem Backup-i me nivel shumë të lartë sigurie.</p>								
<p>Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>	<p>Studentët, pasi zgjedhin udhëheqësin e tyre të diplomës, marrin prej tij gjithë udhëzimet dhe asistencën e nevojshme për zhvillimin sa më cilësor të saj.</p> <p>Në rregullore janë përcaktuar qartë detyrat e udhëheqësit të temës së diplomimit dhe detyrimet e studentëve. Nga ana tjetër, studentët ndihmohen dhe mbështeten në përzgjedhjen e temës duke iu ofruar një listë me tematika studimi të mundshme. Nga ana tjetër udhëheqësi këshillon, mbështet, orienton dhe asiston studentët për zhvillimin e mëtejshëm të punimit të diplomimit.¹³²</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="639 1713 790 1798">Nuk përmbushet</th> <th data-bbox="790 1713 1007 1798">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="1007 1713 1224 1798">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1224 1713 1450 1798">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="639 1798 790 1852"></td> <td data-bbox="790 1798 1007 1852"></td> <td data-bbox="1007 1798 1224 1852"></td> <td data-bbox="1224 1798 1450 1852" style="text-align: center;">√</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				√
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			√						

¹³¹ Evidenca nr. 52: Marrëveshje me Google për platformën G-Suite

¹³² Evidenca nr. 55: Parashikimi i ngarkesës mësimore për semestrin e pranverës, Departamenti i Shkencave Kompjuterike, viti akademik 2020-2021

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimin të cilësisë së mësimdhënies.	Aspekti i përmirësimin të vazhdueshëm të mësimdhënies në nivel institucional, organizohet dhe drejtohet nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Kjo njësi ka krijuar një përvojë të mirë në menaxhimin e këtij procesi. Përveç organizimit në nivel institucioni, sigurimi i cilësisë është i organizuar edhe në nivel njësie kryesore dhe në nivel njësie bazë, të cilat harmonizojnë dhe koordinojnë punën për të përmirësuar cilësinë në mësimdhënie. Rregullorja e NJSBC-së përcakton mënyrën organizimit dhe detyrat që kanë njësitë në nivel fakulteti dhe departamenti. Ndërkohë, nëpërmjet anketimeve të kryera nga studentët dhe vlerësimin të bërë nga titullari i njësisë, personeli akademik ka mundësi të rrisë shkallën e vetëdijësisë për sa i përket procesit të sigurimit të cilësisë. ¹³³
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	Departamenti i Shkencave Kompjuterike është në monitorim dhe në mbështetje të cilësisë dhe performancës së personelit akademik dhe studentëve, për lëndët e ofruara nga programi. Në mbështetje të këtij procesi anëtarët e stafit akademik plotësojnë formularin e vetëvlerësimin, ku ata planifikojnë pritshmëritë e tyre akademike, kërkimore dhe mësimdhënies për vitin në vijim përpara se të vlerësohen më tej nga eprorët e tyre. Nga ana tjetër, marrja e feedbackut të studentëve në lidhje me cilësinë e mësimdhënies nëpërmjet anketës së lëndëve mundëson që njësia bazë ashtu edhe ajo kryesore të monitorojnë hap pas hapi efektshmërinë e implementimit të programit si dhe të rritet vetëdija e personelit akademik dhe studentëve për cilësinë në mësimdhënie. ^{134 135} Vlejnë për t'u përmendur edhe takimet e ndryshme që organizon departamenti si me lektorë me kohë të plotë dhe të pjesshme si dhe specialistë të ndryshëm të fushës, në të cilat diskutohen për mënyrat e rritjes së cilësisë në programet e studimit që ofron. Gjithashtu, departamenti organizon takime të ndryshme të studentëve me specialistë të fushës dhe aktorë në biznesin e teknologjisë së informacionit.
Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.	Eksperimentimi dhe zhvillimi i metodave të reja të mësimdhënies, është çështje që lidhet si me anën infrastrukurore të institucionit ashtu edhe me strategjinë e cilësisë së KU "Bedër". Nga mbikëqyrja e ambienteve dhe auditorëve në institucion, vihet re se zhvillimi i metodave të reja të mësimdhënies është plotësisht i mundur. Ekzistenca e programeve në fushën e edukimit dhe komunikimit është një mundësi e mirë që shërben për rritjen e shkallës së përvetësimit të metodave inovatore të mësimdhënies nga i gjithë personeli akademik. Bashkëpunimi midis fakulteteve të KU "Bedër" dhe departamenteve përkatëse ndihmojnë në shkëmbimin e praktikave të mira dhe mbështetjen nëpërmjet seancave të ndryshme të kualifikimit në fushën akademike dhe në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të procesit mësimor (https://youtu.be/-fLD-A6F28w ; https://youtu.be/Yt7fgKFPcCk)
Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të	KU "Bedër" është një institucion i Arsimit të Lartë, i orientuar drejt kërkimit shkencor. Institucioni inkurajon të gjithë anëtarët e stafit akademik për të

¹³³ Evidenca nr. 48: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC-së

¹³⁴ Evidenca nr. 56: Formulari i vetëvlerësimin për stafin akademik

¹³⁵ Evidenca nr. 46: Anketa e studentit ndaj lëndës

<p>vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>qenë aktivë në fushën kërkimore, duke ofruar mbështetje financiare bazuar në Udhëzimin mbi nxitjen e publikimeve dhe kërkimit shkencor.^{136 137}</p> <p>KU “Bedër” ofron gjithashtu, mbështetje financiare për pjesëmarrjen e personelit akademik në konferenca dhe veprimtari shkencore, të organizuara brenda dhe jashtë vendit. Si rregull, çdo anëtar i stafit akademik ka të drejtë të përfitojë mbështetje financiare për pjesëmarrje në këto veprimtari. Në të njëjtën kohë, organizimi ose bashkëorganizimi i konferencave dhe i veprimtarive shkencore të një niveli ndërkombëtar me partnerë IAL të tjerë brenda apo jashtë vendit është një tjetër dimension i rëndësishëm i politikës kërkimore të KU “Bedër”. Nga ana tjetër, institucioni ka në përbërjen e strukturës së tij edhe Zyrën e Kërkimit Shkencor, e cila luan një rol të rëndësishëm në nxitjen e kërkimit dhe projekteve shkencore.¹³⁸</p>			
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>KU “Bedër” nëpërmjet Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përgatisin dhe zbatojnë një plan trajnimesh konkret në lidhje me trajnimet e domosdoshme për integrimin e personelit. Gjithashtu, disa prej këtyre trajnimeve pasqyrohen edhe në faqen e NJSBC, www.qac.beder.edu.al.</p> <p>E rëndësishme në këtë proces është se një pjesë e konsiderueshme e temave përcaktohen nga nevojat e propozuara nga vetë personeli akademik dhe administrativ. Zyra e Burimeve Njerëzore përmes një emaili zyrtar njofton të gjithë anëtarët e personelit për të propozuar tema të cilat ata i gjykojnë si të arsyeshme dhe të nevojshme, të cilat ndihmojnë për hartimin e planit të trajnimeve.</p> <p>Përveç trajnimeve të vazhdueshme vlen për t’u përmendur dhe trajnimet që kryhen me stafin akademik dhe administrativ në fillim të çdo viti akademik, një traditë e konsoliduar tashmë në KU “Bedër”.¹³⁹</p>			
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Zhvillimi i anketës online në fund të çdo semestri ndihmon institucionin të kuptojë performancën e personelit akademik dhe ndihmës akademik, duke marrë si primar vlerësimin e studentit e më pas vlerësimet e tjera të brendshme të departamentit. Në të gjitha rastet vihet rëndësi e veçantë në përdorimin e metodave inovative në përmirësimin e mësimdhënies.¹⁴⁰</p>			
<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e prishmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Departamenti inkurajon stafin të përmirësojë aftësitë dhe kompetencat didaktike, në mënyrë që programi i studimit të jetë në përputhje me rezultatet e pritshme, objektivat formuese dhe t’i përgjigjet sa më mirë nevojave të tregut të punës. Është praktikë që çdo fillim viti të organizohen trajnime profesionale me në fokus përmirësimin e mësimdhënies, integrimin e teknologjisë në mësimdhënie apo ndërthurjen e kërkimit shkencor me mësimdhënie. Institucioni ka zhvilluar edhe programe të veçanta të trajnimit të vazhdueshëm dhe të trajnimit fillestar për lektorët me kohë të plotë, lektorët me kohë të pjesshme apo stafin ndihmës.</p> <p>Pas marrjes së trajnimeve të përvitshme për stafin, fillon aplikimi i metodave të reja dhe rezultatet e prishmëritë diskutohen në mbledhjet e departamentit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

¹³⁶ Evidenca nr. 57: Udhëzimin mbi nxitjen e publikimeve dhe kërkimit shkencor

¹³⁷ Evidenca nr. 58: Lista e trajnimeve për kërkimin shkencor

¹³⁸ Evidenca nr. 57: Udhëzimin mbi nxitjen e publikimeve dhe kërkimit shkencor

¹³⁹ Evidenca nr. 49: Lista e trajnimeve për stafin, 2014-2020

¹⁴⁰ Evidenca nr. 19: Shembull syllabusi (https://cmp.beder.edu.al/sh/content/default/bachelor-ne-teknologji-informacioni-dhe-komunikimi-16/616/617/?_con=0&cid=4470&t=1&oid=3835)

standardit				√
------------	--	--	--	---

Standardi III.5				
Institucioni barton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.				
Kriteret	Vlerësimi			
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Rregullorja Themelore e KU “Bedër” dhe Rregullorja e programit “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” përcaktojnë format e ndryshme të vlerësimit që mund të aplikohen nga pedagogët në lëndët e ndryshme. ^{141 142} Në syllabusin përkatës të lëndës, pedagogu përcakton në mënyrë të detajuar kërkesat dhe detyrimet që duhen përmbushur nga studentët gjatë semestrit së bashku me mënyrën e vlerësimit për këto detyrime.			
Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Syllabuset e lëndëve për të gjitha semestrat kur është dhënë një lëndë janë gjithashtu të publikuara në Website-in e institucionit në seksionin e programit “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”: cmp.beder.edu.al Studentët e KU “Bedër”, pasi bëjnë regjistrimin e lëndeve në sistemin BIS, mund të shohin aty informacionet e nevojshme rreth metodologjisë së testimit të lëndës, numrin e testeve gjatë semestrit, mënyrat e testimit, si dhe përqindjet që do të kenë në notën përfundimtare, mungesat, etj. Këto ju komunikohen studentëve në fillim të semestrit nga pedagogu i lëndës dhe janë gjithashtu të publikuara në sistemin BIS në hapësirën e dedikuar të lëndës përkatëse në të cilën kanë akses studentët dhe pedagogu i lëndës.			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Pedagogët përdorin forma të ndryshme vlerësimi për t'u dhënë mundësi studentëve që të mund të shprehin dhe paraqesin njohuritë dhe aftësitë e fituara gjatë lëndës përkatëse. Këto forma përfshijnë: testime, projekte konkrete, detyra kursi, kuize, punë në grup, raste studimore, analiza, prezantime, aplikime në raste konkrete reale në bashkëpunim me biznese ose agjenci që operojnë në treg. Këto forma i japin mundësi studentëve jo vetëm të tregojnë aftësitë e tyre dhe njohuritë e fituara, por edhe të njohin forma të ndryshme të aplikimit të këtyre njohurive dhe aftësive, të zhvillojnë aftësitë e punës në grup, aftësitë e komunikimit me njëri-tjetrin dhe me palët e treta, të zhvillojnë aftësitë prezantuese, analizuese dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e situatës. ^{143 144}			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

¹⁴¹ Evidenca nr. 16: Rregullorja Themelore

¹⁴² Evidenca nr. 12: Rregullorja e programit “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”

¹⁴³ Evidenca nr. 16: Rregullorja Themelore, neni 100

¹⁴⁴ Evidenca nr. 19: Shembull syllabusi (https://cmp.beder.edu.al/sh/content/default/bachelor-ne-teknologji-informacioni-dhe-komunikimi-16.616/617/?_con=0&cid=4470&t=1&oid=3835)

Standardi III.6

Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.	Niveli i suksesit të studentit vlerësohet mbi bazën e provimeve semestrale/vjetore; pjesëmarrjes; detyrave të kursit; prezantimeve; aktivizimeve dhe projekteve. ¹⁴⁵ Vlerësimi i lëndës bëhet sipas modaliteteve të përcaktuara për lëndën në syllabusin e saj. Sipas rregullores së KU "Bedër", duhet të ketë të paktën një testim gjysëmfinal dhe një final për secilën lëndë në semestër.
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	KU "Bedër" disponon sistemin e brendshëm BIS ku bëhet komunikimi dhe ruajtja e të gjitha vlerësimeve të studentit sipas lëndëve përkatëse. Format kryesore e testimit elektronik është Google Forms, ku testi realizohet në formë të tillë që vlerësimi të bëhet në mënyrë automatike dhe secili student të marrë në mënyrë individuale tezën dhe vlerësimin e tij, bashkë me çelësin e përgjigjeve. ¹⁴⁶
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale në KU "Bedër" realizohet nga titullari i lëndës ose modulit si dhe asistenti i lëndës ose modulit sipas rastit dhe nga anëtarë të tjerë të stafit akademik të departamentit. Testi mund të bëhet me ose pa kodifikim. ¹⁴⁷
Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.	Testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet me ose pa kodifikim dhe zhvillohet gjithmonë në ambiente në të cilat ruhen distancat e nevojshme midis studentëve. Këto ambiente vëzhgohen gjithmonë nga së paku dy lektorë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës, ndërsa të tjerët anëtarë të stafit akademik të departamentit. ¹⁴⁸
Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Një nga parimet kryesore të funksionimit të Kolegjit Universitar "Bedër" është transparenca. Shpallja e rezultateve shoqërohet me shpjegimet përkatëse të përgjigjeve të sakta dhe me çelësin e tezës së provimit. Në çdo tezë është e paraqitur qartësisht pikëzimi dhe vlerësimi i çdo kërkesë të saj. Çdo vlerësim i testeve të ndryshme, para se të marrin formën e vlerësimit përfundimtar nga grupi me së paku dy anëtarë, i jepet studentit për konsultim, bashkë me çelësin e përgjigjeve. Në rastet e nevojshme, lektori është i gatshëm të bëjë sqarimet e nevojshme për studentët që e kërkojnë këtë. Po ashtu, lektori mund të ofrojë mundësinë për kohë shtesë të dedikuar të nevojshme për përvetësimin e njohurive nga ana e studentëve, qoftë kjo për të gjithë klasën apo për një grup të vogël studentësh. ¹⁴⁹
Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe	Personeli akademik përgjegjës për kontrollimin dhe vlerësimin e punimeve të ndryshme bën kontrollin e duhura të plagjiaturës me anë të platformave të vëna në dispozicion falas dhe me pagesë. Kontrolli i punimeve të diplomave


¹⁴⁵ Evidenca nr. 16: Rregullorja Themelore, neni 78

¹⁴⁶ Evidenca nr. 43: Udhëzimi mbi mësimdhënien në distancë

¹⁴⁷ Evidenca nr. 59: Shembull, organizimi i provimeve finale

¹⁴⁸ Evidenca nr. 61: Rregulla për organizimin e provimeve

¹⁴⁹ Evidenca nr. 59: Shembull, organizimi i provimeve finale



detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.	për plagjiaturë bëhet gradual i pjesshëm, por edhe tërësor përpara dorëzimit dhe pranimit për mbrojtje të punimit të diplomimit. Për të shmangur sa më shumë kopjimin në provime, testimi realizohet në salla të mëdha dhe përcaktohen së paku dy vëzhgues. Gjithashtu, për çdo testim mund të realizohen dy ose më shumë teza të ndryshme. ¹⁵⁰								
Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Matja e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bëhet më anë të testeve me njësi kontrollimi sa më objektive. Punët dhe projektet individuale ose në grup dhe rezultatet e tyre jepen sipas meritës dhe në kohë sipas përcaktimeve në rregulloren përkatëse. ¹⁵¹ Këto afate janë përcaktuar dhe në kalendarin akademik, stafi akademik është i detyruar të respektojë afatet e parashikuara në kalendarin.								
Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Sipas rregullores së programit "Bachelor" në "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi", në rast se studenti ka ankesa ndaj rezultatit përfundimtar të një provimi semestral, ai ka të drejtë që brenda një jave nga dita e publikimit të rezultateve, të paraqesë një ankesë me shkrim tek Zyra e Sekretarisë Mësimore. ¹⁵²								
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	Ankimimi shqyrtohet mbi gabimet e mundshme, nga një komision i cili ngrihet me vendim të Këshillit të Departamentit përkatës dhe përbëhet prej tre anëtarësh. Pedagogu i lëndës nuk mund të jetë pjesë e këtij komisioni. Anëtarë të komisionit janë lektorë sa më afër fushës së specialitetit të lëndës në fjalë. Vendimi i bëhet i ditur studentit jo më shumë se 15 ditë nga dita e paraqitjes së kërkesës për rishikim. Kjo procedurë dokumentohet dhe arkivohet pranë departamentit.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>√</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				√
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			√						

Standardi III.7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Lëndët e programit të studimit "Bachelor" në "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi" zhvillohen duke u dhënë rëndësinë e duhur teorisë, seminareve po ashtu dhe praktikave profesionale. Nëpërmjet marrëveshjeve me kompani të ndryshme në vend, KU "Bedër" i siguron studentëve praktika profesionale cilësore, duke filluar që nga viti i parë akademik. ¹⁵³ Për monitorimin e mbarëvajtjes së praktikave profesionale është hartuar edhe një paketë dokumentacioni me formularë të nevojshëm për t'u plotësuar gjatë ndjekjes së praktikës profesionale nga ana e studentëve, duke përfshirë formulari i vlerësimit të studentit praktikant, formulari i miratimit të praktikës, raport mbi zhvillimin e praktikës. ¹⁵⁴
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit,	Programi "Bachelor" në "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi" është i fokusuar në risitë teknologjike dhe të komunikimit. Stafii kujdeset që të përditësojë kurrikulat dhe syllabuset sipas kërkesave të kohës duke përfshirë

¹⁵⁰ Evidenca nr. 61: Rregullorja për disiplinën e studentëve

¹⁵¹ Evidenca nr. 12: Rregullorja e programit "Bachelor" në "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi"

¹⁵² Evidenca nr. 44: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë, neni 24

¹⁵³ Evidenca nr. 29: Komunikim shkresor i Zyrës së Planifikimit të Karrierës me institucionet e zhvillimit të praktikave profesionale

¹⁵⁴ Evidenca nr. 31: Formular aplikimi për zhvillimin e praktikës profesionale

humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimet (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	teknologjitë më të fundit. Gjithashtu, në kurrikulën e programit janë parashikuar mësimi i dy gjuhëve të huaja: gjuhës angleze dhe asaj gjermane, Metodatat Kërkimore dhe Shkrimi Akademik.
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	Në përfundim të semestrit, lektori i lëndës sigurohet me anë të metodologjive të ndryshme vlerësuese të aplikuara nga ana e tij (përfshirë këtu vlerësimin e vazhdueshëm në format e ndryshme dhe vlerësimin përfundimtar) që objektivat e shprehura në syllabuset e lëndëve, të jenë arritur dhe plotësuar. Këto trajtohen në diskutim të lirë me studentët ku secila prej palëve paraqet konkluzionet përkatëse për njohuritë dhe shprehjet e fituara duke nxjerrë dhe konkluzionet e nevojshme për nevojat e përmirësimit të vazhdueshëm të procesit.
Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.	Një praktikë shumë e suksesshme e studentëve të dy programeve të ofruara nga Departamenti i Shkencave Kompjuterike është prezantimi i projekteve individuale kreative në përfundim të lëndës në kuadër të një lënde të caktuar dhe organizimi i Workshop-eve demo për të demonstruar punët e tyre. Si përshkruhet edhe në raportin vjetor të vitit akademik 2019-2020, secili nga 4 grupet e kursit të vitit të dytë TIK, paraqiti projektin e krijuar prej tyre në semestrin e parë (dizenjim dhe krijim website në kuadrin e lëndës Programim në Web) dhe projektin multimedial të krijuar në semestrin e dytë që prezantojnë këto ëbesite (në format video në kuadër të lëndës Teknologji dhe Multimedia Interaktive). Seancat demonstruese të organizuara në formën e Workshop-eve studentore organizohen pranë mjediseve të KU "Bedër", ndërsa në kohën e pandemisë kjo praktikë është zhvilluar online. Për këtë pikë, do të sjellim përsëri në vëmendje praktikat profesionale, të cilat janë mënyra më efektive për të implementuar praktikisht çështjet e rëndësishme të shprehura dhe trajtuara në syllabuse. Gjithashtu, studentët marrin udhëzime konkrete për format e implemetimit të njohurive dhe aftësive të fituara nëpërmjet praktikave profesionale në kompani apo institucione të ndryshme. ¹⁵⁵
Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Në fillim të çdo viti akademik, departamenti harton një plan aktivitetesh, ndër të cilat bëjnë pjesë edhe leksione e hapura, seminare trajnuese ose Workshop-e. Të ftuarit në këto orë jashtëkurrikulare mund të jenë staf i brendshëm ose i jashtëm, specialistë të fushës, përfaqësues të kompanive dhe bizneseve të ndryshme, etj. ¹⁵⁶ Një praktikë shumë e mirë në këto seminare dhe orë të hapura janë edhe webinarët e zhvilluara online në kushtet e pandemisë, si dhe seancat demonstruese ku studentëve ju shfaqen nga afër aplikime teknologjike, manipulime me pajisje hardware apo me programe software.
Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	Në funksion të departamentit është ngritur dhe një laborator i ri kompjuterik, i cili u jep mundësi studentëve të implementojnë më së miri njohuritë teorike të marra, si dhe të zhvillojnë më tepër njohuritë e tyre. Departamenti ka iniciuar disa marrëveshje bashkëpunimi midis Kolegjit Universitar "Bedër" me institucione të tjera brenda dhe jashtë Shqipërisë. Krahas kësaj, Departamenti i Shkencave Kompjuterike ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi në nivel njësie me institucione të fushës së teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.
Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në	Personeli akademik organizon mbledhje në lidhje me problematika të ndryshme, ku përveç studentëve pjesë të mbledhjeve të departamentit janë

¹⁵⁵ Evidenca nr. 27: Raporti i aktiviteteve të zhvilluara ndër vite, workshopet studentore

¹⁵⁶ Evidenca nr. 22: Vendim i Këshillit të Departamentit për miratimin e planit të aktiviteteve, viti akademik 2020-2021

interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	të ftuarit, varësisht tematikave të trajtuara. Zakonisht mbahen edhe mbledhje të tjera periodike për të monitoruar ecurinë e vendimeve të mbledhjeve të mëparshme. ¹⁵⁷			
Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.	KU “Bedër” ka ngritur Zyrën e Kërkimit Shkencor, e cila ka rol koordinimi të aktiviteve me njësitë e tjera, departamentet dhe studentët. KU “Bedër” stimulon kërkimin shkencor. Nga ana tjetër pranë Fakultetit të Teknologjisë dhe Biznesit është ngritur edhe një qendër kërkimore zhvillimore e quajtur Qendra për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe Inovacion, e cila synon të nxisë vetëdijësimin e lektorëve apo njësive për pjesëmarrje në projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare dhe kjo vlen jo vetëm për stafin e këtij fakulteti, por edhe për stafin e fakultetit tjetër dhe njësive përbërëse të tij. ¹⁵⁸			
Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.	KU “Bedër” mbështet studentët e tij nëpërmjet Qendrës së Kërkuesëve të Rinj, konferencat studentore, etj. Qendra për Kërkuesit e Rinj është një qendër e krijuar në shërbim dhe në mbështetje të studentëve që dëshirojnë të zgjerojnë dijet e tyre në shkencat sociale dhe humane duke bërë kërkime në fusha të ndryshme sipas interesit të tyre. Nëpërmjet anëtarësimit në qendër, studentët kanë mundësi të zhvillojnë aftësitë drejtuese dhe menaxhuese, si dhe të ndajnë me njëri-tjetrin mendimet dhe eksperiencat e tyre mbi kërkimin shkencor. Nga ana tjetër, përfshirja dhe nxitja e mobilitetit të studentëve përmes programeve exchange ka bërë që ata të shkëmbejnë eksperiencat dhe të ndajnë me njëri tjetrin ide inovative mbi anën profesionale, kërkimore dhe akademike të programit. Rritja e mundësive dhe e përvojave ndërkombëtare për studentët përbën edhe një zë të veçantë në planin strategjik të institucionit duke synuar kështu rritjen e vetëdijes kulturore të studentëve dhe duke mbështetur idetë inovative profesionale dhe kërkimore shkencore. ¹⁵⁹			
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Që prej fillimit të operimit të programit, procesit të hartimit të kurrikulave dhe hartimit të propozimeve për hapjen e programit dhe në vazhdimësi, KU “Bedër” konsultohet me specialistë të fushës, përfaqësues të kompanive dhe bizneseve të ndryshme dhe aktorë të biznesit. Marrëveshjet dhe memorandumet e mirëkuptimit për praktikën profesionale dëshmojnë për këto bashkëpunime. ¹⁶⁰ Në kuadër të këtyre bashkëpunimeve janë ndërtuar edhe ura ndërlidhëse komunikimi dhe bashkëpunimi me Universitetin e Tor Vergata në Itali me në fokus shkëmbimin e eksperiencave akademike dhe mbështetjen e shkëmbimeve të lektorëve dhe të studentëve, por një shkëmbim i tillë nuk është materializuar ende për shkak të kufizimeve të pandemisë. Këto marrëveshje janë bërë bazë për organizimin e praktikave të studentëve, projekteve të përbashkëta dhe bashkëpunimeve të tjera në funksion të realizimit sa më mirë të aktivitetit të Departamentit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

¹⁵⁷ Evidenca nr. 27: Raporti i aktiviteve të zhvilluara ndër vite, workshopet studentore

¹⁵⁸ Evidenca nr. 27: Raporti i aktiviteve të zhvilluara ndër vite, workshopet studentore

¹⁵⁹ Evidenca nr. 10: Plani Strategjik 2018-2023

¹⁶⁰ Evidenca nr. 26: Lista e bashkëpunimeve dhe MOU

Standardi III.8

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Studentët në programin “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” në KU “Bedër” informohen në vazhdimësi mbi procesin e diplomimit. Ky proces është dhe pjesë e Rregullores Themelore të institucionit, ku saktësohen dhe detyrimet që duhet të përmbushë studenti deri në finalizimin e diplomimit të tij. ¹⁶¹ Punimi i diplomës i studentëve realizohet në kuadër të lëndës semestrale. Bërja e një punimi të detyrueshëm të diplomimit nga ana e studentit në përputhje me programin e arsimimit, i cili tregon arritjen e një niveli profesional të dëshiruar, vendoset nga ana e organeve kompetente të njësive përkatëse akademike. Kushtet e kryerjes së punimit, afati i dorëzimit, provimi dhe vlerësimi i punimit përcaktohet nga këto organe. Punimi i diplomimit përfshihet si lëndë e semestrit të gjashtë në programet e ciklit të parë. Punimi i diplomimit mund të zëvendësohet si alternativë edhe me një provim formues të organizuar nga departamenti.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Kolegji Universitar “Bedër” bën të mundur bërjen publike të informacioneve rreth provimeve finale ose mbrojtjes së diplomave sipas rregullores. Udhëheqësit e diplomave janë aktorët kyç në përcjelljen dhe kontrollimin e këtij informacioni. Gjithashtu, pjesë e manualit për përgatitjen e punimit të diplomës dhe kriteret e vlerësimit të punimit për studentët e ciklit të parë është edhe formulari për vlerësimin e tij. ¹⁶²
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Bërja e një punimi të detyrueshëm të diplomimit nga ana e studentit, në përputhje me programin e studimit, i cili tregon arritjen e një niveli profesional të dëshiruar, vendoset nga ana e organeve kompetente të njësive përkatëse akademike. Kushtet e kryerjes së punimit, afati i dorëzimit, provimi dhe vlerësimi i punimit përcaktohet nga këto organe. Punimi i diplomimit përfshihet si lëndë e semestrit të gjashtë në programin mësimor. ¹⁶³ Punimi i diplomimit mund të parashikohet edhe në përmbajtjen e një lënde të caktuar. Njësia bazë mund të përzgjedhë në bazë të arritjeve akademike të studentëve dhe shprehjes së vullnetit të tyre midis aplikimit të një provimi përfundimtar apo punimi diplome, kur një gjë e tillë është e parashikuar në planin mësimor/kurrikulën e programit. Kur punimi i diplomës nuk është një opsion, komisioni i posaçëm, harton një provim ku të përfshihen njohuri nga të gjitha lëndët e programit, duke vënë më tepër rëndësi mbi ato pyetje që kanë më tepër peshë në formimin akademik ose profesional të studentit. ¹⁶⁴
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.	Këshilltari akademik, po ashtu edhe udhëheqësi i diplomës ka rol të rëndësishëm në orientimin dhe përgatitjen e studentëve në prag diplomimi. Mbështetja e udhëheqësit mund të shihet që tek përzgjedhja e temës, tek strukturimi i saj dhe përzgjedhja e metodologjisë që do të aplikohet në temë deri tek aplikimi i metodologjisë përkatëse dhe analizimi i të dhënave empirike. Këshilltari akademik gjithashtu, në përputhje me udhëzimin për përgatitjen e punimit të diplomimit, mbështet studentët edhe në hartimin e

¹⁶¹ Evidenca nr. 16: Rregullorja Themelore, neni 87, neni 88, neni 89

¹⁶² Evidenca nr. 62: Manuali për përgatitjen e tezës së diplomës dhe kriteret e vlerësimit të tezës për studentët e ciklit të parë

¹⁶³ Evidenca nr. 55: Parashikimi i ngarkesës mësimore për semestrin e pranverës, viti akademik 2020-2021

¹⁶⁴ Evidenca nr. 60: Rregulla për organizimin e provimeve

	konkluzioneve dhe përpilimin e listës përkatëse të literaturës të përdorur si referencë. ¹⁶⁵
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	<p>Përgjegjësia kryesore për mbikëqyrjen dhe udhëzimin e studentëve gjatë procesit të përgatitjes së punimit të diplomës është e udhëheqësit. Është pikërisht udhëheqësi ai që ndihmon studentët edhe për nevoja të veçanta që duhen mundësuar nga institucioni, në kuadër të përgatitjes me sukses të punimit të diplomës.</p> <p>Në bazë të vlerësimit të kuadrit rregullator të brendshëm, roli i udhëheqësit është i mirëpërcaktuar. Ndërkohë, nga diskutimet e bëra me grupin e studentëve përfaqësues të të diplomuarve, u konstatua se studentët që kishin kaluar nga procesi i punimit të diplomimit, ishin në dijeni për rolin dhe mbështetjen e udhëheqësit shkencor.¹⁶⁶</p> <p>Caktimi i udhëheqësve akademikë nga KU "Bedër", përfshin edhe asistencën e tyre në analiza, teste, matje, etj., në fushën e punimit të temës së diplomës.</p>
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	<p>Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në të gjithë hapat e përgatitjes së diplomës sipas udhëzuesve të miratuar.¹⁶⁷ Ai garanton cilësinë e punimit dhe miraton ose jo, nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit për mbrojtje.</p> <p>Ashtu siç u përmend edhe më sipër, pasi udhëheqësi ka mbështetur studentët në nxjerrjen e rezultateve sipas metodologjisë së paracaktuar dhe ka ndihmuar atë në përpunimin e gjetjeve, vendos nëse punimi i diplomimit të studentit do kalojë për mbrojtje para një komisioni të përcaktuar nga departamenti.</p>
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Në fund të provimit ose temës së diplomës, studenti vlerësohet me notë, e cila do të shfaqet në listën e notave të studentit. Vlerësimi bëhet me notë nga një komision, përbërja e të cilit miratohet nga departamenti. Komisioni përbëhet nga jo më pak se 3 anëtarë, zakonisht specialistë të profileve të ngjashme me temën e përzgjedhur nga studenti. ¹⁶⁸
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Studenti, i cili ka kaluar me sukses në të gjitha lëndët e parashikuara në programin mësimor/kurrikul, nuk ka asnjë notë të vlerësuar me (D- ose F) dhe ka përfunduar të gjitha punimet e parashikuara në rregulloren përkatëse, atëherë pajiset me diplomën përkatëse dhe suplementin e saj. ¹⁶⁹ Vlen për t'u saktësuar këtu në programin "Bachelor" në "Teknologji Informativ dhe Komunikim" ende nuk është diplomuar brezi i parë i studentëve dhe ky është akreditimi i parë për këtë program, për këtë arsye sjellja e evidencave për këtë pikë bëhet e pamundur.
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Institucioni vë në dispozicion kopje të plotë zyrtare të programit të studimit të zhvilluar, në përfundim të studimeve kundrejt kërkesës së studentit. ¹⁷⁰
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse informacione për studentin, nëse	Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar ose të caktuar sipas detyrimeve ligjore kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen, sipas rregullave dhe ligjeve në fuqi. ¹⁷¹

¹⁶⁵ Evidenca nr. 55: Parashikimi i ngarkesës mësimore për semestrin e pranverës, viti akademik 2020-2021

¹⁶⁶ Evidenca nr. 63: Formati zyrtar i institucionit për punimin e diplomës

¹⁶⁷ Evidenca nr. 62: Manuali për përgatitjen e tezës së diplomës dhe kriteret e vlerësimit të tezës për studentët e ciklit të parë

¹⁶⁸ Evidenca nr. 64: Shembull, formular i vlerësimit të punimit të diplomës për programin Bachelor

¹⁶⁹ Evidenca nr. 65: Diploma dhe suplementi

¹⁷⁰ Evidenca nr. 66: Shembull, përshkrim lëndësh nga Zyra e Sekretarisë Mësimore

¹⁷¹ Evidenca nr. 67: Rregullorja e Arkivës, neni 6

kërkohen.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

[Handwritten signatures and text in blue ink]

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Zyra e Burimeve Njerëzore në KU "Bedër" mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.¹⁷²</p> <p>Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit. Çdo fillim semestri, me propozim të njësisë bazë, aprovim të Dekanatit dhe miratim të Rektoratit përcaktohet ngarkesa mësimore për secilin anëtar të personelit akademik të çdo departamenti.¹⁷³</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me Statutin dhe rregulloren. Kjo procedurë parashikohet si në Statutin e KU "Bedër"¹⁷⁴, po ashtu edhe në Rregulloren Themelore¹⁷⁵ dhe në Procedurën e rekrutimit të stafit.¹⁷⁶</p> <p>Siç parashikon edhe neni 61 i Statutit,¹⁷⁷ kriteret e punësimit të personelit akademik me kohë të plotë përcaktohen nga njësi bazë, bazuar në nevojat e kësaj të fundit, pas pëlqimit të Dekanit dhe miratimit nga Rektori. Përzgjedhja e kandidatit drejtohet nga një komision ad-hoc, i përbërë në shumicë nga njësi bazë përkatëse.</p> <p>Komisioni ad-hoc bën renditjen e kandidaturave, ia propozon Rektorit dhe ky i fundit bën emërimin me kohë të plotë të punonjësit.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>KU "Bedër" ndjek një politikë efektive për punësimin e personelit akademik të kualifikuar, me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme. Politikat dhe strategjia e punësimit përcaktohen në Statut, në Rregulloren Themelore dhe në Procedurën e punësimit, e cila parashikon hapat e punësimit të personelit akademik të sipërpërmendur, e cila realizohet përmes një zinxhiri komunikimi formal nga departamenti, në fakultet dhe më pas në rektorat.</p> <p>Sipas kësaj procedure, vendet e lira shpallen në Web-in e institucionit dhe/ose pranë Zyrës së Punës, sipas lajmërimit të përgatitur nga Zyra e Burimeve Njerëzore, në përputhje me procedurat e ndjekura për punësimin në vendet e lira.</p>

¹⁷² Evidenca nr. 68: Lista e të dhënave individuale të personelit me kohë të plotë


¹⁷³ Evidenca nr. 69: Udhëzim "Për ngarkesën mësimore"

¹⁷⁴ Evidenca nr. 7: Statuti i Kolegjit Universitar "Bedër"

¹⁷⁵ Evidenca nr. 16: Rregullorja Themelore, Neni 26

¹⁷⁶ Evidenca nr. 70: Procedura e punësimit të stafit

¹⁷⁷ Evidenca nr. 7: Statuti i Kolegjit Universitar "Bedër", neni 61



	Për një funksionim sa më të suksesshëm, KU "Bedër" aplikon edhe punësimin e personelit ndihmës mësimor-shkencor, si edhe të atij administrativ. ^{178 179}			
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me Statutin dhe Rregulloren Themelore. Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohet në përputhje me strategjinë për zhvillim të KU "Bedër". Stafit në institucion dhe konkretisht në Departamentin e Shkencave Kompjuterike është përzgjedhur, duke treguar një rëndësi të veçantë në fushën e tyre të specializimit, e që përputhet më së miri me zhvillimin e institucionit në përgjithësi dhe të departamentit në veçanti. ¹⁸⁰			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	KU "Bedër" ka një vendndodhje që disponon mjedis qëndror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore. KU "Bedër" ka në sasi të mjaftueshme hapësira, si: laboratorë, klasa, zyra, e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programeve të studimeve. Nga ana tjetër, institucioni ka zhvilluar edhe programe të veçanta të trajnimit të vazhdueshëm dhe të trajnimit fillestar për lektorët me kohë të plotë, lektorët me kohë të pjesshme apo stafin ndihmës të cilët angazhohen për herë të parë në institucion, duke ju mundësuar një mjedis të aklimatizuar me punën në institucion. Institucioni ka hapësira zyrash të mjaftueshme për personelin akademik, ndihmës akademik dhe atë administrativ për të mundësuar lehtësimin e bashkëpunimit të tyre dhe studentëve, si dhe për të lehtësuar komunikimin midis të treja palëve. ¹⁸¹
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	KU "Bedër", nëpërmjet Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, përgatisin dhe zbatojnë një plan vjetor konkret në lidhje me trajnimet e domosdoshme për integrimin e personelit. ¹⁸² E rëndësishme në këtë proces është se një pjesë e konsiderueshme e temave përcaktohet nga nevojat e propozuara nga vetë personeli akademik dhe administrativ. Zyra e Burimeve Njerëzore, përmes një e-maili zyrtar, njofton të gjithë anëtarët e personelit për të propozuar tema të cilat ata i gjykojnë si të arsyeshme dhe të nevojshme, të cilat ndihmojnë për hartimin e planit të trajnimeve. Tematikat e trajnimeve diskutohen në mënyrë të përvitshme edhe në mbledhjet e departamentit me qëllim ofrimin për anëtarët e departamentit trajnime në përputhje me kërkesat e dala nga tregu i punës dhe nga vetë studentët.
Kriteri 3. Institucioni organizon	Në çdo fillim viti akademik, KU "Bedër" organizon seminare trajnuese për të

¹⁷⁸ Evidenca nr. 71: Praktika e punësimit të stafit

¹⁷⁹ Evidenca nr. 72: Shembull, kërkesë për Drejtorinë Rajonale të Punësimit

¹⁸⁰ Evidenca nr. 73: Shembull, kriteret për vendet vakante

¹⁸¹ Shtojca nr. 5: Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë (Tabela 16)

¹⁸² Evidenca nr. 74: Plan vjetor trajnimesh të personelit

<p>programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtjshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>ndihmuar në përditësimin e stafit akademik me zhvillimet teknologjike në metodat e mësimdhënies. Vlen të përmenden dhe trajnimet që janë vazhduar Online, me tematika si të përdorim Google Classroom gjatë zhvillimit të leksionit online. Gjithashtu, janë zhvilluar nga programi i IT-së, disa video "tutorial" dhe manuale në lidhje me përdorimin sa më të efektshëm të aplikacioneve dhe platformave të tilla, si: Google Classroom, Google Meet, Zoom etj., dhe këto janë shpërndarë si tek studentët ashtu edhe tek stafi akademik i përfshirë në mësimdhënien e një programi.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Angazhimi i personelit aktual akademik ka synuar dhe ka arritur një punë optimale për përmbushjen e objektivave të programeve të ciklit të parë. Kjo realizohet si në aspektin e mësimdhënies e mësimnxënies brenda institucionit, ashtu edhe në drejtim të bashkëpunimeve me institucione dhe kompani të ndryshme për të siguruar realizimin e praktikave profesionale nga studentët e departamentit. Kjo mundëson zbatimin në praktikë të aspekteve teorike të programit, të cilat sigurojnë përvetësim dhe aftësim më të plotë të tyre.</p> <p>Angazhimi i këshilltarëve akademikë është një formë efektive për të orientuar studentët në përzgjedhjen e lëndëve në përputhje me programin e studimeve (si lëndët e detyrueshme, ashtu edhe ato me zgjedhje). Këshilltarët akademikë janë orientuesit e studentëve në faza të ndryshme gjatë zhvillimit të këtij programi studimesh në lidhje me kërkesat, rregulloret, kushtet e diplomimit, si dhe për t'i këshilluar në lidhje me karrierën e tyre pas diplomimit.¹⁸³ Gjithashtu, edhe sigurimi i mundësisë për praktika profesionale që në vitin e parë të studimeve të tyre për studentët, mundëson aftësim më të madh të tyre dhe familjarizim me botën e tregut të punës dhe të profesionit të tyre të ardhshëm.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				√


¹⁸³ Evidenca nr. 24: Vendimi i Këshillit të Departamentit për caktimin e këshilltarit akademik

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Varësisht nevojave të programeve akademike, KU "Bedër" ofron mjedise që ndihmojnë studentin për formimin praktik dhe profesional. Të tilla janë laboratorit i gjuhëve të huaja, laboratorit i kompjuterave, Salla e Gjyqit, etj.</p> <p>Siç paraqitet edhe në përshkrimin e mësipërm për infrastrukturën, KU "Bedër" dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme hapësira, si: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programeve të studimeve.</p> <p>Ambientet kanë një infrastrukturë moderne dhe përbëhen nga 17 klasa, 1 sallë konferencash, 2 laboratorë kompjuteri, sallë gjyqesh, News Room të cilat përdoren për aktivitete mësimdhënëse. Gjithashtu, përveç klasave të mësimt, ka dhe shumë ambiente çlodhëse për studentët, si mensë, bibliotekë, mjedise për Këshillin Studentor dhe klubet studentore, etj. Përveç ambienteve që ofrohen brenda 2 godinave kryesore, vlerë e shtuar janë edhe ambientet e jashtme çlodhëse dhe rekreative që pasurojnë në shumë dimensione jetën studentore, brenda hapësirës së institucionit.¹⁸⁴</p> <p>Godinat janë të pajisura me sistem ngrohje, dalje emergjence, ambientet e shërbimit/teknike që i shërbejnë funksioneve të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, si dhe mundëson burime alternative energjie dhe uji.</p> <p>Objekti është larg zonave industriale apo me ndotje përtej normave të lejuara, në ambiente të ndërtuara me materiale cilësore që plotësojnë kushtet higjieno-sanitare dhe nuk shfaqin rrezikshmëri për studentët apo stafin akademik e administrativ.</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Pajisjet e mjedisve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit. Klasat janë të pajisura me mjetet e nevojshme teknologjike, si tabelë interaktive, projektorë, kompjutera, internet. Të gjitha mjediset mësimore janë të pajisura me kondicionim dhe ndriçim të mjaftueshëm.</p> <p>Adoptimi dhe shpërndarja e hapësirave të institucionit në dy godina, bazohet në një përjasje sa më racionale dhe objektive, duke marrë parasysh zonat më private dhe ato që priten të jenë më të populluara me studentë. Në godinën A, e cila është në hyrje të institucionit, përqendrohen kryesisht ambientet e administratës, holli, biblioteka, etj., dhe në godinën B janë të përqendruara auditorët e leksioneve dhe laboratorët kompjuterikë.</p> <p>Në Kolegjin Universitar "Bedër" gjithashtu janë në përdorim dy salla kompjuterësh, Salla e Konferencave, etj. Në shërbim të studentëve është edhe Salla e Gjyqit, e Departamentit të Drejtësisë, e cila mund të përdoret edhe nga studentët e departamenteve të tjera të institucionit.</p> <p>News Room është një prej risive të Kolegjit Universitar "Bedër", është një ambient i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, i cili mund të përdoret edhe nga departamentet e tjera. News Room përbëhet nga kompjutera dhe tavolina leximi, si dhe mund të përdoret në të njëjtën kohë</p>

¹⁸⁴ Shtojca nr. 5: Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë (Tabela 16)



	edhe si laborator i dytë kompjuteri.			
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Për të përmbushur nevojat e programeve janë ngritur laboratorit i Gjuhëve të Huaja, laboratorit i Informatikës, etj. Për realizimin e këtij programi, por jo vetëm, Kolegji Universitar “Bedër” aktualisht zotëron dy laboratorë informatike, ku njëri prej tyre i ndërtuar gjatë periudhës Shtator-Dhjetor 2019 ofron kapacitete shumë të larta teknike. Të gjithë kompjuterët janë arkitekturë Workstation me parametra teknike të larta (HP Z440, MT Xeon 2650 V3, Hexa Core, 16GB DDR4 SDRAM PC4 21000, SSD 240GB, NVIDIA Quadro K2200 GDDR5 SDRAM 4GB, HDD 500GB), ndërsa shpejtësia e transmetimit të rrjetit të brendshëm është të paktën 1Gb/s (kanalet e transmetimit janë CAT 6e me router profesional Cisco 4948 Gb). Nga sa më sipër, ky laborator u mundëson lehtësisht aplikimin në praktikë të njohurive dhe aftësive të fituara nga studentët në kurset teorike. ¹⁸⁵			
Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.	Institucioni ka ngritur dy laboratorë të posaçëm për të përmbushur nevojat e programit të studimit Bachelor në Teknologji Informacioni dhe Komunikimi.			
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.	<p>KU “Bedër”, veçanërisht Departamenti i Shkencave Kompjuterike iu kushton rëndësi të veçantë praktikave profesionale. Prandaj, gjatë vitit studentët nxiten dhe ju ofrohet mundësia të ndjekin praktika profesionale në institucione të ndryshme. KU “Bedër” ndër vite ka nënshkruar një sërë marrëveshesh me institucione të ndryshme ku studentët në të dy semestrate vitit akademik zhvillojnë këto praktika.¹⁸⁶</p> <p>Ndërkohë, KU “Bedër” ka ofruar mundësi praktikash profesionale edhe brenda Institucionit, siç është Zyra e It-së, Zyra e Marrëdhënieve me Publikun dhe Median, revista Objektiv dhe portali objektiv.al.^{187 188}</p> <p>Nëpërmjet këshillimit të karrierës, leksioneve të hapura, të ftuarve të ndryshëm, seminareve profesionale etj., studentët e Kolegji Universitar “Bedër” informohen hollësisht për mundësitë e punësimit pas diplomimit në këtë program studimi.</p> <p>Në kuadër të planifikimit të karrierës, krahas Zyrës së Planifikimit të Karrierës, Kolegji Universitar “Bedër”, pranë çdo departamenti është caktuar një përfaqësues që ndërlidh këtë zyrë me studentët dhe ju mundëson atyre lidhjet me tregun e punës.¹⁸⁹</p> <p>Zyra për Planifikimin e Karrierës ndjek nga afër edhe procesin e praktikave profesionale të studentëve të cilëve u ka mundësuar një praktikë të tillë.</p> <p>Në ndihmë të studentëve departamentet, në mënyrë të bashkërenduar me Zyrën për Planifikimin e Karrierës, kanë krijuar një rrjet të gjerë bashkëpunimi me institucione të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit. Departamenti dhe zyra në fjalë i ka ndihmuar studentët në përzgjedhjen e institucionit, në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, duke dërguar kërkesa të veçanta për çdo institucion brenda dhe jashtë vendit.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

¹⁸⁵ Evidenca nr. 75: Specifikime teknike për laboratorin e kompjuterave

¹⁸⁶ Evidenca nr. 29: Komunikim shkresor i Zyrës së Planifikimit të Karrierës me institucionet e zhvillimit të praktikave profesionale

¹⁸⁷ Evidenca nr. 31: Formular aplikimi për zhvillimin e praktikës profesionale

¹⁸⁸ Evidenca nr. 26: Lista e bashkëpunimeve dhe MOU, shembull ATOM Computers

¹⁸⁹ Evidenca nr. 23: Vendimi i Këshillit të Departamentit për caktimin e përfaqësuesit pranë Zyrës së Planifikimit të Karrierës

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Literatura e nevojshme për lëndët e ofruara, bëhet e ditur me anë të programit të lëndës që në fillim të semestrit. Biblioteka zotëron titujt kryesorë të përfshirë në literaturën e domosdoshme të çdo programi. ¹⁹⁰
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Biblioteka e KU "Bedër" vjen në shërbim të studentëve dhe stafit me kapacitet 24 poste leximi dhe 8 kompjutera në funksion të saj. Në bibliotekë gjenden 22.600 tituj shkencor, 26.000 libra shkencorë, 166 monografi shkencore dhe 48 revista shkencore. ¹⁹¹ Biblioteka është e abonuar në revista shkencore online, si JSTOR duke ju mundësuar studentëve dhe stafit hyrje në këtë bibliotekë madhështore botërore. JSTOR mundëson përdorimin e më shumë se 12 milionë artikujve të revistave shkencore. ¹⁹²
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	Për të lehtësuar kërkimin shkencor të stafit akademik dhe të studentëve, nga viti akademik 2012-2013 është realizuar abonimi me database elektronike-shkencore online. Biblioteka ofron sigurimin e materialeve edhe në rrugë elektronike. Kjo mundësohet nga abonimi që është bërë në bibliotekën online JSTOR. Gjithashtu, Biblioteka e KU "Bedër" mundëson komunikimin dhe në Book Academic Collection.
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Biblioteka e KU "Bedër" është e pajisur me programe kompjuterike dhe kompjutera për t'u mundësuar studentëve realizimin e detyrave dhe mundësi për akses online në varësi të nevojave të tyre.
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	KU "Bedër" parashikon fonde për blerjen e literaturës së specializuar në fushën e kërkimit shkencor, duke i akorduar çdo departamenti një fond të caktuar për pasurimin e bibliotekës me botimet dhe publikimet më të fundit të fushës. Pasurimi i bibliotekës është bërë gjithashtu edhe përmes një projekti studentor "Libri është i vetmi kopsht që mbillet për të tjerët", i organizuar përmes një fushate sensibilizuese për mbledhjen e librave, nga studentët e Departamentit të Shkencave të Komunikimit, në kuadër të së cilës u mblodhën rreth 10.000 libra. Një pjesë e tyre u përdor për pasurimin e Bibliotekës së institucionit, ndërsa pjesa tjetër u dhurua për shkolla, institucione të tjera dhe grupe në nevojë. Një nismë tjetër që ka kontribuar në pasurimin e Bibliotekës së KU "Bedër", ka qenë edhe dhurimi i 318 librave nga Ambasada Amerikane në Tiranë, gjatë muajit Tetor 2018.
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në	Oraret e punës së Bibliotekës shpallen në mjediset e institucionit. Ato janë

¹⁹⁰ Shoja nr. 6: Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online, etj (Tabela 17)

¹⁹¹ Shoja nr. 6: Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online, etj (Tabela 17)

¹⁹² Evidenca nr. 54: Marrëveshje me librarinë Online JSTOR

<p>dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>të bëra publike në hyrje të Bibliotekës, mjediset e së cilës janë të disponueshme nga ora 8:30 deri në orën 19:00 të mbrëmjes. Në periudhë provimesh, Biblioteka qëndron e hapur edhe gjatë fundjavës.</p> <p>Në funksion të Bibliotekës, KU "Bedër" ka vënë në dispozicion edhe sistemin e automatizimit. Sipas këtij sistemi, kërkesa për sigurimin e literaturës dhe regjistrimet e studentëve bëhen në formë elektronike.</p> <p>Biblioteka ofron sigurimin e materialeve edhe në rrugë elektronike. Kjo mundësohet nga abonimi që është bërë në Bibliotekën online JSTOR. Gjithashtu, Biblioteka e KU "Bedër" mundëson komunikimin dhe në Book Academic Collection.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				√

<p>Standardi IV.5</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>BIS është sistemi i automatizimit që përdoret në Kolegjin Universitar "Bedër". Sistemi BIS bën të mundur që të gjitha veprimtaritë në institucion të bëhen në mënyrë të automatizuar.¹⁹³ Sipas projektit BIS, të gjitha njësitet kanë një llogari, faqe të tyre ku bëjnë veprimet në lidhje me detyrat përkatëse. Në BIS ka një llogari dhe për stafin akademik dhe administrative, e cila ju vëhet në dispozicion në momentin e punësimit nga zyra e IT-së. Në modulet e ndryshme të sistemit BIS janë të ruajtura të dhënat dhe rekordet për secilin student që nga momenti i regjistrimit deri në diplomim, duke qenë në gjendje të pasqyrojnë në mënyrë të detajuar vlerësimin, kalimin apo ngeljen e studentëve në çdo lëndë, rimarrjen e një lënde, dhe shpërndarjes përkatëse të ECTS-ve të grumbulluara sipas viteve, me qëllim ndjekjen e ecurisë së studentëve dhe shpalljen e tyre kalues ose jo, në përputhje me Rregulloren e Ciklit të Parë të Studimeve.¹⁹⁴</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>BIS është sistemi i automatizimit që përdoret në Kolegjin Universitar "Bedër". Sistemi BIS bën të mundur që të gjitha veprimtaritë në institucion të bëhen në mënyrë të automatizuar. Sipas projektit BIS, të gjitha njësitet kanë një llogari, faqe të tyre ku bëjnë veprimet në lidhje me detyrat përkatëse. Në BIS ka një llogari për secilën nga njësitet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Studentët; • Stafin akademik; • Zyrë e Burimeve Njerëzore; • Zyrën e Sekretarisë Mësimore; • Bibliotekën; • Sekretaritë e Departamenteve; • Zyrën e Financës dhe Çështjeve Administrative;

¹⁹³ Evidenca nr. 39: Udhëzues i Sistemit Informativ Bedër (BIS)

¹⁹⁴ Evidenca nr. 44: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë

	<ul style="list-style-type: none"> • Zyrën e Marrëdhënieve me Publikun dhe Median; • Zyrën e Marrëdhënieve Ndërkombëtare. <p>Si i tillë, sistemi BIS mundëson administrimin dhe qarkullimin e informacionit dhe gjurmimin e aktivitetit të personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>								
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Sistemi i automatizuar i informacionit përmes moduleve të dedikuara dhe të konceptuara për t'ju ardhur në ndihmë studentëve, personelit akademik dhe personelit ndihmës, përgjegjësi për administrimin e të dhënave, mundëson akses të njëkohshëm në dokumente, të dhëna dhe informacione për të gjitha palët e interesuara të përfshira në procesin akademik apo në proceset administrative që kanë të bëjnë me koordinimin e programeve të studimit.								
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Sistemi i automatizuar BIS, gjithashtu mundëson qarkullimin në kohë reale dhe sinkronizimin e të dhënave, si dhe transferimin e tyre nga njëra njësi tek tjetra dhe nga njëra palë e interesuar tek tjetra, me qëllim mbajtjen dhe ofrimin e të dhënave të përditësuara njëjshme dhe studentëve në çdo kohë.								
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Ashtu sikundër u tha edhe më sipër, sistemi i automatizuar i menaxhimit të informacionit, me modulet e tij përgjegjëse, për të mbështetur veprimtarinë e personelit akademik, ndihmës akademik, administrativ dhe studentëve, garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët. Një shembull i kësaj është qarkullimi çdo fillim semestri në kohë reale i të dhënave në lidhje me studentët që kanë arritur të regjistrojnë lëndët për semestrin përkatës dhe në lidhje me ato që për mangësi të caktuara dokumentacioni nuk arrijnë të regjistrojnë lëndët deri në plotësim të dokumentacionit të nevojshëm.								
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Në faqen zyrtare të institucionit gjendet informacion i përditësuar në lidhje me njësitë akademike dhe administrative, programet e studimit, burimet njerëzore, personelin akademik dhe administrativ të përfshirë në secilin program, si dhe veprimtaritë e njëjshme përkatëse. Në web jepet gjithë informacioni i nevojshëm për studentët përsa i përket kalendarit akademik, orarit të leksioneve dhe provimeve, si dhe një akses i dedikuar për Bibliotekën, Zyrën e Kërkimit Shkencor dhe Zyrën e Koordinimit të Programeve Master. Gjithashtu, publikohen njoftime pune apo njoftime për praktika profesionale, si dhe rezultate të anketave të zhvilluara nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë apo komisioneve të tjera që operojnë pranë Kolegjit Universitar "Bedër". I gjithë informacioni ofrohet në dy gjuhë, në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze (https://cmp.beder.edu.al/sh/content/default/bachelor-ne-teknologji-informacioni-dhe-komunikimi-19/616/617).								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>√</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				√
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			√						

Standardi IV.6







Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	<p>Çdo vit, fondacioni harton një raport ku parashikohen të ardhurat dhe shpenzimet e institucionit. Në raport paraqiten shpenzimet dhe të ardhurat që ka institucioni, të detajuara sipas llojit.</p> <p>Kolegji Universitar "Bedër", gëzon statusin e institucionit të lartë arsimor jofitimprurës. Një mbështetje e madhe financiare për institucionin janë donacionet. Institucioni siguron që të ketë të ardhura të mjaftueshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit.¹⁹⁵</p>
Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.	<p>Në raportin financiar të institucionit paraqiten të gjitha të dhënat mbi shpenzimet dhe të ardhurat që ka institucioni, të detajuara sipas llojit, burimit dhe destinacionit të tyre. Brenda raportit janë të specifikuar të gjitha zërat në lidhje me të ardhurat dhe të gjitha shpenzimet për shërbimet që ofron në mënyrë direkte apo indirekte.</p> <p>Në raport paraqiten të gjitha shpenzimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, etj. Raporti përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.	<p>Çdo vit, fondacioni harton një raport, nga një Kontabilist i Miratuar, të situatës financiare dhe ky raport ruhet pranë Fondacionit.</p> <p>Raportet financiare hartohen sipas legjislacionit në fuqi nga fondacioni, pjesë e të cilit është Kolegji Universitar "Bedër", brenda afateve të përcaktuara, ku përfshihen pasqyra të hollësishme financiare të të ardhurave dhe shpenzimeve.</p> <p>KU "Bedër" i paraqet çdo fundviti akademik Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë raportin vjetor institucional, ku përfshihet buxheti i vitit të kaluar, projektbuxheti i vitit të ardhshëm akademik, si edhe projektbuxheti afatmesëm.</p>
Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	<p>Shpërndarja e burimeve financiare dhe përdorimi i tyre në KU "Bedër" bëhet në bazë të një programi financiar, i hartuar në përputhje me Standardet Kombëtare të hartimit dhe raportimit financiar dhe rregullave të tjera të kërkuara në Ligjin Nr. 80/2015 Për Arsimin e Lartë, në Ligjin Nr. 8788, datë 7.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse", në Ligjin Nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", si dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim të tyre.</p>
Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton	<p>Kolegji Universitar "Bedër" gëzon statusin e institucionit të lartë arsimor jofitimprurës. Duke vlerësuar veprimtarinë e derimëtanishme, KU "Bedër"</p>

¹⁹⁵ Shtojca nr. 7: Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit (Tabela 18)

qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.	dëshmon qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe bashkë me mbështetjen e donatorëve ka kapacitete të mjaftueshme financiare për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Pranimi i studentëve të rinj në programet e ciklit të parë që ofrohen nga KU “Bedër” bëhet në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 “për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”.</p> <p>Studentët e regjistruar në KU “Bedër” informohen në kohë reale përmes sistemit BIS, ku në ekranin e gjithësecilit shfaqet njoftimi përkatës. Komunikimi i brendshëm në KU “Bedër” kryhet nëpërmjet sekretarive të ngritura pranë njësive bazë dhe njësive kryesore. Çdo student ka një adresë elektronike të brendshme. Departamenti i IT-së pajis çdo student me adresë poste elektronike të formës: shkronja e parë e emrit, mbiemri, dy numrat e fundit të vitit të regjistrimit@beder.edu.al.^{196 197 198 199}</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Kriteret për pranimin e studentëve në programet e studimit të ciklit të parë, për vitin akademik 2020-2021, si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Mesatarja e shkollës së mesme, për të gjitha vitet, në masën 70%. 2. Intervista nga komisioni i vlerësimit, i formuar nga departamenti përkatës, në masën 30%.²⁰⁰ <p>KU “Bedër” ndjek politikë mbështetëse për të gjithë studentët dhe siguron ambiente dhe mjete të nevojshme për studentët me aftësi të kufizuara. KU “Bedër” ndjek politika mbështetëse për studentët me aftësi të veçanta, talente dhe që kanë fituar çmime, duke ofruar zbritje nga tarifa e studimit deri në 100% të saj.^{201 202} Kriteret e pranimit për studentët e rinj bëhen publike në faqen zyrtare të institucionit dhe gjithashtu në përputhje me rregullimet ligjore në fuqi edhe në portalin U-Albania. Nga ana tjetër, kriteret e nevojshme për t’u plotësuar nga ana e studentëve me qëllim kalimin e tyre nga njëri vit akademik në tjetrin dhe për diplomim parashikohen dhe janë publike për studentët në Rregulloren Themelore dhe në Rregulloren e Ciklit të Parë. Institucioni ofron mundësinë për studentët të shfaqin edhe interesin e tyre për të aplikuar pranë KU “Bedër” me anë të një formulari interesimi dhe kjo mundëson marrjen nga ana e tyre të informacionit paraprak krahas ndjekjes së procedurave të aplikimit dhe të regjistrimit në portalin U-Albania.</p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të</p>	<p>KU “Bedër” në kuadër të transparencës kundrejt studentëve dhe palëve të treta të interesuara, publikon në faqen e internetit gjithë informacionin e nevojshëm për përmbajtjen e programeve Bachelor që ofron. Sa më sipër, njësitë bazë kanë faqet e tyre të internetit, të cilat mund të aksesohen si në</p>

¹⁹⁶ Evidenca nr. 44: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë

¹⁹⁷ Evidenca nr. 76: Performanca e studentëve nga Zyra e Sekretarisë Mësimore

¹⁹⁸ Evidenca nr. 41: Guida e Studentit

¹⁹⁹ Evidenca nr. 16: Rregullorja Themelore

²⁰⁰ Evidenca nr. 36: Vendimi i Senatit Akademik për miratimin e kriterëve të pranimit të studentëve në programin “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”

²⁰¹ Evidenca nr. 44: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë

²⁰² Evidenca nr. 12: Rregullorja e programit “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”, neni 20

<p>pjesëshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>mënyrë të drejtpërdrejtë, po ashtu edhe përmes faqeve të njësive kryesore apo atyre bazë, siç janë faqet e fakulteteve apo departamenteve. Në këto faqe ka një paketë të gjerë transparence në lidhje me programet e studimit që ofrohen, përfshirë këtu personelin akademik, kurrikulat, syllabuset e lëndëve, këshillat e departamenteve, etj.</p> <p>Po ashtu, procedurat, përzgjedhjet e studentëve dhe njoftime që lidhen me procesin e regjistrimit apo të transferimit të studimeve, bëhen në faqen zyrtare, dhe në platformë që administrohen nga KU "Bedër".^{203 204}</p> <p>Këto informacione mund të sigurohen edhe përmes sekretarive të Departamenteve, Sekretarisë Mësimore, apo pranë Zyrës së Pranimit (https://www.beder.edu.al/sh/news/other/lista-e-kandidateve-fitues-te-raundit-te-pare-viti-akademik-2020-2021/1591).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Procedurat e pranimit të studentëve për çdo vit akademik, si edhe kuotat për çdo program studimi, së bashku me kriteret e pranimit, i dërgohen ministrisë përkatëse, si edhe bëhen publike përmes faqes së internetit. Varësisht afateve të përcaktuara nga agjencitë shtetërore, KU "Bedër" mban lidhje të ngushta me drejtoritë arsimore rajonale dhe përmes panairëve të karrierës në qytete dhe qendra të ndryshme të vendit. Përmes kësaj praktike, maturantët e këtyre shkollave njihen me ofertën akademike të KU "Bedër".²⁰⁵ Në përputhje edhe me legjislacionin në fuqi, kuotat kriteret dhe oferta akademike krahas publikimit të tyre në faqen e internetit të institucionit publikohen edhe në portalin U-Albania për të qenë të aksesueshme nga të gjithë studentët dhe të interesuarit.</p>
<p>Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Siç u përmend edhe më sipër, procedurat e pranimit të studentëve për çdo vit akademik, si edhe kuotat për çdo program studimi,²⁰⁶ së bashku me kriteret e pranimit, i dërgohen ministrisë përkatëse, si edhe bëhen publike përmes faqes së internetit.</p> <p>Programi përcakton dhe ndjek afatet e aplikimit dhe regjistrimit në përputhshmëri të plotë me udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për Arsimin. Nga ana e KU "Bedër" me qëllim mbështetjen e diversitetit në programet e studimit të ofruar nga ky IAL parashikohen çdo vit edhe kuota për studentët me aftësi ndryshe dhe kuota për studentë të huaj apo të ardhur nga trevat shqiptare jashtë atdheut.²⁰⁷</p>
<p>Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>KU "Bedër" është një institucion që ka kritere për pranimin e studentëve. Varësisht politikave institucionale si një institucion jofitimprurës, KU "Bedër" ka pranuar një numër të kufizuar studentësh, në përputhje me infrastrukturën fizike dhe burimet njerëzore që zotëron. Përmes kësaj politike, KU "Bedër" ka synuar angazhimin maksimal të personelit akademik ndaj studentit, duke respektuar të gjitha kriteret e kërkuara në këtë drejtim. Përmes faqes së internetit, broshurave, takimeve të drejtpërdrejta, panairëve, etj., KU "Bedër" bën publike ofertën vjetore të programeve që ofron. Çdo periudhë Janar-Prill të vitit akademik, KU "Bedër" në përputhje edhe me organizimet e parashikuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, përfshihet në fushata promovionale me qëllim sjelljen më nga afër të informimit për ofertën akademike maturantëve, kjo me anë të vizitave nëpër qytete të ndryshme apo nëpërmjet pjesëmarrjes në</p>

²⁰³ Evidenca nr. 36: Vendimi i Senatit Akademik për miratimin e kriterëve të pranimit të studentëve në programin "Bachelor" në "Teknologji Informatik dhe Komunikim"

²⁰⁴ Evidenca nr. 44: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë, neni 35

²⁰⁵ Evidenca nr. 36: Vendimi i Senatit Akademik për miratimin e kriterëve të pranimit në programin "Bachelor" në "Teknologji Informatik dhe Komunikim"

²⁰⁶ Evidenca nr. 77: Vendimi i Senatit Akademik për miratimin e kuotave të pranimit të studentëve në programin "Bachelor" në "Teknologji Informatik dhe Komunikim"

²⁰⁷ Evidenca nr. 77: Vendimi i Senatit Akademik për miratimin e kuotave të pranimit të studentëve në programin "Bachelor" në "Teknologji Informatik dhe Komunikim"

	panairet e organizuara me këtë qëllim.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Të gjitha këto informacione janë të aksesueshme edhe për publikun me anë të faqes së internetit, konkretisht me Guidën e Studentit. ²⁰⁸ Këto informacione mund të merren nga studentët edhe pranë sekretarisë së Departamentit apo pranë Sekretarisë Mësimore. ²⁰⁹ Po ashtu, mund të merren edhe nëpërmjet këshilltarit akademik. Informacion paraprak në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin parashikohet edhe në Rregulloren e Ciklit të Parë të Studimeve dhe Provimeve, në rregulloren e Programit, në Kontratën e Studentit, si dhe në Rregulloren Themelore. ^{210 211 212}
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Njohja e plotë ose e pjesshme e krediteve të grumbulluara nga një student, bëhet nga komisioni i përzgjedhjes dhe pranimit të studentëve me tre anëtarë që ngrihet nga Këshilli i Departamentit ²¹³ vendos për transferimet që kryhen në programet e KU "Bedër". Ky komision kryen të gjitha procedurat përkatëse të ekuivalentimit të lëndëve për programet e ciklit të parë, duke i shoqëruar me një argumentim mbi kushtet e pranimit. Në përputhje me këtë, studentët të cilët kanë kryer procedurat e ekuivalentimit, pajisen me diplomë vetëm në rast se kanë ndjekur jo më pak se dy semestra studime pranë KU "Bedër". ²¹⁴
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Në çdo program lëndor, i cili është publik në faqen e departamentit, gjenden edhe kriteret apo zërat e vlerësimit, gjë e cila ju bëhet e ditur studentëve që në javën e parë të prezantimit të lëndës. Po ashtu, edhe në sistemin BIS, këto zëra vlerësimi ofrohen në kohë reale. ²¹⁵ Më tej, po në sistemin BIS, gjendet ecuria dhe vazhdimësia, jo vetëm e një lënde, por e gjithë periudhës së studimeve, nota dhe pikët e secilës lëndë; notat dhe pikët e grumbulluara, pjesëmarrja në leksione dhe seminare, si edhe mesatarja e gjeneruar nga sistemi.
Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Në programin e studimit, studentët kanë të përfshirë një lëndë të posaçme dedikuar kërkimit shkencor dhe shkrimit akademik, e cila është lëndë e detyrueshme. Po ashtu, studentët kanë një udhëheqës përgjatë punimit të diplomës, me të cilin kryejnë në mënyrë të detyrueshme seanca konsultimi rreth punimit të diplomës. ²¹⁶

²⁰⁸ Evidenca nr. 41: Guida e Studentit

²⁰⁹ Evidenca nr. 78: Shembull, kontratë studenti

²¹⁰ Evidenca nr. 12: Rregullorja e programit "Bachelor" në "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi"

²¹¹ Evidenca nr. 44: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë

²¹² Evidenca nr. 16: Rregullorja Themelore

²¹³ Evidenca nr. 79: Vendimi për ngritjen e Komisionit për Vlerësimin dhe Përzgjedhjen e Studentëve

²¹⁴ Evidenca nr. 80: Rregullorja e Transferimit të Studimeve

²¹⁵ Evidenca nr. 19: Shembull syllabusi (https://cmp.beder.edu.al/sh/content/default/bachelor-ne-teknologji-informacioni-dhe-komunikimi-16/616/617/?_con=0&cid=4470&t=1&oid=3835)

²¹⁶ Evidenca nr. 81: Syllabusi i lëndës "Metodat e Kërkimit dhe Shkrimit Akademik"

	<p>KU "Bedër", organizon herë pas here seanca trajnimesh për kërkimin shkencor, duke iu ardhur në ndihmë studentëve në një mënyrë ekstrakurrikulare.^{217 218 219} Kriteret e diplomimit, përsa i përket parakushteve të mesatares së nevojshme për t'u diplomuar, mbështetjes së udhëheqësit akademik dhe mundësisë për përzgjedhjen e një provimi formues apo një punimi diplome, parashikohen si në Rregulloren Themelore, ashtu edhe në Rregulloren e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Parë dhe në Manualin mbi punimin e diplomës.</p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Siç është thënë edhe më sipër, KU "Bedër" mban lidhje të ngushta me drejtoritë arsimore rajonale dhe përmes panaireve të karrierës në qytete dhe qendra të ndryshme të vendit. Përmes kësaj praktike, maturantët e këtyre shkollave njihen me ofertën akademike të KU "Bedër".</p> <p>Nga ana tjetër, KU "Bedër", publikon katalogje, publikon përmes faqes zyrtare të internetit, shpërndan broshura, organizon takime të drejtpërdrejta, është pjesë e panaireve etj.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>√</p>

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>Institucioni, nëpërmjet ditëve të orientimit, ndjek politika mbështetëse për studentët. Çdo grup i caktuar studentësh është nën përkujdesjen e një këshilltari akademik, i cili ndihmon në mbarëvajtjen e çështjeve mësimore. Kjo parashikohet në nenin 6 të Rregullores së Studimeve të Ciklit të Parë dhe Provimeve.²²⁰</p> <p>Përgjatë ditëve të orientimit, studentët njihen me stafin akademik dhe me atë administrativ, orarin, sistemin BIS, strukturën e KU "Bedër", kohëzgjatjen dhe organizimin e programit.</p> <p>Këto informacione dhe shumë të tjera ofrohen si nga sistemi BIS, ashtu edhe nga faqja zyrtare e KU "Bedër" (https://cmp.beder.edu.al/sh/content/default/bachelor-ne-teknologji-informacioni-dhe-komunikimi-19/616/617).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Siç u përmend edhe më sipër, shumë të dhëna ofrohen si nga sistemi BIS, ashtu edhe nga faqja zyrtare e KU "Bedër".</p> <p>Në faqe, gjendet Guida e Studentit, e cila prezantohet edhe në "Ditët e Orientimit", struktura dhe ngarkesa e programit të studimit, modulet dhe lëndët. Nga ana tjetër, nëpërmjet sistemit BIS studentët informohen për gjëra më specifike, lëndët përkatëse, informacione që mund të merren edhe pranë Zyrës së Sekretarisë Mësimore.</p>

²¹⁷ Evidenca nr. 12: Rregullorja e programit "Bachelor" në "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi"

²¹⁸ Evidenca nr. 16: Rregullorja Themelore

²¹⁹ Evidenca nr. 62: Manuali për përgatitjen e tezës së diplomës dhe kriteret e vlerësimit të tezës për studentët e ciklit të parë

²²⁰ Evidenca nr. 44: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë

<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>Për të ndihmuar studentët në orientimin dhe këshillimin e karrierës, KU “Bedër” ka ngritur Zyrën e Planifikimit të Karrierës, e cila funksionon pranë Dekanatit të Studentëve. Në këtë zyrë, çdo departament emëron një këshilltar për planifikimin e karrierës, i cili ofron konsulencë për studentët e regjistruar. Këshilltari i karrierës informon studentët mbi organizimin e seminareve, rreth teknikave të kërkimit të punës, të shkrimit të CV-së dhe kalimit me sukses të intervistës paraprake; kërkon mundësitë e punësimit për të gjithë studentët që do të diplomohen në programin “Bachelor”, organizon aktivitete të cilat synojnë ruajtjen e marrëdhënieve mes studentëve edhe pas diplomimit të tyre etj.^{221 222}</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>KU “Bedër” parashikon fonde për blerjen e literaturës së specializuar në fushën e kërkimit shkencor, duke i akorduar çdo departamenti një fond të caktuar për pasurimin e bibliotekës me botimet dhe publikimet më të fundit të fushës.</p> <p>Varësisht nevojave të programeve akademike, KU “Bedër” ofron mjedise që ndihmojnë studentin për formimin praktik dhe profesional. Të tilla janë laboratorit i Gjuhëve të Huaja, laboratorit i kompjuterave, etj.</p> <p>Lidhur me infrastrukturën, KU “Bedër” dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme hapësira, si: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve.</p> <p>KU “Bedër”, në varësi të programeve të studimeve, disponon kompjutera në laboratorët e teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale si programe për statistikë dhe gjuhësi. Ndërkohë, KU “Bedër” është i pajisur me të gjitha kushtet e nevojshme për të zhvilluar një proces mësimor sa më bashkëkohor. Pajisja e ambienteve mësimore me tabela interaktive (smart board), projektorë, kompjutera, karrige ortopedike, etj., mundësojnë një proces mësimor cilësor. Gjithashtu, me qëllim informimin sa më të plotë të studentëve me programin që ndjekin, kurrikulën personelin dhe infrastrukturën në dispozicion të tyre, çdo fillim viti akademik organizohen ditë të orientimit studentor ku studentët e viteve të para kryesisht, por jo vetëm edhe studentët e viteve të tjera njihen nga afër me njësinë bazë dhe lektorët që lektrojnë tek programi i përzgjedhur prej tyre, me kurrikulën, laboratorët, dhe infrastrukturën në dispozicion, sistemin e automatizuar BIS, si dhe shërbimet e ofruara nga zyrat e personelit. Ditët dhe seancat e orientimit kontribuojnë në sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. Në ditët e informimit janë të pranishëm edhe këshilltarët akademikë dhe koordinatorët e programeve, të cilët sigurojnë mbarëvajtjen e mësimdhënies dhe mësimnxënies në program në dimensionin afatgjatë.</p> <p>Siç u përmend edhe më sipër, me qëllim për të garantuar një komunikim sa më të shpejtë midis institucionit dhe studentit, KU “Bedër” ndjek politikë mbështetëse për studentët, nëpërmjet veprimtarive të orientimit dhe të kujdestarisë. Çdo grup i caktuar studentësh është nën përkujdesjen e një këshilltari akademik, i cili ndihmon në mbarëvajtjen e çështjeve mësimore.²²³</p>
<p>Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm</p>	<p>Përveç kësaj, Zyra e Sekretarisë Mësimore, në çdo kat bën afishimet e njoftimeve të ndryshme në tabelat e vendosura, bën njoftime edhe me anë të postës elektronike në adresat personale që kanë studentët të ofruara nga Zyra e IT-së në KU “Bedër”. Në momentin e nënshkrimit të kontratës, Zyra e IT-së pajis me një adresë institucionale të gjithë studentët e regjistruar. Në lidhje me njoftimet për studentët e regjistruar, apo edhe për ata të rinj që shprehin</p>

²²¹ Evidenca nr. 29: Komunikim shkresor i Zyrës së Planifikimit të Karrierës me institucionet e zhvillimit të praktikave profesionale

²²² Evidenca nr. 23: Vendimi i Këshillit të Departamentit për caktimin e përfaqësuesit pranë Zyrës së Planifikimit të Karrierës

²²³ Evidenca nr. 24: Vendimi i Këshillit të Departamentit për caktimin e këshilltarit akademik

nga studentët edhe në distance.	<p>interes, KU "Bedër" përdor faqen zyrtare të internetit, si edhe profilet në rrjetet sociale, si mjete të rëndësishme të komunikimit të jashtëm. Në këtë funksion, pranë KU "Bedër" shërben edhe Zyra e Protokollit dhe Korrespondencës.</p> <p>Studentët e regjistruar në KU "Bedër" informohen në kohë reale përmes sistemit të automatizuar BIS (Bedër Information System), ku në ekranin e gjithësecilit shfaqet njoftimi përkatës. Komunikimi i brendshëm në KU "Bedër" kryhet nëpërmjet sekretarive të ngritura pranë njësive bazë dhe njësive kryesore.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.	Zyra e Sekretarisë Mësimore pranë KU "Bedër" ndjek nga afër regjistrimin e të gjithë studentëve, duke krijuar dosjen individuale për secilin prej tyre. Nga ana tjetër, Zyra e Sekretarisë Mësimore, ndër funksionet e saj ka edhe përpunimin e të dhënave në formë statistikore të të diplomuarve. Kjo parashikohet në rregulloren e Zyrës së Sekretarisë Mësimore, neni 3 i saj. ²²⁴
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Zyra e Sekretarisë Mësimore pranë KU "Bedër" disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, çregjistrimet, diplomimet dhe mospërfundimin me sukses të vitit akademik, në të cilin zhvillohet programi i studimeve duke i raportuar këto statistika te instancat përkatëse. Institucioni siguron informacion në kohë reale përmes sistemit BIS, si dhe nëpërmjet sekretarive të ngritura pranë njësive bazë dhe njësive kryesore.
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.	Të gjitha rezultatet e vlerësimit të studentëve në çdo lëndë nëpërmjet Sekretarisë së Departamentit i kalojnë Zyrës së Sekretarisë Mësimore, e cila i arkivon ato.
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Siç u përmend më sipër, Zyra e Sekretarisë Mësimore pranë KU "Bedër" ndjek nga afër regjistrimin e të gjithë studentëve duke krijuar dosjen individuale për secilin prej tyre dhe raporton në mënyrë periodike, të gjitha të dhënat statistikore, te personat apo instancat e autorizuar. ²²⁵
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilit dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në	Pranë Dekanit të Studentëve është ngritur Zyra për Planifikimin e Karrierës, e cila është e angazhuar në ndjekjen e mundësive për praktika profesionale të studentëve. Kjo zyrë i ndjek ata deri në çastin e diplomimit. Në kuadër të planifikimit të karrierës, krahas Zyrës së Planifikimit të Karrierës, KU "Bedër", pranë çdo departamenti ka një përfaqësues, i cili u

²²⁴ Evidenca nr. 82: Rregullorja e Zyrës së Sekretarisë Mësimore

²²⁵ Evidenca nr. 39: Udhëzuesi i Sistemit Informativ Bedër (BIS)

drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	<p>mundëson studentëve lidhjet e tyre me tregun e punës.</p> <p>Zyra për Planifikimin e Karrierës ndjek nga afër edhe procesin e praktikave profesionale të studentëve të cilëve ju ka krijuar një mundësi të tillë.</p> <p>Gjithashtu, në nivel departamenti ka pasur një sërë aktivitetesh, të cilat ju vijnë në ndihmë studentëve për të krijuar sa më shumë lidhje me tregun e punës. Përmendim këtu edhe serinë e leksioneve të hapura të zhvilluara gjatë viteve akademike, etj. ^{226 227}</p> <p>Nga ana tjetër, çdo grup studentësh ka një këshilltar akademik, të përcaktuar nga njësi bazë në çdo fillim viti akademik.</p> <p>Këshilltari ndjek dhe udhëzon studentin mbi anën akademike, gjatë periudhës studimore. Këshilltari miraton formularët e regjistrimit semestral për çdo student përkatës. Detyrat e këshilltarit akademik janë të parashikuara në Rregulloren mbi Organizimin Akademik.²²⁸</p> <p>Këshilltarit akademik i sigurohet një akses i posaçëm në llogarinë e tij në BIS, për një komunikim më të detajuar me studentët që ka nën përkujdesje. Të dhëna të përditësuara në lidhje me cilësinë e studentëve në hyrje dhe në dalje me bazë programi dhe njësi, përqindjen e punësimit të të diplomuarve dhe performancën e tyre përfshihen në raportet vjetore të njësisë bazë të njësisë kryesore dhe gjithashtu në raportin institucional.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Për të garantuar përfshirjen dhe përfaqësimin e studentëve në organet vendimmarrëse, në KU “Bedër” është ngritur Dekani i Studentëve, i cili është përgjegjës për mbarëvajtjen e marrëdhënieve të studentëve me institucionin. Dekani i Studentëve është përgjegjës për përdorimin sa më me efikasitet të burimeve të institucionit dhe për menaxhimin e marrëdhënieve të sipërpërmendura në përputhje me parimin “Studenti në qendër të universitetit”. Dekani i Studentëve kryen detyrat e tij në bashkëpunim me Rektorin dhe/ose Zëvendësrektorin. Kjo instancë i kushton rëndësi të veçantë kujdesit ndaj studentëve, duke pasur si mision kryesor orientimin, këshillimin dhe mbrojtjen e të drejtave të studentëve me anën e zyrave përkatëse.</p> <p>Një rol të veçantë në këtë aspekt, luan edhe Presidenti i Këshillit Studentor.</p> <p>Mbështetja nga Dekani i Studentëve fillon që nga momenti i aplikimit të studentit dhe vazhdon edhe pas diplomimit, duke ruajtur një marrëdhënie produktive dhe mbështetëse, si për studentin ashtu edhe për</p>

²²⁶ Evidenca nr. 27: Raporti i aktiviteteve të zhvilluara ndër vite

²²⁷ Evidenca nr. 29: Komunikim shkresor i Zyrës së Planifikimit të Karrierës me institucionet e zhvillimit të praktikave profesionale

²²⁸ Evidenca nr. 17: Rregullorja mbi Organizimin Akademik

	<p>institucionin. Gjithashtu, Dekani i Studentëve organizon dhe mbështet studentët në praktikat profesionale, aktivitete sociale, projekte të ndryshme, si dhe në gjetjen e mundësive të ndryshme të punësimit.²²⁹ Përfshirja e studentëve në mbledhjet e njësive kryesore dhe njësive bazë, si dhe përfshirja e tyre si pjesë e detyrimeve ligjore në organet kolegjiale të KU “Bedër” është parashikuar edhe në vendimmarrjet e këtyre organeve. Senati Akademik i KU “Bedër” ka marrë vendim për përfshirjen aktive të studentëve përfaqësues nga qeveria studentore në mbledhjet e njësive të KU “Bedër”. Në përputhje edhe me detyrimet ligjore në fuqi ka pjesëmarrje të studentëve të zgjedhur nga Këshilli Studentor në Senatin Akademik në Njësinë SBC dhe në Komisionin e përhershëm për garantimin e standardeve dhe cilësisë.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>KU “Bedër” ka një rregullore të posaçme për vlerësimin e personelit në çdo fund semestri dhe viti akademik. Procedura dhe mënyra e vlerësimit organizohet sipas Rregullores mbi Anketat dhe Vlerësimet,²³⁰ e cila përfshin vlerësimet e studentëve për personelin, vetëvlerësimin e personelit, vlerësimin e eprorëve për vartësit, etj.</p> <p>Vlerësimi i metodave të mësimdhënies është pjesë e rezultateve të mbledhura nga anketat me studentët për çdo lëndë dhe pedagog. Varësisht këtyre rezultateve, departamentet marrin masa për përmirësimin e mëtejshëm të këtyre metodave të mësimdhënies. Anketimet me studentët zhvillohen dy herë në vit, para provimeve finale të çdo semestri.^{231 232}</p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Vlerësimi sasior i punës së studentëve në KU “Bedër” kryhet me anë të krediteve sipas sistemit amerikan dhe atij evropian të mbështetur në ECTS, kurse vlerësimi cilësor i punës së studentëve kryhet me anë të notave, të llogaritura sipas metodologjisë së përmendur në rregulloret mësimore.</p> <p>Përsa i përket ngarkesës, sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek programin “Bachelor” në “Teknologji Informatik dhe Komunikimi” me kohë të plotë, është 60 ECTS. Kjo vërtetohet edhe nga programet e licencuara nga MASR, dhe të shprehura në kurrikulën e programit, si edhe në Statutin e KU “Bedër”.²³³</p> <p>KU “Bedër” lejon transferimin e studentëve në vitet ndërmjetës nga IAL-të vendase ose të huaja, publike ose private, dhe anasjelltas, si edhe brenda programeve të studimeve që ai ofron. Ky proces bëhet pas një barasvlerësimi sipas planeve mësimore përkatëse. Transferimi lejohet ndërmjet programeve të të njëjtit cikël studimesh. Ngarkesa totale e orëve në auditor dhe punës individuale parashikohet në planin mësimor përkatës të hartuar në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe në Rregulloren e programit, në Rregulloren e Ciklit të Parë të Studimeve dhe Provimeve dhe në Rregulloren Themelore.</p> <p>KU “Bedër” ofron mundësi për transferime të studimeve midis programeve të të gjitha cikleve brenda KU “Bedër” apo nga/drejt institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë.</p> <p>Vendimi për njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve të grumbulluara nga një student, me qëllim vazhdimin e studimeve, i takon</p>

²²⁹ Evidenca nr. 50: Vendim i Senatit Akademik për studentët përfaqësues në mbledhje

²³⁰ Evidenca nr. 45: Rregullore e anketave dhe vlerësimeve

²³¹ Evidenca nr. 46: Anketa e studentit ndaj lëndës

²³² Evidenca nr. 83: Shembull, listëprezenca e përfaqësuesit të studentëve në mbledhje

²³³ Evidenca nr. 7: Statuti i Kolegjit Universitar “Bedër”

	<p>strukturës mësimore që pranon studentin.</p> <p>Një komision i përzgjedhjes dhe pranimi të studentëve me tre anëtarë që ngrihet nga Këshilli i Departamentit vendos për transferimet që kryhen në programet e KU "Bedër". Ky komision kryen të gjitha procedurat përkatëse të ekuivalentimit të lëndëve për programet e ciklit të parë, duke i shoqëruar me një argumentim mbi kushtet e pranimi. Në përputhje me këtë, studentët, të cilët kanë kryer procedurat e ekuivalentimit, pajisen me diplomë vetëm në rast se kanë ndjekur jo më pak se dy semestra studime pranë KU "Bedër".</p> <p>Mënyra e transferimit në programet e ofruara në KU "Bedër" parashikohet në rregulloret mësimore të KU "Bedër".²³⁴</p>								
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Në faqen e çdo departamenti, janë të publikuara të gjitha syllabuset e viteve të kaluara, gjë e cila është e aksesueshme nga publiku, si dhe nga studentët. Në këtë kuptim, pedagogët mund të konsultojnë atë me studentët përgjatë diskutimit dhe prezantimit të lëndës.</p> <p>KU "Bedër" i ka kushtuar një rëndësi të veçantë proceseve të ndryshme vetëvlerësuese, qofshin këto në lidhje me aspektin administrativ të institucionit, po ashtu edhe me aspektin akademik. Çdo fundviti, njësitë bazë dhe ato kryesore përgatisin raportin vjetor të cilin e dërgojnë në Rektorat. Në këto raporte, përveç pasqyrimit të aktiviteteve, rëndësi i kushtohet edhe analizës SWOT. Studentët kanë qenë përherë pjesëmarrës aktivë dhe pjesë e vendimmarrjes në takimet për riorganizimin e programeve të studimit apo mes të tjerash edhe në mbledhjet me në fokus ndryshimin e kurrikulës.</p>								
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Anketimet e studentëve për personelin akademik, për të cilat u fol më sipër, plotësohen përmes sistemit të automatizuar BIS, para zhvillimit të provimeve finale në çdo fund semestri. Plotësimi i pyetësorëve është anonim dhe përgjigjet përpunohen në mënyrë automatike dhe të pavarur.</p> <p>Pas sigurimit të të dhënave vlerësuese për personelin akademik, në fund të çdo semestri akademik bëhet edhe vlerësimi për secilin anëtar të personelit akademik, rezultati i të cilit dorëzohet nëpërmjet një zarfi të mbyllur, tek pedagogët përkatës.²³⁵</p> <p>Po ashtu, në rast kundërshtimi të notës, studentët mund të kërkojnë rishqyrtimin e provimit me anë të një kërkesë në Zyrën e Sekretarisë Mësimore.²³⁶</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="724 1429 919 1509">Nuk përmbushet</th> <th data-bbox="919 1429 1098 1509">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="1098 1429 1308 1509">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1308 1429 1477 1509">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="724 1509 919 1568"></td> <td data-bbox="919 1509 1098 1568"></td> <td data-bbox="1098 1509 1308 1568"></td> <td data-bbox="1308 1509 1477 1568">√</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				√
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			√						

Standardi V.6

Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët

Kriteret

Vlerësimi

²³⁴ Evidenca nr. 80: Rregullorja e Transferimit të Studimeve

²³⁵ Evidenca nr. 84: Anketë vlerësimi e studentëve ndaj institucionit

²³⁶ Evidenca nr. 44: Rregullorja e studimeve dhe provimeve të ciklit të parë, neni 24

<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>KU “Bedër” dhe Fakulteti i Teknologjisë dhe Biznesit, si njësi e saj kryesore, në kuadër të transparencës kundrejt studentëve dhe palëve të treta të interesuara, publikon në faqen e internetit gjithë informacionin e nevojshëm për përmbajtjen e programeve “Bachelor” që ofron. Gjithashtu, studentët pajisen me syllabusin përkatës nga çdo lektor në fillim të semestrit. Informacione të ndryshme mund të vijnë në ndihmë për studentët edhe nga Zyra e Sekretarsë Mësimore apo nga Sekretaria e Departamentit.</p>				
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Nëpërmjet këshillimit të karrierës, leksioneve të hapura, të ftuarve të ndryshëm, seminareve profesionale etj.,²³⁷ studentët e KU “Bedër” informohen hollësisht për mundësitë e punësimit pas diplomimit në këtë program studimi.²³⁸ Këshilltari akademik caktohet me vendim departamenti për çdo vit studimi dhe për çdo program. Si i tillë, ai mbështet dhe monitoron nga afër studentët në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p> <p>Në Departamentin e Shkencave Kompjuterike ka pasur një gamë të gjerë leksionesh të hapura, përmes të cilave studentët janë informuar mbi mundësitë e punësimit në tregun e punës.</p>				
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Për të ndihmuar studentët në orientimin dhe këshillimin e karrierës, KU “Bedër” ka ngritur Zyrën e Planifikimit të Karrierës, e cila funksionon pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Studentin. Pranë kësaj zyre, çdo departament emëron një këshilltar për planifikimin e karrierës, i cili ofron konsulencë për studentët e regjistruar.</p> <p>Këshilltari i karrierës informon studentët mbi organizimin e seminareve, rreth teknikave të kërkimit të punës, të shkrimit të CV-së dhe kalimit me sukses të intervistës paraprake; kërkon mundësi punësimi për të gjithë studentët e diplomuar në programet “Bachelor” dhe “Master”, organizon aktivitete që synojnë ruajtjen e marrëdhënieve mes studentëve edhe pas diplomimit të tyre, etj.</p> <p>Një rol i rëndësishëm i kësaj zyre është mundësia e praktikave profesionale për studentët e të gjithë departamenteve që ofron KU “Bedër”.²³⁹</p>				
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Zyra e të Diplomuarve përgatisin raporte periodike në lidhje me punësimin e studentëve, trajnimin e tyre, dhe mundësi që ofron tregu, dhe jua paraqesin ato studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p> <p>KU “Bedër”, në strukturën organizative ka ngritur Zyrën e të Diplomuarëve, e cila funksionon në varësi të Dekanit të Studentëve. Kjo zyrë mban të dhëna në lidhje me të diplomuarit, punësimin e tyre, etj. Në lidhje me këtë pikë dhe konkretisht në lidhje me programin përkatës “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” duhet saktësuar që programi këtë vit diplomom brezin e parë të studentëve dhe si i tillë nuk ka një brez të diplomuarish të gjurmuar përsa i përket punësimit të tyre apo të diplomuar tashmë të punësuar në profil, ka vetëm studentë të cilët gjatë viteve të studimeve univeristare janë përfshirë në praktika profesionale pranë kompanive apo institucioneve me të cilat KU “Bedër” ka një MOU apo marrëveshje bashkëpunimi.</p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së</p>	<table border="1"> <tr> <td data-bbox="686 1825 837 1910">Nuk përmbushet</td> <td data-bbox="837 1825 1037 1910">Përmbushet pjesërisht</td> <td data-bbox="1037 1825 1236 1910">Përmbushet kryesisht</td> <td data-bbox="1236 1825 1449 1910">Përmbushet plotësisht</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		

²³⁷ Evidenca nr. 27: Raporti i aktiviteteve të zhvilluara ndër vite

²³⁸ Evidenca nr. 24: Vendimi i Këshillit të Departamentit për caktimin e këshilltarit akademik

²³⁹ Evidenca nr. 29: Komunikim shkresor i Zyrës së Planifikimit të Karrierës me institucionet e zhvillimit të praktikave profesionale

standardit				√
------------	--	--	--	---

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	<p>Qëllimi i Kolegjit Universitar “Bedër” është përmbushja e misionit të tij përmes një mësimdhënieje, kërkimi shkencor cilësor, krijimi i kushteve të përshtatshme për zhvillimin dhe përmirësimin e cilësisë dhe efijencës së stafit të tij dhe garantimin e mbështetjes së tyre për një punë sa më produktive.</p> <p>Me qëllim vlerësimin akademik dhe zhvillimin e cilësisë, pranë KU “Bedër” është ngritur Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, si dhe dy komisione të përhershme, të cilët kanë dhe faqen e tyre zyrtare në Web, (www.qac.beder.edu.al). Funkcionimi dhe kompetencat e tyre janë të specifikuar në rregulloret përkatëse, si dhe të shprehura në Statutin e KU “Bedër”.^{240 241} Në këto kompetenca përfshihet zhvillimi dhe monitorimi i anketës që realizohet nga ana e studentëve për personelin akademik dhe përmbajtjen e lëndëve. KU “Bedër” për vlerësimin akademik dhe zhvillimin e cilësisë ka ngritur, siç u tha më sipër, edhe dy komisione të përhershme: Komisioni i përhershëm për kërkimin shkencor, projektet, aplikimet dhe inovacionin dhe Komisioni i përhershëm për garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe të programeve të studimit. KU “Bedër” është përgjegjës për sigurimin e cilësisë në përgatitjen e studentëve, sipas standardeve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Për verifikimin periodik të cilësisë dhe përmirësimin e saj janë krijuar Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë Institucionale dhe Programeve të Studimit ²⁴² dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJBSC), e cila përbëhet nga pesë anëtarë, tre pedagogë të brendshëm, një student dhe një ekspert i jashtëm.²⁴³</p>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin	KU “Bedër” është përgjegjës për sigurimin e cilësisë në përgatitjen e studentëve, sipas standardeve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Për verifikimin periodik të cilësisë dhe përmirësimin e saj janë krijuar Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve të

²⁴⁰ Evidenca nr. 48: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC-së

²⁴¹ Evidenca nr. 8: Statuti i Kolegjit Universitar “Bedër”. Kreu VIII, neni 28

²⁴² Evidenca nr. 85: Vendim senati për miratimin e ngritjes së komisioneve të përhershme

²⁴³ Evidenca nr. 48: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC-së

<p>e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Cilësisë Institucionale dhe Programeve të Studimit dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJBSC), e cila përbëhet nga pesë anëtarë, tre pedagogë të brendshëm, një student dhe një ekspert i jashtëm.²⁴⁴ Kjo njësi varet drejtpërdrejt nga Rektori; ajo ka autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat e institucionit. Njësia kryen vëzhgime dhe studime të vazhdueshme në procesin mësimor dhe shkencor, duke përgatitur raporte me shkrim. Kompetenca të kësaj njësie përfshijnë hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, hartimin e standardeve për sigurimin e cilësisë, në përputhje me Kodin e Cilësisë, vlerësimin në mënyrë periodike, rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore në njësitë kryesore të Kolegjit, në përputhje me standardet, kryerjen e studimeve gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga institucioni, në bashkëpunim me njësitë përkatëse, organizimi i pyetësorit studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi në bashkëpunim me Zyrën e Sekretarisë Mësimore dhe raportimin e rezultateve dhe propozimeve përkatëse përpara Senatit Akademik.²⁴⁵</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>KU “Bedër” ka kaluar me sukses 2 akreditime institucionale, të parin në vitin 2013 nga APAAL dhe të dytin në vitin 2017 nga agjensia britanike e akreditimit “Quality Assurance Agency”, në bashkëpunim me ASCAL.²⁴⁶</p> <p>Institucioni ka gjithashtu edhe një rregullore të anketave dhe të vlerësimeve, e cila rregullon procesin e mbledhjes së të dhënave dhe të përdorimit të tyre në funksion të sigurimit të cilësisë. Kjo rregullore parashikon marrjen e informacionit nga anketat e plotësuara nga ana e stafit akademik, administrativ dhe studentët. Ky informacion analizohet me qëllim rregullimin e procesit të vlerësimit të arsimimit, mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe çdo shërbimi të ofruar nga Kolegji Universitar “Bedër”.</p> <p>Kolegji Universitar “Bedër” siguron dhe mbështet stafin akademik, administrativ dhe studentët përmes proceseve të mëposhtme të anketimit dhe vlerësimit:²⁴⁷</p> <ul style="list-style-type: none"> • Anketa vetëvlerësuese e stafit akademik; • Anketë vlerësimi e stafit akademik ndaj institucionit; • Anketë vlerësimi e stafit administrativ ndaj institucionit; • Anketë vlerësimi e studentit ndaj institucionit; • Anketa vlerësuese e studentit për stafin akademik. <p>Në rregulloren e NJSBC-së gjithashtu parashikohet që kjo njësi ndjek procesin e vlerësimit të brendshëm të institucionit, si dhe mbikëqyrjen e përgatitjes së raportit të vetëvlerësimit, ndjek përgatitjen e terrenit për “vlerësimin e jashtëm” të Kolegjit Universitar “Bedër” dhe vënien në dispozicion të institucionit ose organizatës së vlerësimit të jashtëm të çdo informacioni të nevojshëm, ndjek nga afër punimet e vlerësimit të brendshëm dhe të atij institucional dhe i koordinon me masat e ndërmarra në kuadër të planifikimit strategjik, përmirësimit dhe monitorimit periodik.²⁴⁸</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të</p>	<p>KU “Bedër” i ka kushtuar një rëndësi të veçantë proceseve të ndryshme vetëvlerësuese, qofshin këto në lidhje me aspektin administrativ të institucionit, po aq edhe me aspektin akademik. Kompetencat e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në lidhje me sigurimin e cilësisë</p>

²⁴⁴ Shtojca nr. 8: Të dhëna për anëtarët e NJBSC (Tabela 24)

²⁴⁵ Evidenca nr. 10: Plani Strategjik 2018-2023

²⁴⁶ Evidenca nr. 2: Urdhër nr.223, datë 04.06.2013 “Për akreditimin institucional dhe të programeve të studimit”

²⁴⁷ Evidenca nr. 45: Rregullore e anketave dhe vlerësimeve

²⁴⁸ Evidenca nr. 48: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC-së

<p>studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>parashikohen si në Statutin e Institucionit, ashtu edhe në Rregulloren e Njësisë së Sigurimit të Cilësisë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të hartojë politikat dhe procedurat për sigurimin e brendshëm të cilësisë; • të hartojë standardet për sigurimin e cilësisë; • të vlerësojë në mënyrë periodike rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore në njësitë kryesore të Kolegjit, në përputhje me standardet; • të kryejë studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga Kolegji. <p>Në Statut, gjithashtu është e parashikuar që në fund të çdo semestri, para sezonit të provimeve, njësia organizon pyetësorin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi në bashkëpunim me Zyrën e Sekretarisë Mësimore dhe pas çdo vlerësimi raporton para Senatit Akademik rezultatet dhe propozimet përkatëse.^{249 250} Çdo fundviti akademik, njësitë bazë dhe ato kryesore përgatisin raportin vjetor, të cilin e dërgojnë në rektorat. Në këto raporte, përveç pasqyrimit të aktiviteteve, rëndësi i kushtohet edhe analizës SWOT.²⁵¹</p> <p>Senati i KU "Bedër", pas diskutimesh në plan të gjerë me të gjitha njësitë, ka miratuar Planin Strategjik 5-vjeçar të institucionit 2018-2023.²⁵² Ky plan strategjik, në përmbushje të misionit të institucionit, synon zhvillimin në tri fusha kryesore: mësimdhënie, kërkim shkencor dhe kontribut në shoqëri, si dhe vë në fokus të veçantë edhe elementët e vlerësimit. Në koherencë me këtë plan strategjik është hartuar edhe plani i veprimit për vlerësimin e kërkimit shkencor, si dhe është bërë plotësimi i kuadrit ligjor për funksionimin e komisionit të sigurimit të cilësisë dhe Komisionit të Përhershëm për Kërkimin Shkencor, Projektet dhe Inovacionin. Këto plan veprime synojnë kontrollin periodik të cilësisë së mësimdhënies ashtu edhe të kërkimit shkencor dhe kontributit të IAL në shërbimin komunitar.²⁵³</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="667 1120 821 1198">Nuk përmbushet</th> <th data-bbox="821 1120 1029 1198">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="1029 1120 1236 1198">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1236 1120 1444 1198">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">√</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				√
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			√						

<p>Standardi VI.2</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njëjësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Të paturit politika për monitorimin e cilësisë nga ana e komisionit është shoqëruar, sikundër u përmend më sipër, edhe me ngritjen e komisioneve përkatëse dhe njësisë përkatëse për sigurimin e cilësisë. Me qëllim vlerësimin akademik dhe zhvillimin e cilësisë, pranë KU "Bedër" është ngritur Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, si dhe Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit, të cilët kanë dhe faqen e tyre zyrtare në Web,</p>

²⁴⁹ Evidenca nr. 7: Statuti i Kolegjit Universitar "Bedër"

²⁵⁰ Evidenca nr. 48: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC-së

²⁵¹ Evidenca nr. 30: Raporti Vjetor i Departamentit të Shkencave Kompjuterike, viti akademik 2019-2020

²⁵² Evidenca nr. 15: Plani Strategjik 2012-2017

²⁵³ Evidenca nr. 86: Plan veprimi për vlerësimin institucional të kërkimit shkencor

	(www.qac.beder.edu.al). Funksionimi dhe kompetencat e tyre janë të specifikuara në rregulloret përkatëse, si dhe të shprehura në Statut. ^{254 255 256}
Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.	Senati Akademik është organ kolegjal vendimmarrës i Kolegjit Universitar “Bedër” që përcakton politikat e zhvillimit të institucionit, programon, bashkërendon, drejton dhe kontrollon veprimtaritë e mësimdhënies e të kërkimit shkencor dhe vlerëson efikasitetin e tyre. Senati Akademik kryesohet nga rektori dhe mbledhet periodikisht. Propozimet për ndryshimin e programeve mësimore përcillen për në Senat duke pasur parasysh parimin hierarkik vertikal: Departament - Dekanat - Rektor. Procesi i ndryshimit të kurrikulave bëhet nën koordinimin e Zyrës së Zhvillimit të Kurrikulave. Gjithashtu, nominalisht Senati Akademik monitoron veprimtarinë e komisionit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, vlerëson dhe garanton sigurimin e brendshëm të cilësisë në institucion. ^{257 258}
Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	Nga kompetencat e NJSBC-së dhe dy komisioneve të përhershme të përmendura më sipër është edhe zhvillimi i strategjive dhe i planeve vlerësuese për personelin akademik. Komisioni i përhershëm për sigurimin e cilësisë institucionale është organ kolegjal që kryen funksione në lidhje me garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe programeve të studimit. Në nenin 3, Funksionet e Komisionit parashikohet që Komisioni: <ul style="list-style-type: none"> • Miraton standarde dhe procedura që zbatohen në mënyrë uniforme në njësitë e institucionit, duke marrë për bazë profilin e IAL. • Përcakton kritere dhe masa që mundësojnë të identifikohet suksesi dhe mos përmbushja e objektivave në veprimtarinë e institucionit • Miraton, monitoron dhe kryen vlerësime periodike të programeve, në bashkëpunim me njësitë e tjera të Kolegjit <p>Siç u përmend edhe në pjesën përshkrimore, në fund të çdo viti akademik bëhet edhe vlerësimi për secilin anëtar të personelit akademik, rezultati i të cilit dorëzohet nëpërmjet një zarfi të mbyllur. Një tjetër proces vetëvlerësues auditimi i brendshëm është edhe ai i cili zhvillohet nga një komision (<i>ad-hoc</i>) i ngritur nga Rektori. Ky komision auditon njësitë akademike dhe administrative mbi ligjshmërinë e administrimit të dokumentacionit të brendshëm. Në rast mospërputhshmërie me dispozitat statutorë dhe të rregulloreve, grupi i punës u ngarkon detyrat përkatëse njësisive për t'i plotësuar konform kuadrit ligjor përkatës.^{259 260}</p>
Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Rezultatet e marra nga analiza ruhen, arkivohen dhe transmetohen nëpërmjet strukturave përkatëse, në lidhje me programet e studimit, për vendimmarrje të mëtejshme, të cilat janë të specifikuara në nenin 13 të Rregullores për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë. ²⁶¹ <p>Pas hartimit dhe miratimit të treguesve kyç të performancës dekanët e fakulteteve, në konsultim me stafin akademik të çdo departamenti, përcaktojnë prioritetet e fakulteteve për t'i renditur me prioritetet e</p>

²⁵⁴ Evidenca nr. 7: Statuti i Kolegjit Universitar “Bedër”

²⁵⁵ Evidenca nr. 48: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC-së

²⁵⁶ Evidenca nr. 85: Vendim senati për miratimin e ngritjes së komisioneve të përhershme

²⁵⁷ Evidenca nr. 7: Statuti i Kolegjit Universitar “Bedër”, neni 9

²⁵⁸ Evidenca nr. 38: Praktika e ndryshimit në kurrikul

²⁵⁹ Evidenca nr. 87: Njoftim për fillimin e auditimit të brendshëm

²⁶⁰ Evidenca nr. 85: Vendim senati për miratimin e ngritjes së komisioneve të përhershme

²⁶¹ Evidenca nr. 48: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC-së, neni 13

	universitetit.			
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.	<p>Raportet e vlerësimit të jashtëm apo të akreditimeve, si dhe raportet e auditimit të brendshëm institucional shoqërohen me plane veprimi ku parashikohen rezultatet e vlerësimit, masat që do të ndërmerren për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë dhe rezultatet e pritshme. Në këto plane veprimi gjithashtu caktohen njësitë përgjegjëse për ndjekjen e çështjes dhe periudha kohore e implementimit të masës së ndërmarrë.</p> <p>KU "Bedër" publikon rezultatet e vlerësimit të aktorëve të ndryshëm brenda institucionit (student, personel akademik dhe administrativ) në faqen e internetit të tij. Përsa u përket rezultateve të pritshme, KU "Bedër" ka bërë publik planin strategjik institucional për periudhën 2012-2017, si edhe planin e ri strategjik për periudhën 2018-2023.²⁶² KU "Bedër" synon ndërgjegjësimin e personelit të tij dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to. Për këtë arsye, vazhdimisht realizohen takime orientuese dhe informuese, si dhe janë vënë në dispozicion të studentëve dhe të personelit si: Guida e Studentit ²⁶³ dhe Guida e Stafit,²⁶⁴ ku shprehet qartë rëndësia e cilësisë dhe sigurimi i saj në fushën e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

Standardi VI.3

Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	<p>Anketat e vlerësimit të studentit ndaj stafit akademik dhe ndaj institucionit, ofrojnë një këndvështrim të thellë edhe mbi efektshmërinë e programit të studimit dhe nevojat për ndryshim me qëllim sigurimin e cilësisë.^{265 266}</p> <p>Vlerësimi i efektshmërisë së pedagogëve bëhet përmes disa mënyrave, e cila rregullohet sipas Rregullores së Anketave dhe Vlerësimit.²⁶⁷ Pedagogët vlerësohen përmes anketimeve të studentëve, vetëvlerësimit të tyre, si edhe vlerësimit të eprorit brenda njësisë.²⁶⁸</p> <p>Në fund të çdo semestri akademik, nëpërmjet anketimeve të përgatitura, studentët japin mendimin e tyre për pedagogun dhe brendinë e lëndës. Kjo anketë realizohet para provimit përfundimtar të çdo semestri.</p> <p>Vlerësimi i studentëve për pedagogun dhe brendinë e lëndës është objekt i diskutimit për përmirësimin e lëndës në vitin pasardhës, duke bërë ndryshime në format e vlerësimit, tekstet përkatëse, materiale plotësuese, deri në ndryshimin e pedagogut përkatës për zhvillimin e lëndës. Ndryshimet</p>

²⁶² Evidenca nr. 10: Plani Strategjik 2018-2023

²⁶³ Evidenca nr. 41: Guida e Studentit

²⁶⁴ Evidenca nr. 40: Guida e Stafit

²⁶⁵ Evidenca nr. 46: Anketa e studentit ndaj lëndës

²⁶⁶ Evidenca nr. 88: Anketë vlerësimi e stafit akademik/administrativ ndaj institucionit

²⁶⁷ Evidenca nr. 45: Rregullore e anketave dhe vlerësimeve

²⁶⁸ Evidenca nr. 56: Formulari i vetëvlerësimit për stafin akademik

	<p>e propozuara kurrikulare bëhen në koordinim më Zyrën për Zhvillimin e Kurrikulave. Zyra për Zhvillimin e Kurrikulave funksionon sipas një udhëzimi të miratuar nga Senati Akademik, dhe kjo tregon edhe njëherë rëndësinë që i kushtohet përmirësimit të programeve.²⁶⁹ Informacioni i dalë nga aplikimi i anketave të ndryshme përveç se trajtohet në mbledhjet e njësive, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe performancës së programit të ofruar, përfshihet në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Një metodë e rëndësishme për të përmirësuar punët në njësitë kryesore, bazë dhe administrative është edhe organizimi i prezantimeve të hapura të raporteve vjetore të përgatitura nga vetë njësitë. Në këto analiza vjetore marrin pjesë të gjithë anëtarët e personelit akademik dhe administrativ, të cilët shkëmbejnë përvojat dhe japin sugjerimet e tyre për përmirësimin e çështjeve që nevojiten.</p> <p>Nisur nga këto analiza dhe raporte, në fillim të çdo viti akademik hartohet nga njësia bazë plani i aktiviteteve për vitin në vijim.²⁷⁰ Njësitë bazë të institucionit gjithashtu organizojnë takime konsultative me profesionistë të fushës për t'u informuar më tepër mbi dinamikat e tregut të punës dhe mënyrën sesi këto dinamika duhen përcjellë tek ndryshimet në program.²⁷¹</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtëpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Komunikimet me përfaqësues dhe profesionistë të fushës në treg, ekzistenca e bordeve profesionale dhe periodizimi i takimeve të tyre me qëllim njohjen dhe përditësimin me të rejat dhe dinamikat e fundit të tregut, mundësojnë një vlerësim objektiv të realizimit dhe mbarëvajtjes së cilësisë së programit qoftë me anë të metodave të drejtëpërdrejta, apo edhe me anë të seancave “brainstorming” me partneritetet e ndryshme institucionale.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutuara nga ky program.</p>	<p>Studentët përfshihen në vlerësimin e pedagogëve dhe në atë të zbatimit të programeve të studimeve. Në fund të çdo semestri akademik, nëpërmjet anketimeve të përgatitura, studentët japin mendimin e tyre në lidhje me pedagogun dhe brendinë e lëndës. Bashkëngjitur është modeli i anketimit të zhvilluar.^{272 273}</p> <p>Programet e studimeve përmirësohen duke marrë për bazë rezultatet e vlerësimit të tyre nga personeli akademik dhe nga studentët.</p> <p>Metodat e tërthorta të vlerësimit janë implementuar me anë të anketës së zhvilluar me studentë me seksione të veçanta mbi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Pyetje lidhur me përmbajtjen e lëndës • Pyetje mbi performancën e pedagogut të lëndës • Pyetje mbi shërbimin e ofruar nga KU “Bedër” • Pyetje konceptuale • Rekomandime nga studentët

²⁶⁹ Evidenca nr. 89: Udhëzim mbi procesin e Zhvillimit të Kurrikulave

²⁷⁰ Evidenca nr. 22: Vendim i Këshillit të Departamentit për miratimin e planit të aktiviteteve, viti akademik 2020-2021

²⁷¹ Evidenca nr. 38: Praktika e ndryshimit në kurrikul

²⁷² Evidenca nr. 46: Anketa e studentit ndaj lëndës

²⁷³ Evidence nr. 88: Anketë vlerësimi e stafit akademik administrativ ndaj institucionit

	<p>Metoda të drejtëpërdrejta janë ato të përfshira edhe në syllabus-in e lëndës si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësim me pikë për aktivizimin në auditor; • Vlerësime me notë dhe me pikë; • Vlerësim të detyrave të kryera nga studentët; • Vlerësim për përfshirjen në aktivitete jashtë-shkollore; • Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës; • Vlerësime të studentëve nga njëri-tjetri për nivelin dhe formën e angazhimit të tyre në punë e projekte të realizuara në grup; • Vlerësime për testime ndërmjetëse të semestrit përkatës; • Vlerësime për testime finale në përfundim të semestrit. 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				√

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre

Kriteret

Vlerësimi

Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.

Krahas anëtarëve të NJSBC-së përfaqësues të stafit akademik, pjesë përbërëse e saj janë dhe përfaqësuesi i këshillit studentor, si dhe eksperti i jashtëm. Parimet e sigurimit të cilësisë në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm në programet e studimit të parashikuara në rregulloren e strukturës së NJSBC janë:

Gjithë-përfshirja - Proceset e sigurimit të cilësisë zbatohen për të gjitha dispozitat e Kolegjit Universitar "Bedër" në procesin e mësimnxënies dhe mësimdhënies ashtu dhe në programet e bashkëpunimit me institucionet e tjera. Përvoja e të mësuarit e të gjithë studentëve do të vlerësohet në mënyrë sistematike duke reflektuar rregullisht dhe në mënyrë periodike për të përmirësuar këto procese;

Koherenca - Komponentët e kornizës së cilësisë ndërlihen dhe veprojnë për të rishikuar në mënyrë koherente dhe tërësore informacionet dhe stafin/studentët prej të cilëve është marrë ky informacion;

Objektiviteti - Proceset e vlerësimit të cilësisë të institucionit udhëhiqen nga këndvështrimi dhe kontributi i ekspertëve dhe organizmave të institucionit;

Efikasiteti dhe përmirësimi - Komponentët e kornizës së cilësisë akademike dizajnohen për të analizuar në mënyrë rigoroz standardet akademike dhe rritjen e cilësisë akademike, si dhe përgjegjësi të transferuara.

Stafi i Kolegjit Universitar është kolektivisht përgjegjës për ruajtjen e standardeve akademike. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ka autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat e institucionit²⁷⁴.

Kriteri 2. Institucioni përcakton

Përgjegjësitë e dy strukturave të sigurimit të cilësisë, NJSBC dhe komisioni

²⁷⁴ Evidenca nr. 48: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC-së, Kreu 4

<p>përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>i përhershëm për garantimin e cilësisë, janë të parashikuara në rregulloret përkatëse. ²⁷⁵ Gjithashtu çdo njësi, individ dhe student është përgjegjës për zbatimin e çdo detyre dhe përgjegjësie në varësi të pozicionit që ka në KU “Bedër”.²⁷⁶</p> <p>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ka autonomi operative dhe akses në të gjitha të dhënat e institucionit. Komisioni i përhershëm për sigurimin e cilësisë institucionale, siç u përmend edhe më sipër, është organ kolegjal që kryen funksione në lidhje me garantimin e standardeve të cilësisë institucionale dhe programeve të studimit. Ky komision krahas hartimit të politikave dhe të standardeve për sigurimin e cilësisë miraton, monitoron dhe kryen vlerësime periodike të programeve, në bashkëpunim me njësitë e tjera të Kolegjit dhe koordinon ndërlidhjen me njësitë e tjera kryesore dhe bazë të institucionit dhe menaxhon sistemin e informacionit ndërmjet këtyre njësive.</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësive bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në analizat vjetore dhe seancat trajnuese mbi mbarëvajtjen e institucionit në fillim viti ²⁷⁷ marrin pjesë të gjithë anëtarët e personelit akademik dhe administrativ, të cilët shkëmbejnë përvojat dhe japin sugjerimet e tyre për përmirësimin e çështjeve që nevojiten. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësive bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit. KU “Bedër” synon ndërgjegjësimin e personelit të tij dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë.</p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>KU “Bedër” ka një rregullore të posaçme për vlerësimin e personelit në çdo fund semestri dhe viti akademik. Procedura dhe mënyra e vlerësimit organizohet sipas rregullores mbi anketat dhe vlerësimet. Një metodë e rëndësishme për të përmirësuar punët në njësitë kryesore, bazë dhe administrative është edhe organizimi i prezantimeve të hapura të raporteve vjetore të vetëvlerësimit të përgatitura nga ato. Në këto analiza vjetore marrin pjesë të gjithë anëtarët e personelit akademik dhe administrativ, të cilët shkëmbejnë përvojat dhe japin sugjerimet e tyre për përmirësimin e çështjeve që nevojiten.</p> <p>Nisur nga këto analiza dhe raporte, në fillim të çdo viti akademik hartohet nga njësia bazë plani i aktiviteteve për vitin në vijim. Proceset ciklike të vlerësimit respektojnë integritetin akademik shmangin çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p> <p>Krahas saj për stafin akademik me qëllim ruajtjen e objektivitetit në vlerësimin e tyre janë hartuar edhe anketat e vetëvlerësimit, të cilat u japin atyre mundësinë të vetëvlerësohen fillimisht, dhe më pas të vlerësohen nga eprorët dhe kolegët.</p> <p>Anketa e vetëvlerësimit e stafit akademik ka për qëllim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të njohë progresin që ka pasur stafi akademik gjatë vitit të kaluar; • Të përcaktojë mënyrat nëpërmjet të cilave performanca e tyre mund të përmirësohet dhe zhvillohet për t'i shërbyer si individit edhe institucionit; • Të mbështesë dhe zhvillojë qëllimet për vitin e ardhshëm; • Të rishikojë zhvillimin e karrierës;

²⁷⁵ Evidenca nr. 90: Rregullorja për funksionimin e Komisionit të Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit

²⁷⁶ Evidenca nr. 48: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC-së

²⁷⁷ Evidenca nr. 49: Lista e trajnimeve për stafin, 2014-2020

	<ul style="list-style-type: none"> • Të përcaktojë fushat e trajnimit dhe zhvillimit në mënyrë që të përmbushë misionin dhe qëllimet; • Të përcaktojë treguesit e cilësisë në mësimdhënie, kërkim shkencor dhe publikime.²⁷⁸ 								
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vjera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Ashtu sikundër u tha edhe më sipër, njësitë bazë të institucionit gjithashtu organizojnë takime konsultative me profesionistë të fushës për t'u informuar më tepër mbi dinamikat e tregut të punës dhe mënyrës sesi këto dinamika duhen përcjellë tek ndryshimet në program.</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">√</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				√
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			√						

<p>Standardi VI.5</p> <p>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë</p>	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Një metodë e rëndësishme për të përmirësuar punët në njësitë kryesore, bazë dhe administrative është edhe organizimi i prezantimeve të hapura të raporteve vjetore të vetëvlerësimit të përgatitura nga ato. Në këto analiza vjetore marrin pjesë të gjithë anëtarët e personelit akademik dhe administrativ, të cilët shkëmbejnë përvojat dhe japin sugjerimet e tyre për përmirësimin e çështjeve që nevojiten.</p> <p>Strategjia e institucionit është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimin e KU "Bedër". Aktualisht institucioni ka miratuar Planin e ri Strategjik për periudhën 2018-2023, në hartimin e të cilit morën pjesë përfaqësues të rektoratit, departamenteve, njësiteve kryesore, si edhe përfaqësues të studentëve të diplomuar dhe Këshillit Studentor, për të siguruar një përfaqësim sa më të plotë e gjithëpërfshirës.</p> <p>Të dy planet strategjike janë të aksesueshme për këdo përmes faqes zyrtare të institucionit.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Rezultatet e vlerësimeve të brendshme të programeve ju vihen në dispozicion personelit akademik, ndërsa raportet e akreditimeve të programeve apo vlerësimeve të jashtme publikohen për studentët dhe aktorët e tjerë, duke respektuar etikën akademike dhe legjislacionin për të dhënat personale.^{279 280}</p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që</p>	<p>Nga konstatimet e vlerësimeve dhe pas diskutimit të tyre edhe në njësitë bazë përkatëse në NJSBC, në komisionet e përhershme dhe në Senatin</p>

²⁷⁸ Evidenca nr. 45: Rregullore e anketave dhe vlerësimeve, neni 3

²⁷⁹ Evidenca nr. 2: Urdhër nr.223, datë 04.06.2013 "Për akreditimin institucional dhe të programeve të studimit"

²⁸⁰ Evidenca nr. 3: Vendim i BA Nr. 101, datë 10.11.2017 "Për akreditimin periodik të Institucionit të Arsimit të Lartë, Kolegji Universitar "Bedër"

adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Akademik, ngrihen grupe pune për hartimin e planveprimeve. Një shembull është Planveprimi për Vlerësimin Institucional të Kërkimit Shkencor. ²⁸¹			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Informacionet e marra nga pyesorët e ndryshëm janë pjesë e raportimeve të ndryshme periodike që bëjnë njësitë kryesore respektive. Raportet për monitorimin e cilësisë shpërndahen me stafin akademik dhe diskutohen për përmirësim të mëtejshëm të programeve të ndryshme mësimore. Varësisht rezultateve të vlerësimeve periodike të formave të ndryshme të vetëvlerësimit të përmendura më sipër, bëhet një shpërndarje e çështjeve që kërkojnë përmirësim, ose zhvillim të mëtejshëm varësisht zyrave përkatëse dhe më pas ri-auditohet nga komisioni përkatës ad-hoc. Vlejnë për t'u përmendur këtu monitorimi i zbatimit të plan-veprimeve të hartuara në kuadër të rekomandimeve të dala nga vlerësimet e jashtme, apo nga akreditimi i programeve të studimit, si dhe rishikimi i dokumentacionit me qëllim përmirësimin e cilësisë në vijim të auditimit të brendshëm që zhvillohet në institucion. ²⁸²			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	KU "Bedër" synon ndërgjegjësimin e personelit të tij dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë. Për këtë arsye, vazhdimisht realizohen takime orientuese dhe informuese, si dhe janë vënë në dispozicion të studentëve dhe personelit Guidën e Studentit ²⁸³ dhe Guidën e Stafit, ²⁸⁴ ku shprehet qartë rëndësia e cilësisë dhe sigurimi i saj në fushën e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor. Gjithashtu, me qëllim informimin sa më të plotë të studentëve me programin që ndjekin, kurrikulën, personelin dhe infrastrukturën në dispozicion të tyre. Çdo fillim viti akademik organizohen ditë të orientimit studentor ku studentët e viteve të para kryesisht, por jo vetëm, edhe studentë të viteve të tjera njihen nga afër me njësinë bazë dhe lektorët që lektrojnë tek programi i përzgjedhur prej tyre, me kurrikulën, laboratorët, dhe infrastrukturën në dispozicion, sistemin e automatizuar BIS, si dhe shërbimet e ofruara nga zyrat e personelit. Ditët dhe seancat e orientimit kontribuojnë në sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. Në ditët e informimit janë të pranishëm edhe këshilltarët akademikë dhe koordinatorët e programeve të cilët sigurojnë mbarëvajtjen e mësimdhënies dhe mësimnxënies në program në dimensionin afatgjatë. ^{285 286}			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht √

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht √
----------------------------------------------------------	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	-----------------------------------

²⁸¹ Evidenca nr. 86: Plan veprimi për vlerësimin institucional të kërkimit shkencor

²⁸² Evidenca nr. 87: Njoftim për fillimin e auditimit të brendshëm

²⁸³ Evidenca nr. 41: Guida e Studentit

²⁸⁴ Evidenca nr. 40: Guida e Stafit

²⁸⁵ Evidenca nr. 24: Vendimi i Këshillit të Departamentit për caktimin e këshilltarit akademik

²⁸⁶ Evidenca nr. 34: Vendimi për caktimin e Koordinatorit të Programeve Bachelor, viti akademik 2020-2021

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Kolegji Universitar Bedër”

Pikat e forta dhe afirmime

1. Ndërtimi i institucionit dhe i programeve mbi bazën e një vizioni, misioni dhe plani të zhvillimit strategjik të qartë, të plotë, dhe modern.
2. Ekzistenca e një kornize ligjore rregullatore e cila orienton zhvillimin e programit në përputhje me strategjinë e zhvillimit të KU “Bedër” me vizionin dhe misionin e tij dhe me treguesit e profesionalizmit.
3. Programe studimi të hartuara në përputhje me nevojat e tregut, objektivat e reformës së arsimit të lartë në vend dhe të Procesit të Bolonjës, si dhe duke integruar përvojën më të mirë bashkëkohore të huaj dhe vendase.
4. Cilësia e personelit akademik. Personeli akademik efektiv i angazhuar në realizimin e programit të studimit "Bachelor" në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” ka nivel të lartë të përgatitjes profesionale dhe eksperiencë të gjatë në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në profilin përkatës.
5. Personeli me kohë të pjesshme dhe lektorët e ftuar që vijnë nga institucione dhe fusha të ndryshme si ato të TIK, shkencave kompjuterike, medias, etj., ofrojnë në auditor një qasje praktike, duke i orientuar më mirë studentët drejt përvetësimit të kompetencave profesionale.
6. Përparësia dhe rëndësia kushtuar kërkimit shkencor. Përfshirja e personelit akademik në projekte të ndryshme kërkimore dhe sociale, në bashkëpunim me institucione të rëndësishme kombëtare dhe ndërkombëtare. Në këto projekte parashikohet dhe përfshirja aktive e studentëve. Departamenti i Shkencave Kompjuterike nxit në vazhdimësi përfshirjen e studentëve në kërkim shkencor. Studentët bëhen pjesë e konferencave studentore të organizuara nga departamenti duke prezantuar punimet e tyre. Përfshirja e studentëve në kërkim shkencor realizohet edhe në kuadër të lëndëve specifike gjatë programit tre vjeçar.
7. Bashkëpunimi me institucione arsimore, biznese, dhe kompani të teknologjisë së informacionit dhe shkencave kompjuterike brenda dhe jashtë vendit. Bashkëpunim i institucionalizuar me institucione homologe, me institucione të administratës publike dhe organizata. Nëpërmjet këtij bashkëpunimi KU “Bedër” realizon objektivat për praktikën, kërkimin, ndarjen e përvojave dhe punësimin e të diplomuarve.
8. Infrastrukturë logjistike, IT dhe sistemi i automatizimit (BIS). Administrimi Online i të dhënave nga njësitë kryesore rrit cilësinë e shërbimeve ndaj studentëve dhe transparencën ndaj tyre, duke i ardhur në ndihmë personelit.
9. Auditorë të hapur për përfaqësues të njohur të institucioneve, organizatave dhe kompanive të ndryshme shqiptare e të huaja. Larmishmëria e të ftuarve nxit studentët për t'u përfshirë

në mënyrë më të drejtëpërdrejtë në jetën profesionale.

10. *Pranim të studentëve bazuar në kriteret e cilësisë.* Kolegji Universitar “Bedër” zbaton kriteret të caktuara për pranimin e studentëve. Bursat e ekselencës janë vërejtur si mundësi për të rritur cilësinë e studentëve në fazën e pranimin.
11. *Vëmendja e kushtuar ndaj çështjeve me karakter social.* Kolegji Universitar “Bedër” u ka kushtuar një rëndësi të veçantë studentëve me aftësi ndryshe. Kolegji Universitar “Bedër” ka ndjekur një politikë gjithëpërfshirëse të studentëve në aktivitete të ndryshme me karakter social dhe sensibilizues.
12. *Përfshirja e studentëve në vendim marrje.* Përmes përfshirjes së studentëve në organe të ndryshme kolegjiale vendimmarrëse, Kolegji Universitar “Bedër” u ka mundësuar atyre jo vetëm të informohen rreth zhvillimeve të institucionit, por të kenë mundësinë për të qenë pjesë e vendimmarrjes.
13. *Kombinimi i standardeve akademike me aplikimet e botës reale.* Programi i studimit respekton standardet akademike duke i lidhur ato me aplikimet në fushën e teknologjisë dhe informacionit. Gërshetim harmonik mes aspektit teorik dhe atij praktik gjatë realizimit të programit të studimit. Për nga vetë natyra e programit, është e rëndësishme që studentët të marrin në mënyrë të koordinuar dijet teorike dhe praktike që parashikohen në kurrikul.
14. *Planifikimi i mirë i karrierës profesionale, i cili nis që me praktikën e gjetura dhe të organizuara nga departamenti në bashkëpunim të ngushtë me Zyrën për Planifikimin e Karrierës.* Angazhimi i përfaqësuesit të departamentit pranë Zyrës së Planifikimit të Karrierës përbën një avantazh për studentët. Po ashtu, edhe përfshirja e profesionistëve apo specialistëve IT dhe shkencave kompjuterike, në procesin mësimdhënës si asistent lektorë apo të ftuar, ka ndikuar pozitivisht në planifikimin e karrierës për studentët e departamentit.
15. *Institucionalizimi i sistemit të sigurimit të brendshëm të cilësisë* ka mbështetur sigurimin e cilësisë. Vlerësimi është bërë pjesë integrale e veprimtarisë së KU “Bedër” dhe Fakultetit të Teknologjisë dhe Biznesit.
16. *Strukturë e kompletuar organizative dhe funksionale.* Krijimi i një strukture të kompletuar, njësisive koordinuese dhe të sigurimit të cilësisë kanë ndihmuar në një menaxhim më të efektshëm.
17. *Klima pozitive e punës dhe bashkëpunimit.* KU “Bedër” ka një politikë të efektshme të marrëdhënieve të punës brenda institucionit dhe të marrëdhënieve të bashkëpunimit me partnerë jashtë institucionit.
18. *Përgatitja e studentëve cilësorë,* të aftë që orientohen shpejt përballë tërësisë së informacioneve dhe specifikave të sektorëve e degëve ku ata specializohen.
19. *Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit* mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Vlerësimi i vazhdueshëm rrit nivelin e objektivitetit dhe transparencën në vlerësimin e studentit dhe ka natyrë stimuluese e inkurajuese.
20. *Grupe të vogla studentësh për vit akademik.* Politika e kuotave jo-masive ka sjellë një impakt pozitiv në cilësinë e studentëve të pranuar dhe diplomuar nga programi. Grupet e vogla që nuk e kalojnë numrin 40 studentë, i japin mundësi personelit akademik dhe mbështetës në departament, për një angazhim të personalizuar ndaj çdo studenti.
21. *Eksperiencia e Departamentit të Shkencave Kompjuterike në administrimin e seancave të*




përvitshme trajnuese me stafin akademik të institucionit për menaxhimin e informacionit online që i shërben mësimdhënies.

22. Aksesimi i librarisë dixhitale JSTOR lidhur me librat dhe literaturën në fushën e Shkencave Kompjuterike.
23. Për realizimin e këtij programi, dhe jo vetëm, Kolegji Universitar “Bedër”, aktualisht zotëron dy laboratorë informatike të cilët ofrojnë kapacitete shumë të larta teknike. Të gjithë kompjuterët janë arkitekturë Workstation me parametra teknike të larta. Laboratori i ri i ngritur këtë vit akademik përballon rritjen e numrit të studentëve dhe instalimin e programeve të reja.
24. Programet ekstra-kurrikulare janë një mundësi shumë e mirë për studentët për të kuptuar dhe zhvilluar më mirë talentin, prijet dhe interesat e tyre dhe për t'i përdorur ato në funksion të së ardhmes së tyre.
25. Kolegji Universitar “Bedër” dëshmon perspektivën për t'u bërë një aktor dhe faktor i rëndësishëm në disiplinat e ofruara, jo vetëm në Shqipëri dhe rajon, por edhe më gjerë.
26. Pozicioni gjeografik dhe strategjik i Shqipërisë në rajon, i ofron Kolegjit Universitar “Bedër” perspektivën për t'u kthyer në një qendër ndërkombëtare studimesh.



Pika të dobëta

1. Numri i lartë i institucioneve të arsimit të lartë në Shqipëri, shpesh shfaqet si pengesë për njohjen e institucionit në publik.
2. Të qenurit një institucion relativisht i ri. Kjo përbën një tjetër pengesë në një treg të gjerë institucionesh të arsimit të lartë, një pjesë e të cilave kanë një historik më të gjatë dhe për rrjedhojë sigurojnë akses me të plotë në projekte të BE-së.
3. Ndryshimet e shpeshta të kuadrit ligjor që ndikojnë negativisht veprimtarinë e shkollave të larta private.
4. Rënie e interesit të studentëve ndaj librit dhe të lexuarit në përgjigjësi. Të ndikuar nga zhvillimet teknologjike dhe stili i komunikimit në hapësirën virtuale, studentët e rinj nuk tregojnë interesin e duhur për librin dhe të lexuarin.
5. Nevoja e ndryshimit të shpeshtë të programit mësimor që vjen si rezultat i avancimit të shpejtë të teknologjisë kompjuterike.

The bottom of the page features several handwritten signatures in blue ink. From left to right, there are four distinct signatures. The first is a stylized 'AB' followed by a name. The second is a more complex signature with a date '1/3/2017' written below it. The third is a signature that appears to be 'Art'. The fourth is a signature that appears to be 'S. B.'.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT VLERËSIMIT	E	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
		Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT					√
STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT					√
MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT					√
BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT					√
STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE					√
SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE					√
VLERËSIMI TËRËSOR					√

[Handwritten signatures and marks]

Lista e dokumenteve bazë për procesin e akreditimit të programeve të studimit

Lista e mëposhtme është dokumentacion i detyrueshëm që institucionet duhet të dorëzojnë së bashku me RVB në kuadër të akreditimit të programit të studimit. Nuk është e thënë që çdo pikë e mëposhtme duhet të jetë një dokument i veçantë; mundet që në një dokument mund të përmblihen disa nga të dhënat e kërkuara.

Në rastet kur dokumenti është ndryshuar totalisht ose pjesërisht, citimi i tij duhet të reflektojë edhe ndryshimet e bëra (ose të bashkëngjiten të dy dokumentet). Gjithashtu mund të përdoren evidenca të tjera që Institucioni ka në funksionin e tij.

Lista e dokumentave përmban **emërtimin e plotë të dokumentit** (psh statuti etj), ndërsa në Raport duhen cituar **edhe pjesët përkatëse të tij** (psh statuti i IAL, neni x, pika y).

Në rastin e mbështetjes/citimit në ligjet/aktet ligjore, këto dokumenta duhet të jenë pjesë e listës së mëposhtme (pjesërisht/ose plotësisht)

Evidenca nr. 1: Vendimi i Këshillit të Ministrave “Për liqencimin e Shkollës së Lartë “Hëna e Plotë” (Bedër)

Evidenca nr. 2: Urdhër nr.223, datë 04.06.2013 “Për akreditimin institucional dhe të programeve të studimit”

Evidenca nr. 3: Vendim i BA Nr. 101, datë 10.11.2017 “Për akreditimin periodik të Institucionit të Arsimit të Lartë, Kolegji Universitar “Bedër””

Evidenca nr. 4: Urdhër Nr. 426, Datë 18.07.2018, për hapjen e programit të ciklit të parë të studimit “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”, në Kolegjin Universitar “Bedër”, Tiranë

Evidenca nr. 5: Urdhër nr. 200, datë 3.7.2020 “Për riorganizimin e njësisve kryesore të Kolegjit Universitar “Bedër””

Evidenca nr.6: Urdhër Nr. 350, Datë 17.06.2019, për hapjen e programit të ciklit të parë të studimit “Bachelor” në “Shkenca Kompjuterike”, në Kolegjin Universitar “Bedër”, Tiranë

Evidenca nr. 7: Statuti i Kolegjit Universitar “Bedër”

Evidenca nr. 8: Vendim i Senatit Akademik për miratimin e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm, programi Bachelor në TIK


Evidenca nr. 9: Kërkesë për fillimin e procesit të vlerësimit të jashtëm të programit nga ana e Kolegjit Universitar “Bedër”, drejtuar Bordit të akreditimit

Evidenca nr. 10: Plani Strategjik 2018-2023

Evidenca nr. 11: Aplikim burse për Luginën e Preshevës

Evidenca nr. 12: Rregullorja e programit “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”

Evidenca nr. 13: Strategjia kombëtare për punësim dhe aftësi, 2014-2020:



[https://financa.gov.al/wp-](https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2018/06/Strategjia_Kombetare_per_Punesim_dhe_Aftesi_Plani_Veprimit.pdf)

[content/uploads/2018/06/Strategjia_Kombetare_per_Punesim_dhe_Aftesi_Plani_Veprimit.pdf](https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2018/06/Strategjia_Kombetare_per_Punesim_dhe_Aftesi_Plani_Veprimit.pdf)

Evidenca nr. 14: Studim tregu i programit “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”

Evidenca nr. 15: Plani Strategjik 2012-2017

Evidenca nr. 16: Rregullorja Themelore

Evidenca nr. 17: Rregullorja mbi Organizimin Akademik

Evidenca nr. 18: Raport i Zyrës së të Diplomuarve, viti 2019-2020

Evidenca nr. 19: Shembull syllabusi CMP 111 Hyrje ne algoritem dhe programim

Evidenca nr. 20: CV e stafit të angazhuar në programin “Bachelor” në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”

Evidenca nr. 21: Organigrama e Fakultetit të Teknologjisë dhe Biznesit

Evidenca nr. 22: Vendim i Këshillit të Departamentit për miratimin e planit të aktiviteteve, viti akademik 2020-2021

Evidenca nr. 23: Vendimi i Këshillit të Departamentit për caktimin e përfaqësuesit pranë Zyrës së Planifikimit të Karrierës

Evidenca nr. 24: Vendimi i Këshillit të Departamentit për caktimin e këshilltarit akademik

Evidenca nr. 25: Marrëveshje bashkëpunimi në kuadër të Erasmus me Universitete në Rumani dhe Kroaci

Evidenca nr. 26: Lista e bashkëpunimeve dhe MOU

Evidenca nr. 27: Raporti i aktiviteteve të zhvilluara ndër vite

Evidenca nr. 28: Përshkrim rreth Konkursit Kombëtar të IT-së

Evidenca nr. 29: Komunikim shkresor i Zyrës së Planifikimit të Karrierës me institucionet e zhvillimit të praktikave profesionale

